

NAUM R. PRIFTI

NJE PUSHKË MË SHUMË


REGJIME
BIBLIOTEKA E

85H-32

P 93

SHKËRTI

TROKASTER



8SH-32
PP3

8SH-32
S

NAUM R. PRIFTI

NJË PUSHKË MË SHUMË

(Tregime)

~~1979~~

LIVRATA E SHTETIT
GJËRANISHT
2986

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

E P A B E S U E S H M J A

E ke parë stendën e mjekësisë në Muzeumin e Luftës nacionalçlirimtare? Të lutem, shikoje me kujdes.

Autori.

Mjeku kryqëzoi duart mbi gjoks me një ndjenjë dëshpërimi dhe, ashtu siç e kishte zakon në raste të vështira, kafshoi buzën e poshtme, sa për një çast ajo i mbeti e bardhë.

— Tani e ka radhën «ai» — tha ngadalë. — Si të bëjmë, ta futim apo jo?

Infermieri po vështronte tej dritares zogjtë që çuçuritnin për një krodhe bukë mbi dëborën e ngrirë, ktheu kokën i hutuar, sepse nuk e kishte kapur menjëherë pyetjen. Ai duke shikuar fytyrën e menduar të doktorit, e mori me mend për kë ishte fjala.

Doktori sigurisht fliste për atë partizanin që duhej t'i prisnin dorën. Tjetër herë Abazi s'do të mendohej gjatë për të dhënë një përgjegje të prerë dhe, ndonëse i vinte mirë që mjeku po këshillohej me të, prapëseprapë e kuptonte pse e bënte atë gjë.

Ç'këshillë mund t'i jepte infermieri, kur vetë doktori s'dinte si të vepronte?

Nuk e kishin lënë më kot «atë operacion» për në fund. Dora duhej t'i pritej sepse s'kishte asnjë shpresë shërimi, po kishte një arësye tjetër të fortë që doktori e shtynte operacionin nga dita në ditë. Një dorë mund të pritet edhe në kushtet e papërshtatshme të një spitali fushor, këtu s'ishte çështja as te suksesi i operacionit, as te përgjegjësia që do të mbante mjeku. Gjatë atyre muajve pune në spitalin partizan, ai kishte mësuar shumë më tepër nga kirurgjia e luftës se sa në sallat e pastra e të bardha të Akademisë. Çështja qëndronte gjetkë: në spitalin partizan nuk gjëndej asnjë ampulë narkoze, asnjë shishe eter, dhe ishte jashtë logjikës të merrje një guxim prej të marri duke u hyrë operacioneve të vështira.

Doktori s'dinte si të bënte atë çast. Gjithë ato ditë s'kishte ditur si të vepronte. Ishte marrë me disa mjekime plagësh të vogla, kishte nxjerrë copëra predhash, kishte bërë ndërhyrje të lehta — të gjitha këto pa narkozë — po në fund të fundit ato s'ishin veçse plagë të lehta. Po dorës së atij partizanit si t'ja bënte, si mund të pritej një dorë pa një pikë narkoze?

E megjithatë duhej të bënte diçka. S'kishte nga kush të priste ndihmë. Spitali partizan që në një zonë të thellë midis malesh të larta, i siguruar nga rreziqet e papritura të luftës dhe kjo kishte anët e saj të mira, po kishte gjithashtu një të keqe te pashërueshme: që larg nga vijat e furnizimit. Ja si ndo-

dhi rasti tashti: po të ishin afër ndonjë qyteti, nuk do ta kishin vështirë të merrnin ca ampula me kloretil, kurse atje larg, në mes të maleve...

— Si t'ja bëjmë, Abaz?

Abazi ngriti supet dhe lëkura mbi ballë iu zhubros. E dinte se doktori kërkonte këshillë nga ai vetëm e vetëm se ndodhej tepër ngushtë. Po, në fund të shpirtit atij i erdhi mirë, prandaj u përgjegj shkurt e prerë, siç e kishte zakon:

— Ç'të presim më, doktor, ta futim, them unë.

Mjeku ngriti kokën dhe drejtoi trupin. Vendosmëria e infermierit sikur e shkundi dhe sytë i xixëlluan.

— Ashtu thua ti, hë?

— Poo...

Mjeku filloi të fërkonte qafën me dorë.

— Mirë, shko lajmëroje!

Abazi doli nga dera duke përkulur kokën.

Matanë dritares një diell i ftohtë dhe i largët shikonte dëborën e bardhë e të ngrirë. Cungenjtë e akullit, që vareshin nga strehët e çative, dukeshin si dhëmbë të mëdhenj të një bishe përralore që kishte mbyllur sytë e kotej përgjumësh. Një qetësi e trishtuar dimri sundonte në fshat dhe rreth e përqark krahinës dhe ajo botë, pa tinguj e pa zhurmë, ngjante me diçka memece. Para se të binte kjo dëborë e dëndur, në spitalin partizan dëgjohej fare mirë gjëmimi i topave dhe krisma e mbytur e mitralozëve të rëndë, po dëborë që pati rënë para tri ditësh, sikur e kishte veçuar spitalin partizan nga jehona e armëve.

Operacioni armik i dimrit 1943 që në kulmin e zhvillimit të tij; këtë e kuptonte edhe mjeku që, hëpërhë, ishte larg zonave të betejës. Dhe s'ishte e vështirë për ta kuptuar, sepse në dy javët e fundit kishin ardhur shumë partizanë të plagosur dhe krye dy-tri ditëve do të vinin sërish të rinj.

Doktori u shikonte plagët, u shikonte edhe moralin. Disa prej tyre qenë të tronditur përpara asaj furie të tmerrshme që kishte shpërthyer armiku dhe, ndonëse e mbanin veten, fytyrat dhe vështrimet e tyre të menduara flisnin hapur për ankthin që i mundonte dhe për pyetjen që i bënin vetes: si do të përfundojë kjo punë?

Këtë pyetje ja bënte vetes edhe doktori. Ai e merrte me mend se në spital vinte vetëm një pjesë e të plagosurve dhe ndofta pjesa më e vogël, afërsisht një e treta. Shumë të tjerë nuk vinin, ata që mbeteshin në fushën e betejës s'kishin si të vinin; nuk vinin as ata partizanë të cilët e kishin për turp t'i quanin plagët e tyre aq të rënda sa për të vajtur në spital.

Një nga ata ishte edhe «ai», që kishte ardhur në spital para katër ditësh. Qe një djalë i ri, me sy të butë e të qeshur, me një ecje të shkathët e të lehtë si prej sportisti dhe me trup të drejtë. Doktorit i bëri përshtypje fytyra e tij, që ruante gjithmonë një buzëqeshje të çiltër. Bustinën e vinte pak mënjanë, dhe prej saj i dilnin një tufë flokësh të dredhur ngjyrë gështenje.

— Po ti, çfarë ke? — e pyeti mjeku.

— Unë, — tha ai duke vënë buzën në gaz,

— s'kam ndonjë gjë me rëndësi. Vetëm dora më dhemb pak, qëkurse u plagosa. — Dhe, si një fëmijë i zënë në faj, filloi të fërkonte me gisht dërrasën e krevatit.

— Pa dale ta shikojmë pak!

— Ja, shikoje. S'është ndonjë plagë kushedi se çfarë. Unë erdha këtu më tepër që të mos ja prishja komisarit. Ai m'u qep e s'më ndahej: «shko që shko në spital.»

— Çpështille pak, të lutem! — Partizani filloi të zgjidhte nyjen e fashës, po këtë punë e kishte vështirë ta bënte vetëm me një dorë.

— Dale të të ndihmoj unë, — i tha mjeku dhe, ndërsa po ja zgjidhte, bandazhin, dëgjonte tregimin e partizanit.

— E kështu, doktor, këtë kujtim e kam nga Qafa e Martës. Atje u plagosa para një jave në pëllëmbë të dorës. Thashë me vete: e majta është, s'ka gajle dhe, që të më pushonte gjaku, bëra atë punë që ti e di, doktor. Në fillim e kisha mirë, po tani s'kuptoj pse u mahis dhe sikur është nxirë.

— Nxirë? — pyeti doktori duke rrudhur vetullat.

— E pra, është nxirë dhe lëshon ca flluska të vogla.

— Ç'thua, more? A je në vete?

Po partizani e ktheu përsëri me shaka:

— E po tani të sëmurë jemi ne, shoku doktor. Dhe në themi ndonjë gjë, ashtu kapërxyer, mos na e vërë re.

Doktori as që e dëgjoi. Ai po mundohej të çpështillte me kujdes fashat të cilat, pranë mishit

kishin marrë një ngjyrë kafe të zezë dhe qenë bashkuar e bërë një me dorën. Duke e çpështjellë, doktori e merrte me mend se ç'kishte ngjarë. Partizani që plagosur në dorë dhe, mbasi e kishte mjekuar plagën ashtu si ja kishte marrë mendja, s'i kishte dhënë më rëndësi. Pastaj plaga ishte mahisur nga të ftohtit, kishte ngrirë dhe dalëngadalë që bërë gangrenë.

— Ah, more shok, more shok... Po pse nuk erdhe më përpara?

— Kur të vija, atëhere kur e kisha mirë? Është turp, doktor, të vish në spital për një plagë të lehtë. Unë të thashë, ç't'i bëja komisarit, pa as që do të vija fare.

Gjithë pëllëmba e dorës që ënjtur, gishtrinjtë rrinin të hapur, të fryrë e mishi kishte marrë ngjyrën e plehut. Mishi kishte filluar të kalbej e të binte erë.

— A të dhëmb? — e pyeti mjeku.

Ai shikoi dorën e plagosur dhe pastaj fytyrën e mjekut.

— He, edhe më dhëmb pak, plagë është, s'ke ç'i bën.

Mjeku kapsalliti sytë dhe shtrëngoi dhëmbët vetëvetiu.

— Ty të dhëmb kaq shumë, — i tha i sigurtë, — sa herë-herë të vjen ta shkulësh këtë dorë dhe ta hedhësh tej.

Dhe u mundua të buzëgeshte.

— Vërtet, doktor, ndonjëherë ashtu më vjen, po, kur kujtoj se për të luftuar duhen dy duar,

them mirë e kam, le të dhëmbë ca, po duhet mbajtur.

Partizani e shtypi pëllëmbën me gishtin e dorës tjetër dhe në vendin e shtypur shenja e gishtit mbeti si një gropë e vogël me anë të rrumbullakta. Doktorin i shpërveshi mëngën dhe shikoi pullat kafe që ishin formuar te kyçi i dorës.

— Duhet të kishe ardhur menjëherë, tani kjo dorë... e kupton.

Partizani tha i qetë:

— U pa puna tashti, që do bëjmë ca pushim. Komisari tha se duhet çarë që të kullojë gjaku i lig. Tani ti e di, doktor, dhe bëj si të jetë më mirë, vetëm me gjilpëra mos më shpo, se ato s'i duroj dot.

Partizani po tregohej shumë optimist. Ndofta ai s'e kishte dëgjuar kurrë fjalën gangrenë. Mjeku psherëtiti padashur. Psherëtima e tij sikur e turbulloi partizanin e ri.

— A e ke dëgjuar ndonjëherë fjalën gangrenë?

— Jo, — tha partizani. Dhe u mundua ta mban-te mend këtë fjalë, që t'ua tregonte shokëve kur të kthehej në çetë.

— Do të përpiqemi ta shërojmë, po në rast se s'do të kemi sukses, atëhere s'kemi ç'bëjmë, «do ta heqim», — i tha mjeku me një gjest të vendosur që s'pranonte kundërshtime.

Partizani u vrënjt në fytyrë. E largoi dorën nga mjeku dhe e afroi pranë trupit, si të donte ta mbronte nga një rrezik.

— Jo, këtë s'do ta pranoj kurrë.

— Unë të thashë, — vërejti mjeku duke i shqip-

tuar fjalët shkoqur e ngadalë, — në qoftë se nuk do arrijmë ta shpëtojmë me mjete të tjera.

Në dhomë hynte drita e bardhë e diellit që reflektohej nga bora. Partizani tundi kokën me flokë kaçurrela dhe mbylli kapakët e syve. Atë gjë s'e kishte pritur kurrë, fytyra në çast iu bë serioze dhe e menduar. Po pastaj e mblodhi veten dhe përsëri ata sytë e butë morën shprehjen e tyre të zakonshme.

— Jo, doktor, nuk do vejë puna gjer atje. Kjo dorë do shërohet.

Doktori thërriti Abazin t'i lidhte fashat dhe u largua prej tij.

Mjekimi me serum antigangrenoz, ashtu siç e kishte parashikuar mjeku, nuk dha asnjë ndihmë. E jo vetëm s'e përmirësoi, por s'qe në gjendje të ndalonte përparimin e mëtejshëm të sëmundjes. Për çdo ditë që shkonte kyçi i dorës enjtej, duke marrë të njëjtën ngjyrë kafe të zezë, ashtu si pëllëmba e gishtrinjte.

Çdo ditë e humbur sillte tani rreziqe të reja dhe komplikacione.

Të djeshmen doktori e kishte marrë mënjanë partizanin dhe kishte biseduar me të. Në fillim ky djalosh i ri i qe dukur mjekut si gaztor, i prirë në jetë për të shikuar anën humoristike të gjërave. Bile dukej sikur çdo gjë e kish marrë me shaka, edhe plagosjen, edhe urinë, edhe dimrin, edhe vetë jetën.

— A ke nënë? — e pyeti mjeku jo pa qëllim, sepse çdo njeri gjen diçka për të thënë nga familja e tij.

— Kam njëzë! — u përgjegj partizani.

— Pse. kush ka dy?

— S'e di për të tjerët, po unë, një kam.

Doktorit iu duk më e natyrshme të hynte drejt e në temë dhe t'ja thoshte një herë e mirë të gjitha.

— Partizan, dëgjo si është puna. — Ai u ngrit nga karrigja dhe i hoqi duart nga tëmthat. — Me këtë dorë s'i kemi punët mirë. Besoj se edhe ti e ke kuptuar. Unë mendoj se është më mirë të jesh me një dorë, se sa të rrezikohesh.

Në dhomë ra një heshtje e rëndë, që zotëroi për disa çaste. Ndihehin vetëm hapat e partizanit, që vente e vinte nga dritarja deri te tryeza e mjekut. Pastaj qëndroi dhe pyeti me njëfarë mosbesimi.

— Gjer këtu paska arritur puna?

Mjeku tundi kokën në shenjë pohimi.

— Po sikur të pyesja një herë komisarin?

Nga kjo pyetje tepër naive dhe e qartë doktorit iu duk sikur çeli një dritare në shpirtin e tij. Po, në të njëjtën kohë i erdhi edhe keq. Pse vallë nuk e besonte atë? Deshi t'i thoshte: «Këtu komisar dhe komandant jam unë», po iu duk se me atë shprehje do ta fyente, dhe ai s'dëshironte të fyente asnjeri.

— Po ti, ç'pandeh? Mos vallë komisari të dërgoi kot këtu?

Partizani e pranoi se kjo vërejtje që e drejtë dhe u mat të ngrihej. «Vërtet komisari nguli këmbë të më përcillte sa më parë në spital, dhe s'm'u nda për asnjë çast. Të ketë ditur gjë komisari?».

— Prit, — i tha mjeku, — duhet të të them edhe diçka tjetër.

— Akoma?

Mjeku i vuri dorën në sup dhe e shikoi drejt në sy. Partizanit i erdhi mirë që mjeku e trajtonte si shok, dhe priste të dëgjonte ndonjë këshillë se si duhej t'i bënte ballë jetës këtej e tutje vetëm me një dorë. Mjeku i foli:

— Kjo na takon të dyve, por më shumë ty se sa mua. Ne s'kemi ilaçe për të të vënë në gjumë, na janë mbaruar, se kemi pasur shumë të plagosur, dhe kushedi kur do të na vijnë. Kemi dërguar një korrier në qytet, po puna jote nuk pret, prandaj duhet ta presim dorën pa narkozë.

Mjeku fliste me ndërprerje të gjata, duke i nxjerrë fjalët ngadalë.

— Kështu pra, do ta kemi pak vështirë, po ti do më japësh fjalën se do durosh si burrat. Unë kam besim se partizanët durojnë. Nuk është hera e parë që na ngjet kjo gjë. Unë kam operuar dhe tre-katër partizanë të tjerë me këtë sëmundje, — bile në gjendje më të rëndë — dhe ata kanë duruar tamam si partizanë, s'kanë nxjerrë asnjë britmë nga goja.

— Mirë, — i tha partizani — do përpiqem të duroj.

Dhe ja, erdhi çasti që ai të vinte për operacion.

Spitali partizan qe vendosur në një ndërtesë të vogël, e cila ndryshonte fare pak nga shtëpitë e tjera të fshatit. Dikur kishte qenë shkollë fillore, por për këtë as që i binte ndër mend njeriu, mbasi të

gjitha orenditë, bankat, tryeza e mësonjësit dhe dollapet qenë vjedhur ose kishin përfunduar në zjarr. Kishte mbetur, si për çudi, vetëm dërrasa e zezë, mbi të cilën një dorë e pastërvitur kishte shkruar me germa të mëdha: «Vdekje Fashizmit» — «Liri Popullit», duke zënë me këto katër fjalë krejt dërrasën, si të donte të tregonte se përveç kësaj parulle s'kishte asnjë tjetër më të rëndësishme në botë që të meritonte të shkruhei.

Po afronte dreka dhe strehët kishin filluar të pikonin. Një pikë këputej kohë pas kohe nga një cungal akulli dhe, duke rënë mbi kapakun e llamarinës, tingëllonte si një kampanë që bie përzishëm: tang! një pushim, tang! edhe një pushim tjetër, tang! edhe një pushim.

«Si i thashë? — u kujtua mjeku. — Do të të dhëmbë pak, por s'ke se ç'bën, duhet të durosh, sikur kjo të ishte diçka e lehtë, si mjekimi i një çibani. Ai do të ketë dhëmbje të tmerrshme, të padurueshme, do të bërtasë në kupë të qiellit, po unë duhet të mos e dëgjoj dhe të vazhdoj të punoj, sa të mundem me kujdes e shpejtësi. Për mua do të ishte më mirë që të mos i kisha veshët këto dy orë. Nuk është çudi t'i bjerë të fikët nga dhëmbja, prandaj edhe për këtë duhet të marrim masa, do t'i them edhe Abazit. Si tha i shkreti? Po sikur të pyesja një herë komisarin? Kush do të jetë ky komisar vallë? E njoh unë? Sidoqoftë amputacionin duhet ta bëj, megjithëse pa narkozë, është një gjë e tmerrshme. Sikur të më shikonte profesori se në ç'kushte po punoj, do të zinte kokën me duar dhe do të çmendej,

ose do të më quante mua të çmendur. E keqja është se s'kam as narkozë dhe as mjete për të bërë amputacionin. Si mund të pritet koska me një sharrë të zakonshme druri? Po s'kemi ç'bëjmë, këtë kemi. Ai do të bërtasë, do të qajë e do të më lutet që të mos e vazhdoj më, po unë duhet të mos e dëgjoj. Kam lexuar në një vend, te Odisea më duket, se si ai ua zuri veshët detarëve që të mos dëgjonin këngët e atyre sirenave magjistare të ishullit. Unë i thashë se kam bërë edhe nja tre operacione të tilla, e gënjeva që t'i jepja kurajë, por s'di në e besoi këtë gjë apo jo. Sikur të më ketë besuar, do ta kem më lehtë, edhe ai do ta ketë më lehtë. Duhet t'i them Abazit të ketë mendjen e t'i shikojë herë pas here pulsën. Po legeni ku është? Ah, ja ku qënka. Nuk mund të presim më, është kohë e humbur. Duhet të lajmëroj në shtab të nisin një korrier tjetër, se i pari nuk u kthye. Kushedi, mbase dhe është vrrarë. Unë s'duhet të jem kaq i merakosur kur të vijë ai partizani, përkundrazi duhet të sillem sikur kjo është diçka krejt e zakonshme dhe normale. Duhet t'i flas pak, që ta përgatit... Se si do të vejë kjo punë, s'e di as unë.»

Partizani hyri, pas tij ecte Abazi duke hequr zvarrë çizmet e grisura.

— Hë, ç'u bërë? — pyeti mjeku vetëm sa për të thënë diçka.

— Tani sa më lajmëroi ky «xhaxhua» — tha ai duke treguar me dorë Abazin.

— Uh! — shfryu Abazi. — Ç'xhaxho jam unë,

ore, sa vjeç më di ti mua? Apo që më shikon kësh-
tu të rrudhur...

— Nuk di sa vjeç je, po nja pesëdhjetë më du-
kesh se do të jesh.

Abazi, i fyer, filloi të nxirrte bandazhe e gar-
za nga një çantë dhe diç murmuriste.

— Unë kur të shikoj ty, nxjerr mallin e gjyshit!
— tha partizani.

— Ore ti djalë i mbarë, shiko hallin tënd, mos
shiko vjetët e mi.

Partizani vuri buzën në gaz dhe, duke ngrohur
dorën e shëndoshë pranë zjarrit, tha:

— Unë s'kam halle. Qëkur dola partizan e kam
bërë mendjen top, ose të them më mirë kam atë
hall që kanë gjithë partizanët: të çlirojmë Shqipë-
rinë nga fashizmi. — Dhe si të mos e kishte vënë
re zëmërimin e Abazit, iu drejtua i qetë:

— Abaz, i martuar je ti?

— Punë për mua.

— I pamartuar do të jesh. Duket.

Mjeku i bëri shenjë partizanit që të mos e ngac-
monte më tej infermierin e vetëm të spitalit, parti-
zani shikoi edhe një herë nga Abazi dhe tundi ko-
kën, ndërsa sytë i shkrepëtinin në të dy cepat me
një gëzim prej fëmije çapkën.

— Pse i futni hundët në punët e botës? Ke ar-
dhur për t'u shëruar apo përse?...

— Tani e shkele, Abaz. Jemi shokë a ç'jemi?

— Shokë, shokë, po çdo gjë ka një kufi... «Je
i martuar, s'je i martuar», ç'domethënë kjo?

Mjeku e pa se Abazi ishte nxehur vërtet dhe të gjitha ato fjalë që mendonte se duhej t'ja thoshte para se të fillonin nga puna iu dukën se pas atyre shakave nuk kishin vend. Dhe i ra shkurt:

— Abaz, përgatitu, të lutem, se s'kemi kohë. Ti, shoku partizan, ulu këtu. Do të bësh mirë të kthesh kokën në anën tjetër që të mos e shikosh gjakun. Dhe sa të mundësh përpiqu të jesh i qetë. Nuk do të zgjatë shumë, po ti, si djalë i ri që je, nuk do t'ja dish. Të siguroj unë, nuk është ndonjë gjë e madhe. Ti ke parë edhe më keq...

Partizani vuri re se doktorit i dridhej zëri dhe vazhdimisht fërkonte duart. Abazi e ndihmoi partizanin të shtrihej mbi një tryezë të zakonshme mbuluar përsipër me një mushama ushtarake. Në vatër digjej zjarri dhe mbi të valonte një kusi e madhe, prej nga dilte doreza e një sharre druri.

— Fillojmë, — tha mjeku. — Abaz, nëm bisturin. — Pastaj u përkul mbi kokën e partizanit dhe i tha: — Tani në fillim do të të dhëmbë pak, njësoj sikur të pritesh padashur me brisk, po pastaj do ta kesh më lehtë se vendi do të mpihet vetëvetiu.

— Mirë, mirë, — tha partizani disi nervoz.

Tani ai shikonte vetëm ballin dhe sytë e mjekut, pjesën tjetër të fytyrës ja mbulonte krejt një maskë garze. Një maskë të bardhë kishte vënë edhe Abazi, po nën hundë atij i dallohej si një tumbë tufa e dendur e mustaqeve.

Partizanit iu duk sikur dikush e pickoi fort në llërë, dhe pastaj ndjeu gjakun e ngrohtë që i derdhej mbi lëkurë. Partizani mbylli sytë, shtrëngoi

nofullat sa i kërcitën dhëmbët dhe u tkurr, duke u përpjekur të mbyste përbrenda çdo klithmë që mund t'i shpëtonte.

«Ja edhe pak, — thosh ai me vete sa herë që thika priste pejzat e muskujve, — sa të mpihet vendi dhe s'kam për ta ndjerë aq shumë, siç më tha doktori. Më duket se do të turpërohem, më vjen për të bërtitur. Duhet t'i shtrëngoju dhëmbët shumë!»

Ai shtrëngonte nofullat dhe nga tendosja e muskujve faqet i qenë bërë krejt të bardha. Dukej në ato çaste se asnjë mjet, asnjë forcë fizike s'do të qe në gjendje t'i hapte gojën. Doktori vazhdonte prerjen dhe i hidhte nga një vështrim fytyrës së tij. Shikonte edhe muskujt e qafës, të tkurrur aq fort, sa nga çasti në çast dukej sikur do të këputeshin duke bërë krak!

«Po duron... po duron mirë gjer tani. Po sa do të vazhdojë ky durim?».

Abazi kishte filluar ta shikonte me habi dhe respekt. Balli i partizanit qe djersitur e zverdhur, dhe, sa herë që thika priste diçka, gjithë trupi i ngrihej pak nën çarçaf e pastaj ulej sërish. Këto tkurrje e shtynin mjekun të punonte shpejt dhe, ashtu si korrenti elektrik, ato ja përçonin dhembjet e partizanit që po operohej pa narkozë.

Partizani me sy mbyllur parafytyronte sikur qe në këmbë dhe vinte re se si po e bënin operacion. I dukej sikur qe në këmbë dhe po shikonte se si i prisnin dorën. «Kjo s'është dora ime, le të bëjnë ç'të duan me këtë dorë. Ato pincat të kafshojnë keq. Si është e mundur të përdorin kaq shumë pin-

ca? Më duket se s'ka as vend. Gjithë kjo punë do të zgjatë dhe disa minuta. Kur filluam, si s'e vura re orën? Më pihet ujë... Sa është data sot? Më mirë t'i hap sytë. Ky tavan është i ulët... tavani i shtëpisë sonë është më i lartë dhe i lyer me bojë të gjelbër. Mbeta me një dorë. Sikur të kërkoja ca ujë. Tani më dogji shumë, më duket sikur po më shkulin diçka nga zemra. Kur të kthehem unë në çetë me një dorë... Vera! Ç'do të thotë Vera, vallë?» Dhe u mundua të merrte me mend keqardhjen e saj. Ai do t'i thoshte: «Vera, ai doktori më tha, është më mirë të jesh me një dorë, se sa pa asnjë».

Nga jashtë vinte drita e bardhë e dëborës dhe cicërimat e harabelave. Hija e doktorit dhe e Abazit kishte shkuar më nga lindja. Pika e ujit që binte mbi llamarinë ishte shpeshuar dhe tani kërciste me një tingull të qartë e ritmik, si të ishte duke shënuar sekondat e atij operacioni.

Erdhi çasti t'i prisnin dy koskat e krahut të dorës; ky ishte çasti më i vështirë dhe më i rrezikshëm. Këtu durimi s'kishte më punë, le të çirrej, le të bërtiste, vetëm të mos i binte të fikët.

— Tani e kemi pak vështirë, i tha doktori — Ti durove shumë mirë; u tregove burrë, tani edhe po të mos durosh s'ka gajle. Në qoftë se të vjen për të thërritur, thërrit.

Partizani mezi mundi t'i çlironte nofullat e shtrënguara dhe belbëzoi diçka, po mjeku nuk e mori vesh se ç'deshi të thoshte dhe iu vu sërish punës me tensionin e zakonshëm të kirurgëve.

Kur sharra e drurit i preku koskën, atëhere

s'ishte më punë durimi. Trupi i partizanit rrëgjohej e mblidhej, në çdo lëvizje të saj, sa nga një anë në anën tjetër, dhe nga sytë e mbyllur i kërcyen currila lotësh.

«Do bërtasë, tha mjeku me vete, do bërtasë si ai i djeshmi kur i nxora copën e predhës, po unë nuk do ta dëgjoj.»

Ai e pa partizanin që hapi gojën duke luajtur kokën sa djathtas majtas, pa gjetur prehje asgjëkund, po nuk e mori vesh se ç'deshi të thoshte.

«S'ka gjë, le të thërrasë, këtë askush në botë s'mund ta durojë, sepse dhimbjet janë jashtë kufive të mendjes njerëzore.»

Po partizani nxori në fillim ca tinguj të çjerrë, të thellë e të ndërprerë. Rrokjet e tij dilnin të shkëputura, me grykë dhe të ashpra si gurë mali.

**Kuq është ku lind dhe perëndon,
Kuq është në jug dhe në veri. . .**

Partizani, që të mos bërtiste, nisi të këndonte,
Dhe, ndërsa operacioni vazhdonte dhe sharra
me një fërshëllimë të mbytur hynte në koskë, ai
këndonte copëra këngësh njerën pas tjetrës.

**«Mitralozi kërcet,
Kudo lufta buçet,
Partizanët sulmojnë
Me trimëri.**

Qe një këngë e fuqishme, madhështore, e egër.

Dhe papritur pas derës së vogël u ndjenë zërat e një kori tjetër, që vazhdonte këngën si një jehonë:

«Në çdo vend, kudo shkel Brigad' e Parë,
S'ka armik që ta ndalë në rrugë të saj...
Ja brigada sulmon dhe armikun shkatërron...»

Ishin të plagosurit e tjerë. Ata e dinin se spitali partizan s'kishte ilaçe për të vënë në gjumë, dhe ndiqnin me ankth operacionin e rëndë të shokut të tyre. Dhe kur ai kishte filluar të këndonte, ata, si të magjepsur, nisën këngën edhe vetë, pastaj dikush prej tyre shtyri derën dhe ata u futën në dhomë.

Në çdo rast tjetër mjeku do t'i kishte nxjerrë përjashta, po atë ditë s'u tha gjë. Ata me zëra të ndryshëm bashkonin këngën e tyre me atë të shokut që po bëhej operacion.

Kur mbaroi krejt, mjeku i flaku dorezat dhe, pa hequr bluzën, e shtrëngoi pas gjoksit partizanin pa i thënë dot as edhe një fjalë.

Abazi, duke mbledhur copat e pambukut dhe të garzave të gjakosura, thoshte me zë të lartë:

— Dragua! Këtë e ka bërë nëna dragua!

— Do ta fitojmë luftën, — u tha mjeku të plagosurve të tjerë dhe ata pohuan me kokë pa e ditur se kjo frazë ishte si përfundim i një mendimi shumë të gjatë të doktorit.

Pika e ujit që shkiste prej konit të akullit tani binte mbi llamarinë me një ritëm të shpejtë, e tingulli i saj ngjante me një zilkë që tingëllon hare-

shëm, ting! ting! ting! ting! si të donte të lajmëronte
afrimin e shpejtë të pranverës.

Matanë dritares dielli shkëlqente mbi dëborë,
ndërsa strehët e çative kullonin dhe ujrat e dëborës
shkisnin në të gjitha drejtimet.

NJË PUSHKË MË SHUMË

Nënave të dëshmorëve

— Shko ti, më tha komandanti mua. — Shko dhe ti tok me të! — i tha Nasit që rrinte mbështetur pranë portës. — Nisuni tani, dhe në mëngjez të jini këtu.

Mua m'u drodh zemra dhe sikur ngriva. Nuk doja t'i kundërshtoja komandantit, nuk doja të thyeja urdhërin e tij, po edhe atje ku më dërgonte ai nuk më shkohej. S'më bënin këmbët të shkoja. Do të më vinte më lehtë të sulmoja një fortino a t'i dilja përpara një tanksi, se sa të përmbushja urdhërin e tij. Mbase nuk ishte as urdhër, ishte vetëm një lutje e thjeshtë, po e thënë në mënyrë të prerë, ngaqë s'mund të thuhej ndryshe në ato çaste. Unë duhej të shkoja në familjen e shokut dhe të jepja lajmin e hidhur të vrasjes së Bakiut.

Bakiu qe vrarë atë ditë, dhe ne s'e kishim mbuluar akoma. Komandanti kishte thënë se do ta varrosnim të nesërmen. Humbja e shokut tim më të ngushtë më kishte tronditur shumë, dhe isha si i hu-

tuar. Më dukej e pabesuar që më nuk do marshonim së bashku në malet e larta dhe s'do të dëgjonim shakara nga goja e tij.

Bakiun e kishim shtrirë në dhomën e një shtëpie fshati. Përsipër i kishim hedhur një kapotë të hirtë dhe mbi fytyrë i kishim vënë bustinën. Ai dukej sikur bënte një gjumë të thellë, pas një rruge të gjatë. Ne partizanët i rrinim përreth, pinim duhan në heshtje dhe këmbenim më të rrallë ndonjë fjalë, ndërsa përjashta binte ngadalë një muzg i qetë dhe i vakët pranverë. Nga dritarja e hapur vinte një erë mjalti, sigurisht nga lulet e kumbullës dhe të qershive që kishin hapur.

Kisha qëndruar në këmbët e Bakiut dhe shikojta këpucët e tij me proka, gjysmë të ngrëna e të shkëlqyeshme nga rrugët e gjata të maleve. Pyesja veten: «Pse nuk do të ecë më Bakiu? Si është e mundur?» Më vinte sikur pas një çasti ai do të shtynte kapotën me duar dhe duke u ngritur përgjysmë do na thoshte:

«Pse, vërtet pandehët ju që vdiqa? Kjo që vetëm një shaka.»

Pastaj do të dilnim të gjithë së bashku nga dhoma. Ai do të merrte pushkën që e kishte lënë afër dritares dhe unë, si intendent që isha, do t'u merrja lejë shokëve e do t'i jepja një racion bukë më shumë. Po nga ana tjetër e kuptoja fare mirë se këto qenë vetëm ëndrra dhe m'u kujtua se edhe asaj dite, kur më vdiq babai, unë po kështu kisha menduar, sikur ai do të ngrihej nga çasti në çast.

Në çetë na ishin vrarë dhe shokë të tjerë dhe

partizanët kishin vajtur për të treguar në familjet e tyre, po mua s'më kishte rënë kjo barrë e rëndë dhe as e kisha menduar ndonjëherë se sa i vështirë qe ky mision.

«Ç'na bëre, more Baki!» — i thosha unë, si të doja ta qortoja, dhe më dukej se gjer atë ditë ne kishim qënë shumë të lumtur, vetëm se atë lumturi, për çudi, nuk ë kishim ndjerë, nuk e kishim vënë re, dhe për këtë më vinte inat. Po tani, sikur të ngrihej Bakiu, sa të lumtur do ta ndjenim veten.

«More Baki, ç'na bëre! Si të vete t'i them unë nënës sate tashti?» Duket se këto fjalë i thashë me zë të lartë, pa e kuptuar as vetë, sepse Petriti, komandanti i çetës, pyeti:

— Akoma s'jeni nisur ju?

Ashtu i dëshpëruar siç isha, ja ktheva:

— Për nder, shoku komandant s'më bëjnë këmbët. Dërgo ndonjë tjetër...

Ai vrënji vetullat dhe më shikoi me inat:

— Nisu, more, dhe lëri fjalët!

Ai s'dinte të fliste bukur dhe nuk i zgjidhte fjalët. Fliste ashtu si i vinte për mbarë. Bile shpesh nuk fliste fare, dhe ne e kuptonim ç'donte të thoshtë vetëm duke shikuar fytyrën e tij.

U ngrita dhe fillova të mbërtheja kopsat. Atë fjalët e tij sikur më fshikulluan me thupër. Ç'do t'i tregoja unë, që e doja dhe e kisha shok të ngushtë Bakiun? Kjo ishte e vërtetë. Po ishte gjithashtu e vërtetë se unë e kisha shok, kurse ai e kishte vëlla.

Prandaj përpara tij s'kisha si të mos e ndjeja veten ngushtë.

Pas disa këshillave, që të kishim mendjen e të ruheshim nga armiqtë, ne u nisëm. Ashtu të rënduar siç ishim, as ua vumë veshin këshillave të tyre, dhe gjatë atyre vjetëve të luftës, s'mbaj mend ta kem kapërcyer xhadenë e të kem ecur më i shkujdesur se atë natë. Në atë gjendje shpirtërore, që ishim ne, ç'do gjë që të na ndodhte rrugës do të na dukej e parëndësishme.

— Trim ishte! — tha Nasi.

Sigurisht ai e kishte fjalën për Bakiun dhe për betejën që kishte ngjarë në mëngjez. Ne ja njihnim trimërinë Bakiut, sepse e kishim parë edhe tjetër herë si luftonte, prandaj vdekja e tij na rëndoi të gjithëve dhe na u duk sikur u plagos çeta. Plumbi e mori në gjoks, tek po u vërviste armiqve një bombë dhe ai ra menjëherë në tokë. E morëm të plagosur dhe e shpumë në një shtëpi fshati për ta mjekuar, po ai nuk rroi më shumë se dy orë.

Dhe ja tani ne duhej të vinim e të jepnim mandatin në shtëpinë e tij. Rrugës i dhashë të drejtë Petritit kur më caktoi me këtë detyrë, sepse natën, asnjë tjetër veç meje s'mund ta gjente rrugën dhe shtëpinë e tij më lehtë se sa unë që isha nga i njëjti fshat.

— A ke treguar ndonjëherë ti Nasi? — e pyeta shokun tim, me shpresë se ai ndofta, do të kish përvojë në kësí punëshi.

— Jo, asnjëherë, — tha Nasi. — Unë s'di fare nga këto punë.

— Po sikur të tregoje sot?

— Më vjen rëndë, tha Nasi, — s'e bëj dot. Dhe si të ishte kujtuar për diçka, vazhdoi. — Pastaj ty të përket, se e ke nga fshati dhe i di zakonet më mirë.

S'e zgjata më tej, sepse ai kishte të drejtë. Po mendoja fjalët që duhet të thoja dhe ecja duke përpjekur këmbët pas gurëve të rrugës. Vallë, si do ishte më mirë: ta thoja gjëmën menjëherë, apo ta nxirrja ca nga ca? Çfarë fjalësh thuhet në këso rastesh? Asgjë s'më binte ndër mend; fjalët nuk ujdinjin me njera-tjetrën, dhe të gjitha qenë pa lidhje. Më shumë se ato mendime, më kujtohet se kisha dëshirë që ajo rrugë të mos mbaronte kurrë dhe të mos vinte ai çast që të ngrija dorën e të trokisja në portën e Bakiut.

Po rruga mbaroi dhe ne arritëm në fshat aty nga ora dhjetë. Dritë s'dukej asgjëkundi. Ishte kohë lufte dhe njerëzit flinin herët. Edhe shtëpia e Bakiut ishte e errët dhe e heshtur si nata. Unë u hodha nga avllia dhe trokita lehtë në xham me thua.

— Kush është? — u dëgjua një zë gruaje nga brenda.

Ky ishte zëri i nënë Nasibesë.

— Jam unë, Mehmeti, me një shok, — thashë me zë të ulët.

U ndie fërkimi që bën koka e shkrepset mbi kuti, dhe pastaj dhoma u ndriçua. Mbi pllakat e oborrit ra menjëherë hija e kryqëzuar e hekurave të dritares dhe kjo vazhdoi gjersa mbajti flaka e shkrepset. Pastaj ndezën një kandil që ndriste dobët me një dritëz të verdhë dhe që s'kishte fuqi të hidhte hije.

Dikush doli na hapi portën dhe ne u futëm brenda. Rrinim të dy me Nasin me sytë përdhe e pa guxuar të shikonim njerëzit në fytyrë. Diku dëgjohej një e qarë fëmije dhe e trokitura ritmike e një djepi që tundej mbi dysHEME, po nuk kuptohej nëse kjo ngjiste në dhomën ngjitur apo në shtëpinë e fqinjit.

— Ç'ka ky djalë kështu sonte? Plasi së qari! — tha nënë Nasibeja. Ajo ishte mësuar t'i priste partizanët kurdoherë që t'i vinin, ditën a natën, prandaj vizita jonë i ngjau fare e natyrshme. Ajo nuk vuri re se ne qëndronim të heshtur, ose na vuri re dhe pandehi se qemë të lodhur nga rruga. Kjo ka më shumë të ngjarë, sepse pas pak urdhëroi një vajzë të re që hyri në dhomë;

— Sillu djemve të hanë nga një kafshatë bukë dhe shtrojuni për të fjetur se janë të lodhur.

— Ne nuk do të rrijmë, — i thashë unë — ne kemi ardhur... kemi ardhur... — dhe ngela, sepse nuk dija si të vazhdoja.

— Nga çeta vini? — pyeti ajo.

— Nga çeta, — iu përgjegja unë.

— Si i kam djemtë?

Unë heshta dhe ula kokën.

— Ç'ka ngjarë, Mehmet? — pyeti ajo duke u ngritur në këmbë.

Atëhere e përmblodha veten, i vajta afër dhe i vura dorën në sup.

— Nënë Nasibe, kemi ardhur të të japim një lajm shumë të keq, po ti do të durosh ashtu si durojnë nënat e partizanëve. Baku na la...

Ajo mblodhi duart mbi gjoks dhe unë pashë se si i dridheshin gishtrinjtë dhe si e përhumbur vështronte dhomën. Megjithatë nuk bërtiti, nuk thërriti dhe as nuk ja dha kujes ashtu siç prisja unë. Një grua që u ndodh te dera, vuri duart në kokë dhe iku duke lebetitur. Të qarët e saj u ndie në gjithë shtëpinë.

I tregova nënë Nasibesë ca hollësira dhe i thashë se do të ktheheshim po atë natë në çetë.

— Do vij dhe unë të shikoj djalin, tha ajo. — prandaj më prisni.

Ne e pritëm gjersa u bë gati dhe pastaj dolëm të tre. Prapa nesh lamë një shtëpi me dritë dhe zemra të dërrmuara nga dhembja. Sikur nënë Nasibeja të mos kishte ardhur me ne, unë do të mendoja se detyrën më të vështirë tani e kishim kryer; ç'që për të thënë, u tha dhe me kaqë kjo punë do të merrte fund. Po tani mendoja me ankth çastin kur ajo do të ndodhej para kufomës së djalit. Atëhere do të binte mbi trupin e tij, do ta pushtonte dhe do të qante me ngashërim, gjersa të mos kishte më lot. Mirëpo kjo gjë do t'i trishtonte shokët e çetës. Ne s'ishim mësuar me të qara grash, dhe më dukej sikur çeta, për një çast, do ta humbte pamjen e saj prej luftëtarësh dhe burrash.

Ne s'qanim për shokët që na vriteshin, se na vinte turp, edhe kur na shpëtonte ndonjë lot fshehur, kthenim fytyrën mënjanë që të mos na shikonin të tjerët. Ishim mësuar t'i kapërdinim lotët, dhe ata binin brenda nesh të rëndë, bashkë me dëshpërimin, me dhembjen e me urrejtjen tonë.

Natën ecnim pa folur. Unë prija përpara, nëna në mes dhe Nasi prapa. Vallë, përse mendohej ajo nënë, duke shkuar asaj rrugë të mundimshme? Mos vallë kujtonte fragmente nga jeta e djalit të saj. Ja, Bakiu është i vogël, nëna e ka lidhur në një djep prej druri dhe e përkund. Fytyra e tij ndriçohet në gjumë nga një buzëqeshje e ngrohtë, e pastër dhe e butë si diçka që mund të preket. Apo vallë kujton atë çast kur djali u lëshua nga prehri i nënës dhe duke u tundur e duke gugatur bëri tri-katër hapat e para në drejtim të vëllait të madh? Dhe pastaj gishtrinjtë me bojë të vjetëve të shkollës dhe fytyrën të përskuqur nga thëllimi i dimrit. Njëherë, duke luajtur me top, ai theu një xham dhe nga frika se mos e qortonte babai, atë natë vajti fjeti te halla. Kujtime të vogla, të parëndësishme, të cilat tani kishin mbetur larg si një rrugë e kaluar.

Në mëngjez, sapo ra dielli, arritëm në Vithkuq. Lajmi se kishte ardhur nëna e Bakiut i gjallëroi të gjithë partizanët.

Nënë Nasibeja hyri në dhomën ku kishim Bakiun, dhe partizanët që u ndodhën atje, u ngritën menjëherë në këmbë. Ajo hodhi sytë mbi trupin e të birit, po vetëm për një çast, pastaj shikoi sërish fytyrat e luftëtarëve. E qetë, e heshtur dhe e madhërishtme u dha dorën të gjithë partizanëve me radhë, si t'i ngushëllonte për humbjen e shokut, sikur deshte t'u tregonte se Bakiu u përkiste më shumë atyre se sa asaj. Vetëm kur mbaroi këtë ceremoni iu afrua trupit të të birit, iu ul afër kokës dhe si i hoqi bustinën nga fytyra, e puthi në ballë.

Ajo nuk qau, nuk thërriti dhe ne s'i pamë sytë e saj të përbotur. E dija se shtëpia e tyre ishte shtëpi luftëtarësh, dhe burrat e kishin për turp të qanin, po ajo që ishte nënë si duronte? Ku e kishte gjetur atë forcë të rrinte e heshtur si një përmendore, kur vdekja i këpuste një pjesë të zemrës së saj, një pjesë të trupit të saj?

Ajo ndenji atje pranë Bakiut duke i lëmuar ballin me dorë lehtë e lehtë, si të donte ta përkëdhelte dhe duke i thënë vazhdimisht vetëm një frazë:

— Biri i nënës, shokët do ta marrin hakun.

Unë shikoja sytë e saj të mëdhenj, të thellë, të menduar, që shprehnin në të njëjtën kohë dhembje e krenari, shikoja hundën e saj të shkurtër e pak të kthyer, lëvizjet e saj të matura dhe m'u duk sikur ajo ishte nëna e të gjithë luftëtarëve. Unë e aduroja duke i thënë me zemër fjalët më të dashura. Më vinte t'i hidhesha në qafë dhe ta pushtoja fort.

Sado që fishekët i kishim të paktë, kur e varrosëm shokun tonë, shtimë një batore për nder të tij. Ne do dëshironim që t'i jepnim përshëndetjen e fundit me një breshëri artilerie, po në çetë s'kishim asnjë top.

Nëna e Bakiut u përshëndosh me ne dhe u kthye që atë ditë në fshat, për të pritur njerëzit që do t'i vinin për ngushëllim. Unë e përcolla gjer në të dalë të fshatit dhe kur po ndaheshim i thashë:

— Të lumtë, nënë Nasibe! Qënke e fortë dhe trime. Unë pandeha se do të qaje, po ti u mbajte si burrneshë.

Ajo më dha një përgjigje që më la me gojë hapur. Me një zë ku shprehej habia, më tha:

— Si do qaja? Ai u vra, nuk vdiq!

Vdekja dhe vrasja për atë ishin dy gjëra që ndryshonin shumë nga njëra-tjetra. Vdekja ishte një fatkeqësi, një kob, një mënxyrë, kurse vrasja ishte një vepër burrërie dhe gjaku që kishte derdhur i biri në alltarin e lirisë një gjë e guximshme dhe e bukur. Sa mirë dinte ta bënte këtë dallim ajo!

Duke menduar kuptimin e atyre fjalëve, u ktheva kot së koti në atë dhomë, ku kishim pasur të shtrirë Bakiun. Pushka e tij ishte akoma afër dritares. Komandant Petriti, që deri atë çast e kishte mbajtur veten shumë mirë, pas varrimit të të vëllait po qante i vetëm në dhomë. Unë pashë se si i shkisnin lotët gjer në mustaqet e zeza. Ai më ndjeu që hyra, dhe bërtiti:

— Po ti ç'bën këtu? Shko, ndaju bukë shokëve dhe thuaju të bëhen gati.

Dola përjashta të bisedoja me kryetarin e këshillit të fshatit, i cili sapo kishte sjellë dy thasë me ushqime.

«Kujt i shkon mendja për bukë?» mendova. Megjithatë i ndava racionet sipas skuadrave. Pandehasë asnjë s'do të hante, po kjo s'qe e vërtetë. Partizanët hëngrën bukë, u mblaçitën në heshtje dhe, pa bërë shaka si tjetër herë, u bënë gati për rrugë.

Pasdreke u nisëm nga Vithkuqi. Tani çeta jonë mbeti me një shok më pak e me një pushkë më shumë. Komandanti më tha rrugës.

— Pushkën e Bakiut jepja të parit vullnetar që do vijë në çetë!

— Mirë, mirë, — i thashë unë, po me mendje kisha bërë tjetër plan. Pushkën e Bakiut do ta mba-ja unë, kurse atij që do të vinte do t'i jepja pushkën time. Doja të kisha një kujtim nga shoku im, po më shumë dëshiroja që, sa të isha unë gjallë, pushka e tij të vazhdonte të shkrepnte në dorën time.

TRE VETË KAPËRCEJNË MALIN

Kujtim të tim eti

— Unë kam qenë kalë, — e nisi ai bisedën duke shkundur pas zjarrishtës hirin e llullës. — Po, po, një copë herë në jetën time kam qenë kalë; dhe mos të duket çudi. Ne, në kohë të luftës, bënim kontrabandë, kapërcenim kufirin natën dhe futeshim në Greqi. Ishte një punë e lodhshme dhe e rrezikshme. Malet e Gramozit në dimër mbulohen me dëborë të dendur dhe ne duhet t'i ngjiteshim të përpjetës së malit ngarkuar me kontrabandë në kurriz. Kuajt dhe mushkat nuk kishin si të shkonin mbi dëborën e dendur, dhe punën e tyre e bënim ne; prandaj të thashë qëparë se unë kam qenë kalë.

«Na paguanin mirë për çdo rrugë, po edhe rreziqe kishte plot. Rreziqet ishin të ndryshme dhe vinin nga shumë anë, të gjitha binin mbi kokën tonë. Ne duhet të riheshim nga «guardia di finanza»; nga ujqit e uritur, nga gorenit i ashpër dhe nga partizanët.

«Guardia di finanza» kishte një karakoll të vogël sipër fshatit, veçse dimrit ata rrinin më shumë në zyrat e nënprefekturës, në qytet, se sa nëpër karakollët anës kufirit. Megjithatë, kishin rënë në erë të punës sonë dhe herë pas here ja behnin natën në

fshat, duke përgjuar nisjen e kontrabandistëve. Shpesh ata vepronin sipas ligjeve: kontrabandistët që zinin i gjykonin dhe pastaj i dënonin me burgje të ndryshme, sepse qeveria kishte plot burgje. Nuk ishin të rralla as rastet kur merrnin në dorë bakshishe të majme nga shefat tanë dhe s'e shpinin punën më tej; na lironin pa vajtur akoma në qytet. Më të rrezikshmit nga të gjithë qenë partizanët, ata s'kishin burgje dhe i binin shkurt: të pushkatonin ose të lironin.

«Kontrabanda që një batakçillëk i madh, që s'dihej se ku fillonte dhe ku mbaronte, ne qemë vetëm një hallkë e këtij zinxhiri. Mallrat që mbanim mbi kurriz s'ishin tonat; ne qemë kafshë që bënim mbar-tjen mbi malet me dëborë në dimrin e ashpër, e megjithatë mbi ne binin rreziqet më të mëdha. Të tjerët rrezikonin paratë, ne kokën.

— Po pse merreshit me këtë punë të rrezikshme?

— Gjithmonë gjënden njerëz në botë që merren me punë të rrezikshme. Disa i shtyn pasioni, disa kureshtja, shumicën halli.

— Po ju kush ju shtynte?

— Nevoja, — tha ai, — fuqitë ndërluftonjëse na i grabitën të gjitha bagëtisë dhe ne mbetëm si peshku në zall. S'kishim me se të rronim, dhe bënim çdo lloj pune, mjaft që të fitonim diçka.

* * *

Tre vetë po kapërcenin malin natën. Ndonjë gjysmë ore ecën me kujdes e pa folur nga frika se

mos i dëgjonte kush, pastaj, kur u larguan mjaft nga fshati, filluan ta ndjenin veten të qetë, se rojet e financës nuk ngjiteshin kurrë deri atje.

Poshtë, fshati mezi dukej nën dritën e hënës. Gramozi sipër tyre zbardhte në heshtje, edhe lugina poshtë qe e heshtur, çdo gjë dukej e heshtur dhe e ftohtë si dëbora që kishin nën këmbë.

Dëborën e çante Rrapi Gjini, kurse dy të tjerët ecnin në gjurmat e tij. Ata e kishin vështirë ta ndiqnin, sado që ai çante dhe dëborën.

— Të çlodhemi pak! — tha Xekua. I vinte rëndë t'ja thoshte Rrapit këto fjalë, prandaj iu kthye atij që kishte prapa. — Si thua ti, Ndreko?

— Si të thotë babai, ai e di më mirë këtë punë.

— Te «Gurët e Bardhë» do të qëndrojmë, — tha Rrapi Gjini, pa kthyer kokën. Këtu të grin era.

Këto fjalë ai i tha në një mënyrë të tillë, të vendosur e të qartë sa asnjëri s'pati guxim të kundërshtonte. Rrapi i dinte të gjitha shtigjet, sepse më parë kishte punuar si qiraxhi asaj rruge dhe njih-te me hollësi çdo pëllëmbë vend. Ai orientohej në natën e errët, në mjegull dhe në tufan, si një mushkë plakë që e gjen rrugën me anë të instinktit.

Te «Gurët e Bardhë» qëndruan. Xekua u shtri më kurriz mbi topin e lëkurëve. Rrapi liroi litarin, e la arkën në dëborë dhe pastaj i ndihmoi të bërit të shkarkohej.

— Pesë minuta do të rrimë! — tha Rrapi duke shkundur dëborën e këpucëve. Dy të tjerët ndiqnin si padashur çdo lëvizje që bënte ai. Ata panë se si ai hoqi dorashkat dhe pastaj nxori nga xhepi një

shishe të vogël me konjak «Metaksa», dhe përpara se t'i hiqte tapën e shkundi shishen mirë.

— Mos ka ngrirë? — e pyeti Xekua.

— Jo.

— Çudi. E kam vënë re edhe unë, sado ftohët që të bëjë, konjaku s'ngrin kurrë.

I pari piu Rrapi pastaj edhe dy të tjerët.

— Ama ç'zanat edhe ky yni! Jo të rrimë ta pimë konjakun pranë zjarrit, në shtëpi, ashtu siç ka hije, po këtu, në majë të malit!

— Kush s'luan këmbët, s'luan as dhëmbët! — Proverbi ishte i njohur, po toni me të cilin i shqiptoi këto fjalë Rrapi Gjini, i tingëlloi Xekos si një qortim i rëndë. Ai bëri sikur s'kuptoi, dhe pyeti për diçka tjetër:

— Kuptohet se qeveria e ndalon kontrabandën, po partizanët shqiptarë pse? Ç'u hyn atyre në punë, në qoftë se ne japim mall e marrim flori?

— Derisa kanë dhënë urdhër, domethënë që u hyn.

— Po ta shikosh hollë, ne ndihmojmë luftën. U japim grekve mall dhe marrim flori. Floririn se mos e kanë të tyre grekët! Englezët ua kanë dhënë.

— Nuk është ashtu. Ç'merr ti nga rruga? Një napolon. Po paratë e tjera ku shkojnë? Në xhepin e Xhezat beut, apo jo?

— Tamam, — pohoi Xekua. — Në xhep të Xhezat beut, ose të ndonjë tjetri.

— Me një fjalë në xhepin e atij që ka mallin. Kurse Xhezat beu dhe shokët e tij janë kundër partizanëve. Kjo dihet.

— Xhezat beu s'është as me djallin, më duket mua. Ai është nga ajo anë që del paraja.

— Xhezati është me italianët. Edhe mallin prej tyre e blen. Po këto para që fiton, një ditë, do t'i kthejë kundër partizanëve.

Ndrekoa dëgjonte bisedën e tyre në heshtje. Ai mendonte se sa e çuditshme qe gjendja e tyre.

Në këtë copë rrugë që mbante vetëm katër orë ata këmbenin tre pushtete të ndryshme. Në fshat, qëndronin në fuqi ligjet e qeverisë së Tiranës me nene e paragrafe të kopjuara nga Italia, të cilat dita-ditës po e humbnin fuqinë. Në zonat e çliruara dhe praktikisht në mal, këto ligje as njiheshin, as respektoheshin, aty zotër të vendit ishin partizanët, ata qeverisnin vendin dhe kishin ligjet e tyre të pashkruara; kurse në tokën greke, rrëmuja ishte akoma më e madhe, ngaqë vendi qe i ndarë në shumë parti politike.

— Mua gjene s'më mbushet mendja, — kundërshtoi Xekua. — Në fund të fundit beu, me këtë punë që bën, ndihmon grekët. Ata vishen, mbathen, armatosen dhe luftojnë kundër fashizmit.

— Nuk ta merr mendja se këtu ka edhe diçka politike? Ti e kupton, puna është e tillë që duhet të punosh me mirëbesim. Shkojnë e vijnë me mijëra florinj. Po në fund të fundit me kë e bën kontrabandën Xhezat beu? Me Zervën, apo jo. Dhe ajo puna e Zervës s'merret vesh, ai sa për sy e faqe lufton kundër fashistëve, po me partizanët grekë nuk bashkohet. Sidoqoftë, ai me sa duket është dbrë e englezëve në Greqi dhe as heq, as këput.

— E di unë atë punë: nëntë grekë bëjnë dhjetë parti.

— Sidoqoftë, ku shkojnë këto para që po fitohen me grusht? Ti e the vetë, në xhepin e Xhezat beut ose të ndonjë tjetri. E përse do t'i përdorin ata këto para? Për të luftuar partizanët, se partizanët janë armiqtë e tyre, dhe ja si kthehet çështja fët e fët në politikë. 5000 florinj në dorë të Xhezat beut janë 500 bashibozukë në radhët e ballistëve. E di si thonë francezët: luftën e bën paraja.

— Po atëhere ne békemi bataqçillëk! — thërriti Xekua me frikë nga ky zbulim që kishte bërë.

Rrapi Gjini nuk u përgjegj. U ul, mori arkën me gozhdë këpucësh, e hodhi në kurriz dhe i nxiti të tjerët të niseshin për rrugë.

— Dil ti, Ndreko, çaj dëborën! — urdhëroi ai të birin.

Xekua mbeti pak më prapa.

— Mos ke ndër mend të kthehesh? — e pyeti me ironi Rrapi.

— Për nder, edhe të kthehem s'jam pishman. Unë s'e dija, pa nuk e bëja kurrë një gjë të tillë. Im bir partizan, dhe unë hajvani. . . Po ti, more Rrapi, kur i di si janë kokolepsur çështjet, pse merresh me këtë punë?

— Se më paguajnë, përse tjetër.

— Po rashë në dorë të djalit, keq e kam punën. Vetëm të shpëtoj kësaj radhe. Sidoqoftë kjo është hera e fundit. Në ardhsha tjetër herë, m'u thafshin këmbët, u bëfsha ulok!

— Yt bir! — qeshi me pahir Rrapi Gjini. —

Punë e madhe! Do të të shajë, shumë-shumë do të të pështyjë, po nuk i erdhi turp, po nuk do të të vrasë, se i ke bërë kokën. Po a ke menduar ndonjëherë, sikur t'i bija unë në dorë Jani Kripës? Sikur të bija në dorë të hasmit tim?

Xekua e dinte se Rrapi Gjini ishte në hasmëri të vjetër me familjen e Jani Kripës. Ishte si një hasmëri korsikane, që vazhdonte me dhjetra vjet, e tani as që dihej kur e pse kishte nisur.

— Qeni! — tha Rrapi duke e shqiptuar këtë fjalë me gjithë urrejtjen që mund të mblidhej në ato katër gërma.

— Qeni! — tha së dyti. — Pse jo, edhe inatin e nxjerr, edhe ligjin e mbron.

— Ç'merresh atëherë me këtë punë?

— Sidomos po u ndodh vetëm. Atëherë na qëroi, s'ka nevojë të na shpjerë përpara gjyqit partizan.

— Po atëhere ku vemi ne? — pyeti Ndreku me druajtje dhe qëndroi në vend.

— Kam marrë vesh se s'është nga këto anë. E kanë hequr, e kanë shpënë andej nga Çorovoda. Jam ujk plak unë, i nuhas gjërat me erë. S'e dini ç'më ka ngjarë para tri javësh. Këtë as Ndrekos nuk ja kam thënë, — tha ai si për t'u shfajësuar para të birit. — Më zuri Jani Kripa...

— Jo, ore! — u habit Xekua.

— Më zuri e më liroi. «Maskara, më tha, maskara — përsëriti kastile këtë sharje, që t'i fuste të birit urrejtjen në shpirt për hasmin e tyre, — nuk e di që e kemi ndaluar kontrabandën?» «Nuk bëj kontrabandë, i thashë, këtë duhan po ja shpie tim

kushëri». «Mua s'ma hedh dot, më tha dhe mos u orvat të më gënjesh. Këtë herë do të të liroj, që të mos thuash ma bëre për inat personal, por po të zura tjetër herë, plumbin e ke hak... Herën e dytë nuk do të të fall!»

— Të paska dalë nga borxhi! — tha Xekua.

— U tregua zotëri! E njoh unë atë, ç'maskara është. E bëri kastile që të më poshtëronte.

Ndrekua dëgjonte pa bërë zë. Për tetëmbëdhjetë vjet me radhë ai pat dëgjuar këngën e urrejtjes në shtëpi të tij. Çdo sharje që mund të thuhej në adresën e hasmëve të tyre, ishte thënë, e plaku kish kujdes të shfrytëzonte çdo rast të parëndësishëm, që të mos e linte zjarrin e urrejtjes të shugatej. Në familjen e tyre nuk ua përmendnin kurrë emrin hasmëve, po thoshnin «ata» ose «ai» dhe me kaqë kuptohej fare mirë se për kë ishte fjala. Ndrekua ndofta do të kishte shkuar partizan si shokët e tjerë, dhe këtë do ta kishte bërë me kohë, por mendimi se në çetën e vendit ishte «ai», e bënte të stepej dhe të ngurronte. Bile i dukej se nga ky shkak nuk e kishte më atë dashurinë e parë për partizanët e për idetë e tyre. Do të kishte qenë mirë sikur Jani Kripën të mos e kishin pranuar në çetë, ose sikur ai të ishte bërë ballist, atëherë Ndrekua do të shkonte menjëherë partizan, sepse donte që hasmin ta kishte kundërshtar, po jo shok armësh. Këto bluante Ndrekua në mendje ndërsa çante dëborën e dëgjonte fjalët e të jatit.

Natë dimri, natë e gjatë dhe e ftohtë. Hëna hidhte mënjanë hijët e tyre dhe ato shiknin lehtë e lehtë mbi shtresën e bardhë të dëborës. Hija e Xekos i

ngjante një aeroplani, sepse ai kishte ngarkuar një deng me shuaj. Herë dukej si aeroplan e herë si kryq.

— Kryq! — tha Rrapi nëpër buzë, duke i ngulur sytë hijes dhe diçka i theri në gjoks. Ngriti sytë nga qielli dhe u lut pa zë: — O zot, na ndihmo!

I tha djalit të këmbente rrugë e të merrte tjetër drejtim, vetëm që hija e Xekos të mos dukej si një kryq i zi që ikte mbi dëborë; ai e kishte vënë re: kjo shenjë ndillte prapësi. Si të gjithë kontrabandistët, edhe ai e kishte kokën të mbushur plot me bestyt-ni. Në vend të pagurit me konjak, që ishte shumë më praktik, mbante një shishe, sepse i qe tiposur në mëndje se ajo i sillte fat.

Agimi po zbardhëllonte ngadalë. Kreshtën e mallit e kishin kapërcyer me kohë dhe po zbrisnin në faqen lindore të Gramozit. Rruga ishte e tatëpjetë, dhe këmbët i hidhnin pa mundim, veç duhej të kishin kujdes se mos shkisnin.

— Duhet gjetur ndonjë punë e ndershme, baba! — tha Ndrekua. Si dukej atij s'i pëlqente të merrej me kontrabandë. Rrapi Gjini e dinte këtë, sepse i biri tërthorazi i kishte thënë dhe disa herë të tjera.

— Punë e ndershme! — tha me përbuzje Rrapi. — Në kohë lufte s'ka punë të ndershme. Gjëja më e ndershme është të luftosh, përndryshe, edhe sikur të mos duash, do të merresh me batakçillëqe.

Ai kishte një logjikë të ashpër dhe të vrazhdë. Ndrekua e dinte se të jatën shumë njerëz nuk e donin dhe e urrenin për atë lakuriqësi me të cilën i shprehtë mëndimet.

Xekua s'donte të fliste. Meqë e kishte rrugën e

fundit, edhe rruga i dukej e gjatë, edhe barra e rëndë. Donte që udhëtimi të mbaronte sa më parë e të kthehej gjallë e shëndoshë në shtëpi, të pinte një ponç të ngrohtë e pastaj të flinte. Kur shkoi nëpër mend se sa rreziqe i ishin dashur të përballonte për ato pak para që kishte marrë, e quajti veten budalla që i ishte futur një pune të tillë.

— Mbaje mend, Xeko, «Tre Bredhat», duhen lënë më të djathtë, se përndryshe dalim te gremina.

— S'më duhen më! — tha Xekua i vendosur.

— Pse, s'ke për të ardhur tjetër herë?

— Jo.

— S'ka gjë. Dikush tjetër do të vijë në vendin tënd. Njerëz ka shumë, punë pak.

U këmbyen përsëri. Rrapi Gjini nisi të çante dëborën. Djali e shikonte në profil dhe mendoi atë që kishte menduar qindra herë: në profil babai ngjante çuditërisht me një shpend grabitqar. Ai kishte vënë re se babai kishte edhe një zakon tjetër: fitimet ose punët që i dilnin mbarë s'i zinte kurrë me gojë, sepse i dukeshin krejt normale, kurse humbjet dhe dështimet i përmëndte gjithmonë me një dëshpërim të sinqertë.

Rrapi u kthye papritur nga pasonjësit dhe i pyeti:

— A u lodhët?

— Dëbora të lodh... — tha Ndrekuja nëpër dhëmbë, kurse Xekua s'foli fare.

— Edhe për një orë vemi në fshat. Kaqë mban prej këtej. E di unë... — Lanë pas ca bredha të ngarkuar me dëborë. Rreth e qark, me kilometra të të-

ra s'ndihej asnjë zhurmë. Vetëm dëbora kërciste nën hapat e tyre. Ajo qetësi kishte diçka të frikshme e të ankthshme për të tre kontrabandistët.

Rrapi ndezi një cigare dhe, duke nxjerrë tymin, me një psherëtimë të gjatë, tha:

— Domethënë kështu tha Seiti për lopën: «i dua paratë në dorë».

— Po, kështu më tha.

— S'ke ç'i bën, sot kështu ka ardhur koha, s'të beson njeri. Do t'ja japim, të mos ketë merak. Me ato që kemi mbledhur e me ato që do marrim sot plotësohen. Me para bëhen të gjitha. As gruaja s'të do pa para.

Sado që këto fjalë i ati i tha për të gjitha gratë e botës, Ndrekos iu dukën si një fyerje për të ëmën. Atij nuk iu durua, dhe e qortoi të jatin duke i thërritur ashpër:

— Baba!

Po i ati s'hoqi dorë nga mendimi i tij.

— Do të martohesh e do ta shikosh, mos ki merak.

Shkonin në gjurmat e njëri-tjetrit. Në atë bardhësi të heshtur s'kishte shenjë jete, dhe për një çast Ndrekos iu duk sikur ata ishin udhëtarët e parë, që po zbulonin një tokë të panjohur. Tej, përfund shpatit të malit, dukeshin shtëpitë e një fshati të vogël dhe një tym i hollë ngjyrë vjollce nderej mbi të.

— Ikën nga një krahinë në tjetrën dhe të duket çudi, — tha Rrapi Gjini — e sidomos, kur shkon në ndonjë vend malor, thua me veten tënde: «ç'bëjnë këta njerëz që rrinë këtu, në këtë vend të humbur? Ç'do t'i prishej botës sikur këta të mos ishin fare?»

Hiç, asgjë! Po nga ana tjetër, edhe të tjerët, kur shikojnë fshatin tonë, me siguri kështu thonë. Kurse ne na duket se fshati ynë është ndryshe nga të tjerët, dhe e vlen të jetohej.

Asnjëri nuk e vazhdoi bisedën më tej. Po atij iu duk se kjo ishte një e vërtetë që s'kishin si ta kundërshtonin, prandaj, për t'i dhënë shkas bisedës, foli:

— Ama çfarë qetësie, hë?

Xekua s'donte të fliste, bënte sikur s'dëgjonte, kurse Ndrekuua dukej i humbur në ëndërrime. Rrëzë një peme ata vunë re se dëborë që përlyer me gjak të freskët dhe pupla e pendë ishin përshkënditur andej-këtej. Sigurisht ndonjë skifter do të kishte ngrënë atje prenë e vet. Dukej se do të ishte bërë edhe një përleshje midis viktimës dhe skifterit, sepse shtresa e dëborës që prishur në një sipërfaqe të madhe. Rrapi e soditi vendin dhe shfaqti admtrimin e tij për skifterin.

— Shih, ç'i ka punuar. Ore! E ka zhvatur me sqep e kthetra!

Kurse Ndrekos ai gjak mbi dëborë i ngjalli një ndjenjë të turbullt dhe i erdhi keq për viktimën. Dësh të thoshte diçka, po i ati papritur pyeti:

— A thua të ketë ngrirë lumi?

Ndrekuua u kollit, kurse Xekua diç murmuriti nëpër dhëmbë.

— Lumi s'ngrin kollaj, — iu përgjegy vetes së tij Rrapi. — Ujët e nderjur ngrin menjëherë, kurse ai që lëviz mezi ngrin.

Dëbora kërciste nën këmbët e tyre. Ai donte me domosdo ta thyente heshtjen, sepse heshtja rëndonte si plumb.

— Kifoni shiti sahatin e xhepit katër napolona flori. Lirë e shiti. Po ta kisha unë atë sahat, do ta kisha shitur gjashtë napolona. Sot kështu është, ata që janë të zot blejnë, ata që s'janë të zot shesin.

Ata ecnin dhe më shumë u rëndonin mendimet se sa barra që mbartnin në kurriz.

— Te kisha e Shënmërisë do të qëndrojmë, — tha Rrapi. — Ju do të rrini atje të ruani mallin, unë do të zbres në fshat.

Kishin zbritur në luginë e po ecnin anës së një pylli.

Atje moti e kishte hedhur dëborën me erë, vende-vende dukeshin gurët e zez dhe toka e ngrirë, kurse në vende të tjera, metalet e dëborës ngriheshin gjer dy metra lart, duke formuar ca përrenj të bardhë e të heshtur.

— Duket se s'do të ketë partizanë! — tha Rrapi, sepse vendin e rrezikshëm tani e kapërcyem.

Rrëzë kufirit, partizanët shqiptarë vinin shpeshherë; ato ishin zona të thella dhe ata çlodheshin ose rigrupoheshin pas aksioneve që kishin bërë kundër armikut.

Ai s'e kishte mbaruar mirë fjalën, kur dalloi dy koka njerëzish që po vinin në drejtim të tyre. Instinktivisht u ul të fshihej. Pas tij qëndroi edhe djalli, kurse Xekua vazhdoi të ecte kokulur.

— Ulu, Xeko! — i thërriti Rrapi nëpër dhëmbë, që të mos dëgjohej larg.

Xekua nuk dëgjoi, ai vazhdoi rrugën: Rrapi e thërriti përsëri.

— Ç'është? — pyeti Xekua, duke u kthyer ngadalë si ari.

Rrapi Gjini iu ngërdhesh e i bëri me shenjë që të ulej.

Xekua u platit në tokë ndonja njëzet metra përpara tyre.

S'ndihej asnjë zhurmë. Një degë pishë aty pranë lëshoi barrën e dëborës e pastaj, e lirë, u ngrit lart.

Me sytë të mbërthyer në një pikë, at e bir ishin përqëndruar dhe donin të dëgjonin se ç'po ngjiste rreth tyre.

Rrapi Gjini nuk e dinte se ç'ishin ata që po vinin në drejtim të tyre. Mbase fshatarë që shkonin të nxirrnin pishë në pyll. Sidoqoftë përvoja e tij prej kontrabandisti e kishte mësuar se masat mbrojtëse nuk ishin kurrë të tepërta.

— Të kthehemi! — tha Ndrekuja duke e shikuar të jatin me ngulm.

— Shët! Rri aty e mos folë!

Rrapi Gjini e dinte se s'kishin nga të shkonin. Ai ledh dëbore mbaronte disa metra më tutje, dhe prapa tij qe vetëm e përpjeta e malit. Në atë dëborë ata do të ishin si shenja të zeza në një fushë të bardhë. Kurse pylli më të djathtë ishte mjaft larg. Ai, me lëvizje të shkathëta e të matura, u lirua nga arka që mbante në krahë. U orvat ta mbulonte me dëborë, kur veshi i zuri këto fjalë:

— Sa vetë ishit?

Si duket të panjohurit po pyesnin Xekon.

Kjo i ndolli Rrapit diçka të keqe. Po të ishin fshatarë, s'kishin pse të pyesnin. Ai mbajti vesh të dëgjonte se si do të përgjigjej Xekua, por nuk dëgjoi asgjë. Xekua duket fliste shumë ngadalë.

— Ju ishit tre. Unë ju pashë mirë.

—

— Ka të tjerë pas jush?

At' e bir u shikuan sy ndër sy. Ishte e kotë të fshiheshin, i kishin kuptuar. Rrapi Gjini tundi kokën, sikur çdo gjë të kishte marrë fund atë çast.

— Jani! — i tha ai të birit. — Jani Kripa, e njoh nga zëri. Keq e kemi punën. . .

Ndrekua u rrëngqeth dhe e shikoi të jatin me përgjërim.

— S'kanë ku të fshihen! . . — u dëgjua një zë pak i ngjirur.

Ndiheshin hapat që kërcisnin në dëborë. Sipër ledhit të dëborës, ku kishte qëndruar Rrapi Gjini me të birin, u duk një kokë. Rrapi u ngrit menjëherë në këmbë. S'donte që armiku ta gjente të struktur.

— Ku e ke kontrabandën? — e pyeti Jani.

— S'kam kontrabandë, shkoj për vizitë.

Ai kishte dalë i tëri në skarpatin e përroit prej dëbore e dukej si një statujë ogurzezë. Automatikun e mbante në duar. Djalit iu duk ndryshe nga ç'e kishte njohur përpara. Veç vetullave, të cilat i kishte pasur kaleshe e të dëndura, tani i ishin rritur edhe qimet e mjekrës e të mustaqeve, dhe gjithë fytyra, me përjashtim të syve e të hundës, dukej e mbuluar me lesh. Vështrimi i syve ngjyrë ulliri i

ishte bërë më depërtonjës e më i egër.

Qe veshur me një xhaketë shajaku të punuar trashë në avlëmend dore dhe me një palë çorape prej lesh dhije, prej nga dilnin në të gjitha drejtimet ca qime të ashpra. Mbi opingat e lëkurta koklat e dëborës ishin mbledhur nëpër qimet si rruzuj të vegjël të bardhë. Ndrekos gjithë figura e tij i ngjau me një vemje të madhe leshtore, e cila nga çasti në çast do të hapte gojën e do ta gllabëronte.

Duke e vështruar gjithë urrejtje, Rrapi Gjini e hodhi sërish arkën në krahë.

— Ku do të na shpiesh? — e pyeti Xekua.

— E di unë... — iu përgjegj Jani.

U nisën për rrugë. Aty më tutje, mbi një shkëmb, Ndrekos i zunë sytë një partizan tjetër me gjyslykë. Ai hukaste duart dhe përplaste këmbët që të ngrohej. Kokën e kishte kërrusur midis shpatullave dhe kontrabandistët i shikonte me një sy të ftohtë e indiferent. Nga sa dukej ata ishin nisur për në tjetër vend, po për shkak të kontrabandistëve duhej të ktheheshin sërish në fshat.

Ecnin mbi dëborë si një kope, pa patur kujdes të shkonin në gjurmat e njëri-tjetrit; kjo tani s'kishte asnjë kuptim. Ata bile as që e vinin re se rrugën po e çante kushdo vetë, dhe prapa tyre mbeteshin shumë vrraga. Rrapi Gjini e dinte se po shkonte në një rrugë pa kthim. Ecte rëndë e pa shikuar njeri, Ndrekos i erdhi çudij se sa mirë e mbante veten i ati. Duke e shikuar fytyrën e tij që të kujtonte një shqiponjë, iu duk si një i huaj që e shikonte për herë të parë. e me të cilin s'kishte të bënte. Ndjeu

se për të nuk i vinte keq, dhe kjo sikur e dëshpëroi.

— Jani, ku do të na shpiesh? — e pyeti Xekua sërish.

Jani e shikoi shtrembër e nuk iu përgjegj.

— Po a e di që jemi tanët, more Jani?

— E di...

— Aman, Jani, mos na shpjer atje. Të të vijë keq për ne të shkretët. Nga halli e bëjmë...

— Ecë, mos më pengo!

— Hera e fundit kjo. U thashë edhe këtyre që rrugës. Në më pafsh më, vramë me dorën tënde. Po mos më shpjer atje, më vjen turp t'i dal përpara djalit...

Jani s'fliste. Shikonte përpara dhe ecte rëndë.

— Ja, t'i hedh këtu në dëborë shojet? T'i hedh të venë në djall dhe lermë të iki... Lermë, Jani, mos ma bëj këtë të keqe!

Nga mënyra se si fliste e se si lutej Xekua, Rrapi ndjeu neveri për shokun e tij. I shkoi pranë, e kapi për mënge dhe e shau:

— Kujt i lutesh, mor budalla!

Xekua e hoqi menjëherë mëngën me frikë, duke e shikuar Rrapin me tmerr, sikur ta kishte zënë vetë vdekja.

— Ikë, mos m'u afro, se ti më more në qafë...

— Ta kam thënë njëqind herë, ty dhe të tjerëve: «Dy vdekje s'ka, dhe nga një nuk shpëton dot!»

Partizani që kishte ftohtë, u gjallërua menjë-

herë nga kjo shprehje që dëgjoji dhe iu afrua Rrapit.

— Si, si e the atë fjalë?

Rrapi e përsëriti.

— Shprehje e bukur, — tha partizani. — S'e kisha dëgjuar ndonjëherë. «Dy vdekje s'ka, dhe nga një nuk shpëton dot!»

U largua anash, nxori një blok të vogël dhe me dorën që i dridhej nga të ftohtit shënoi diçka me laps. Rrapit i vajti mendja se ky do të ishte ndonjë mësues, ose student, sepse edhe pushka nuk i qëndronte mirë në sup. Ai e mbante pushkën pa kujdes, sikur dikush t'ja kishte varur në sup rrasësisht.

«Kaqë e patëm! — mendoi Rrapi Gjini. — Këtë herë më duket se morën fund të gjitha. Ç'm'u desh që e mora me vete? Ah, sikur të mos e kisha marrë. Për vete s'më vjen keq, veç djalin të mos e kisha marrë. Po sikur t'i lutem: «Ierma djalin, mua vramë, atë liroje se s'ka faj?...» Kot që t'i them. Nuk do të më dëgjojë. Dhe pastaj kujt t'i lutem, armikut tim? S'e bëj kurrë këtë punë, nuk do ta poshtëroj veten në sy të atij horri. Le të marrë fund. Zëre se djali do më ishte vrarë në luftë. Kë do vrasin të parin, atë apo mua? Po na çuan në gjyq, unë do të them: «Djali s'ka faj, unë e mora në qafë». Si të vogël, mbase edhe mund ta falin. Sikur ta falin, hë, sa mirë do të jetë. S'besoj se do të na çojë në gjyq ky qimederri, ka për të na vrarë rrugës...»

Nuk dinte si të bënte. Nuk donte t'i lutej hasmit të tij, por as nuk i dukej e udhës ta linte t'ja

vrisnin djalin kot, kur ndofta me një fjalë mund ta shpëtonte. I dukej se krenaria që po rrëfente s'kishte asnjë kuptim. Më shumë se çdo gjë tjetër atë e trembte mendimi se armiku i tij s'kishte për ta dëgjuar, dhe kjo ishte më e keqe se vetë vdekja.

Xekua mezi merrte frymë nga të qarët dhe kolovitej sa nga njera anë, në anën tjetër.

Në fytyrën e Ndrekos tmerri kishte lënë vulën e tij. Muskujt e fytyrës e kishin humbur tonusin e tyre, ato qenë lëshuar e për këtë arsye sytë i dukeshin më të mëdhenj, të ngrirë e të përhumur. Pesha që mbante në kurriz dhe gjithë ajo rrugë i dukej fare pa kuptim e si makth. Ç'kuptim kishin ata dy partizanë anash dhe këta mes tyre? Përse ngjiste gjithë kjo? Ai pylli që dukej atje tej pse ishte ashtu i zi? Ishte ëndërr kjo apo e vërtetë? Priste se nga një cast në tjetrin do të zgjohesh e atëhere do të merrte frymë lirisht. Po kjo nuk ishte ëndërr. I ati iu afrua pranë dhe i foli me një zë pak të dredhur po mjaft të fortë, që ta dëgjonin të tjerët:

— Atë lopën blijeni te Seiti. Mos e lini. Meri dajkos ca para dhe ja lani më vonë.

Ç'kuptim kishin këto fjalë?

— Cacit jepjani ato tridhjetë napolona kartë. që i kam marrë borxh. I thuaj dhe se... jo, jo, mos i thuaj gjë. Tjetër njeriu s'i kam borxh. Ata që më kanë mua, në t'i dhënçin, mirë, në mos t'i dhënçin, ti mos ua kërko. Dëgjove?

Ndrekuja e shikonte dhe s'po kuptonte gjë. Derisa të dy po shkonin drejt vdekjes, si ishte e mundur që

të kthehej e të përmbushte porositë? Deshi të fliste, po i ati e ndaloi.

— Merreni lopën, mos rrini pa lopë.

Jani Kripa e dëgjonte. Kuptoi se këto ishin amanetet e fundit që Rrapi Gjini i linte të birit. E kuptonte edhe pse ja linte të birit porositë. Tërthorazi i thoshte që djalin nuk duhej t'ja vrisnin. Jani e dinte se atij ja kishin marrë italianët të gjitha bagëtitë, dy qetë, demat dhe viçat e vegjël dhe s'i kishte mbetur në haur asgjë e gjallë.

— Kështu, si të thashë, — vazhdoi Rrapi, — ti, më mirë kthehu që tashti në shtëpi.

Ndrekua ngurroi.

— Kthehu, kur të them unë! — tha Rrapi Gjini.

Ndrekua ktheu sytë nga Jani.

— Këtu urdhëroj unë dhe jo ti! — i tha Jani duke e vështruar me egërsi. — Ecë përpara!

Ata ecën përpara.

«S'do ta lëshojë, qeni. Do të na qërojë të dy njëherësh. Bëra mirë që s'iu luta». Pastaj u këthye nga djali.

— Ke frikë? — e pyeti.

— Më vjen keq... — tha Ndrekua.

— Mos ki frikë, ty nuk do të të bëjnë gjë...

— Mamaja do të qajë, më vjen keq për të... —

Ndrekos i rrodhën lot në faqe.

— Mos qaj, është turp të qash! Ti, djali im! — tha Rrapi ngadalë. — Ata nuk do të bëjnë si thotë ky.

— Rrapi Gjini, të është mbushur kupa. Plumbi të pret, të ta them unë.

— Gjete rastin të marrësh hak. Merre! S'pres mirë nga ti.

Ishin afruar te kisha e Shënmërisë. Kupola e saj e vogël shkëlqente në diell. Matanë kishës Rrapi e dinte se ishte një përrua dhe një urë e vogël prej druri.

Xekua u kthye nga Shënmëria e u fal, duke murmuritur një lutje nëpër dhëmbë. Pastaj ktheu kokën nga Jani e iu lut:

— Aman, more Jani, lëshomë. M'u prenë gju-njët, s'eci dot më tutje. Lermë të vete në shtëpi e, po dola më nga shtëpia, vramë me dorën tënde...

Jani s'ja vuri veshin, ai vazhdoi rrugën. Po afroreshin te ura. Nga parmakët e saj të drunjtë vareshin qirinj akulli. Përposh urës, midis dy buzëve prej akulli, ujët vazhdonte të rridhte tatëpjetë.

— Reshit, eja pakë këtu! — tha Jani.

Të dy partizanët bisedonin me zë të ulët dhe Ndrëkua, që ishte afër tyre, s'mundi të dëgjonte gjë tjetër veç frazës «inat personal», që u përsërit disa herë.

— Ashtu them edhe unë! — tha Reshiti me zë të lartë në fund të bisedës së tyre.

Në fytyrën e Ndrëkos shkëlqeu një rreze shprese; kjo zgjati vetëm pak dhe duket se qe e parakohshme, sepse kur vajti te ura, Jani Kripa u dha urdhër të qëndronin. Pastaj, me gjakftohtësi i uli grykën poshtë automatikut dhe i hoqi sigurecën. U ndie një krismë e vogël, e cila i bëri të rrënqetheshin të gjithë.

«Këtu do të na vrasë, mendoj Rrapi. As në gjyq

nuk do të na çojë, se ka frikë mos na lirojnë».

— Dëgjoni këtu! — tha Jani Kripa. — Me këtë shokun vendosëm t'ju lirojmë pa iu shpënë fare në gjyqin partizan. Po ju çuam atje, e dimë ne se ç'iu pret. Zhdukuni tani, dhe të mos u shohim më nga këto anë!

Rrapi Gjini bëri dy hapa përpara.

— Je dhelpër, po mua s'ma hedh dot. Do të na qëllosh prapa krahëve e të thuash pastaj: «i vrava se deshën të arratiseshin...» Ne nuk ikim. Na shpjer përpara gjyqit!

Jani u ngërdhesh e, duke shtrënguar nofullat, bërtiti:

— Ikni! Zhdukuni!

Atë çast Xekua filloi të vraponte si i çmendur. Kapërceu urën me një frymë dhe iu drejtua pyllit, duke ecur me këmbë e me duar nëpër dëborë. Ndrekuua mbeti mbi urë. Shikonte Xekon që vraponte në drejtim të pyllit dhe babanë që po grindej akoma me partizanët.

— Ti do të qëllosh. Unë të pashë që ule sigurecën.

— Do të qëlloj, — i tha Jani, — do të qëlloj në erë...

— Gënjen, të njoh mirë, gënjen. Mua vramë, s'më vjen keq, djalin mos e vra...

Reshiti iu afrua Rrapit e i tha më zë të butë:

— Ikë, more budalla, se s'të vret njeri. Ikë, kur të them unë.

Rrapi Gjini me hap të rëndë e të qetë çau dëborën. Kur vajti deri në mes të urës, dëgjoi shkrehjen e automatikut dhe pas një çasti jehonën që nga pylli ta-ta-ta-ta!

Ai ktheu gjoksin e bërtiti:

— S'është burrëri prapa krahëve. Qëlllo, po deshe!
Por i erdhi turp dhe inat nga vetja e vet, kur pa se Jani Kripa e mbante tytën e automatikut në drejtim të kundërt të Rrapit dhe qeshte.

* * *

Mbanë pyllit Xekua qëndroi të çlodhej e të prishte shokët.

— Shpëtuam më duket, — tha duke marrë frymë thellë. — Bobo, për pak vdiqëm!

Ai ecte pa u kujtuar fare që dengun me shuaj po e mbante akoma në kurriz. U kujtua vetëm kur u pengua pas një brëdhi.

— Po këto ç'djall i mbaj më krahë? — tha me ankim e duke i zgjidhur litarët e hodhi dengun në dëborë.

— Pse i hedh? — e pyeti Rrapi.

— I hedh, e s'dua t'i shikoj më me sy...

— Shiko, more Xeko, këto s'janë malli ynë. Do të t'i kërkojë Xhezat beu e do të gjesh belanë.

— Ç'thua, more, je në vete ti apo jo? Këtë që hoqa sot, edhe varrit do t'ja tregoj. S'bëhem merak as për Xhezat be, as për Kapllan be. Atje i ke, do t'i them, po ta mbajti shko i merr. Po ai s'vjen vetë këtej, se ja bëjnë kokën barabar me supet...

— Do të të fusë në burg.

— E po unë s'kthehem me këto në fshat, që të më zënë rojet e financës.

— Mirë thotë, baba, t'i hedhim e t'ja mbathim për në shtëpi.

— Po këto kujt t'ja lemë? Janë mall, more djallë, s'janë një krahë dru që mund t'i lesh në mes të rrugës...

I biri e dinte se të jatit në fshat i thërrisnin «mushkë», po gjithmonë kishte menduar se kjo ishte një nofkë që i kishte mbetur nga koha kur punonte si qiraxhi, kurse tani po e kuptonte se arësyeja e vërtetë ishte ndryshe.

— Edhe ti, Xeko, ke hak, se me këto në krahë nuk kthehem dot... — U duk sikur Rrapi bëri kthesë, po kjo zgjati vetëm pak kohë, sepse ai shtoi: — Ja, si të bëjmë, them unë. T'i fshehim dhe pas dy-tri ditëve vijmë përsëri. Po t'i fshehim mirë, s'na i gjen njeri.

Ai ngriti kokën e shikoi rreth e rrotull. Pylli i djegur kishte një pamje fantastike e përrallore. Mbi trungjet e degët e zeza, që kishin mbetur akoma më këmbë, dëborë kishte hedhur petkun e saj të bardhë dhe kontrasti që me të vërtetë mahnitës. Dukej sikur drurët e zez kishin vënë gëzof dhe këpucë të bardha, për t'u mbrojtur nga të ftohtit.

— Kështu do të bëjmë! — tha Rrapi i vendosur.

— Bëj ç'të duash, unë as që i zë me dorë... — tha Xekua me mospërfillje dhe u nis përpara.

Ndrekua e ndihmoi babanë, pa qejf, ta fshihnin kontrabandën në një guvë.

— Mbaje mend këtë «Pyllin e Djegur»! — porositi i ati.

Ndrekua pohoi me kokë.

—Më duket si ëndërr, — tha Xekua. — Na liroi.

— E pra.

— Mua sikur ma ndjente zemra. S'më bënin këmbët, qëkur u nisa. . .

Ti paskëshe qenë shumë frikacak!

— Pse, shaka i thonë? Ikë, more tutje, ç'më duhej trimëria atje, apo që të haja ndonjë plumb kokës?

Xekua ishte në qejf, e vazhdonte të fliste. S'i mbante mëri asnjërit, dhe as fyerjeve që i bënte Rrapi, nuk ua vinte veshin.

— Pse s'na vräu, thua ti, Rrapi? S'ma merr mendja se i erdhi keq, do të ketë diçka në këtë mes. . .

Ndrekua gjithë rrugës s'kishte folur. Kjo pyetje e kishte munduar vazhdimisht edhe atë, e kur e dëgjoi nga goja e Xekos, qëndroi menjëherë që të dëgjonte si do të përgjigjej babai.

— S'e vras mendjen unë për atë punë. . . Mjaf-ton që shpëtova. Tani s'do t'i vete më si cjapi te kasapi.

Te «Tre bredhat» Ndrekua e pyeti:

— Po sikur të ishte ti baba në vend të tij, ç'do të kishe bërë?

Rrapi qeshi duke e shfrytë ajrin nga hundët.

— Hëm! Të isha unë në vend të tij? E dija unë se ç'do të bëja.

Nga sa dukej, Rrapi s'e priste këtë pyetje dhe e quajti fare pa vend të jepte një përgjegje se iu duk e kotë. Një pyetje të tillë as që duhej ta bënte njeriu.

Derisa vajtën në fshat, Ndrekuja s'e hapi më gojën.

* * *

Më të ngrysur hynë në shtëpi. Ndrekuja hyri brenda e mori një fshesë që të hiqnin dëborën nga rrobat. Rrapi u ul në prak të derës, nxori këpucën dhe, duke e përpjekur pas murit, mundohej të shkundte dëborën.

— Na vajti gjithë rruga kot — tha plaku.

— Unë them duhet të merremi me diçka të ndershme, baba.

— S'ka punë të ndershme. Ta thashë qëpari unë atë.

— E do fshesën?

— Nëma këtu! — Ai filloi të fshihej, duke u rënë me forcë pantallonave, ku dëborja ishte ngjitur pas fijeve të leshit.

— Kështu them unë, pasnesër të nisemi që me natë.

— Ku të vemi?

— Atje ku fshehëm plaçkat; ku gjetkë?!

I biri përcolli pështymën e uli kokën. Deri atëhere s'i kishte kundërshtuar babait kurrë.

— Baba! — tha ai kokulur, — unë s'vij.

— Pse?

— Nuk vij më.

— E prisja këtë! — tha plaku rreptë.

— S'dua të merrem më me këtë punë, — tha Ndrekuja i vendosur.

— Frikacak! Ti i ke ngjarë mamasë, e ke zemrën si të pulës. Të vura re që u trëmbe shumë.

Po të pasnesërmen ngjau diçka që Rrapi s'e priste kurrë. Djali iku partizan dhe shkoi po në atë çetë ku ishte edhe Jani Kripa.

ATË DIMËR

Petër Priftit

Ne kurrë s'kishim parë fëmijë aqë të dobët. Ai erdhi e qëndroi mbanë fshatit, pranë mullirit të Kolineve. Ndofta s'kishte fuqi të shkonte më tej, ose ndofta mendoi të flinte atë natë atje, nën pemët e larta e të nesërmen të nisej sërish për rrugë, gjersa të arrinte në atë vend ku njerëzit flisnin një gjuhë tjetër nga ajo e vendit të vet.

Atë e ndiqte nga pas uria si një kafshë dinake dhe, për t'i shpëtuar asaj, ai linte prapa lugina, pyje, qafa malesh, kapërcente përrenj të rrëmbyer malorë e shkonte gjithmonë drejt Veriut, pas gjurmëve të të uriturve të tjerë. Më të mëdhenjtë e arrinin në udhët e ngushta malore dhe po në rrugë e linin, sepse hapat e tij ishin të vogla, ndërsa ato të urisë të mëdhaja.

Dhe ai zvarriste këmbët pas atyre pa u shqetësuar nga mospërfillja. E dinte se të nesërmen grupe të tjerë njerëzish do ta arrinin në rrugë e do ta linin mbrapa, ashtu si të parët, po tani ishte mësuar me këtë gjendje dhe s'i bënte shumë përshtypje.

S'i bënte përshtypje as kur të trokiturat e tij nëpër porta të ndryshme mbeteshin pa përgjigje; këto porta ai me mend i quante «memece» dhe ishte më i kënaqur kur s'i përgjigjej kush, se sa atëhere kur të zotët e shtëpisë e përzinin duke i thënë fjalë të vrazhda. Kjo e dëshpëronte shumë djalin e vogël. Ishte një gjendje tepër e hidhur. Bukë s'të jepte askush. Gati të gjithë të përcillnin me të njëjtat fjalë: «Ne s'kemi për vete. Shko më tutje, mbase ata të japin».

Zia e bukës shtynte, në dimrin e vitit 1944, me mijëra grekë të uritur drejt tokës së Shqipërisë. Lufta i kishte shkatërruar kufitë, ashtu siç kishte shkatërruar edhe ekonominë. Njerëzit e kapërcenin vijën e kufirit pa iu nënshtruar asnjë kontrolli. Në Greqi gjendja vazhdonte të ishte e keqe dhe zia e bukës bënte kërdrinë. Grupe të vegjël refugjatësh iknin nga vendlindja dhe drejtoheshin në vendet fqinje a ku t'i shpinin rrugët e fatit. Ata ishin refugjatë të trishtuar, të verdhë, të leckosur e trokisnin nëpër dyert e një vendi të huaj me ndrojtje e turp, dhe dukej hapur se s'e kishin për zanat atë punë aqë të vështirë. Ata s'kërkonin as tokë, as fshatra, as qytete, kërkonin vetëm bukë. Dhe nga shtëpitë e kasollet shqiptare, qindra e mijëra duar nënash, ditë për ditë, lëshonin me bujari në pëllëmbët e thata të refugjatëve, atë send aqë të zakonshëm e aqë të çmuar, që mban emrin bukë. Të japësh bukë s'është e lehtë, por nënat tona e dinin mirë se, të kërkosh, është akoma më e vështirë.

Disa syresh përpiqeshin të bënin një tregëti të ndershme, dhe sillnin vaj e ullinj në ca kaçupë lë-

kure. Vajin dhe ullirin i këmbenin vetëm me drithë ose me miell; paraja s'hynte në punë. Po këta ishin të paktë; të shumtët e refugjatëve s'kishin asgjë me vete, përveç një thesi të zbratur nën sjetull.

Ne, që ishim afër kufirit, i shikonim ata kur vinin grupe-grupe në vendin tonë; i shikonim pas-taj edhe kur iknin drejt vendit të tyre, të kërrusur nën peshën e trishtuar të asaj ngarkese. Ata karvanë refugjatësh, duke përshkuar njërin fshat pas tjetrit, duke kapërcyer njërin mal pas tjetrit, arritën deri në Durrës.

Ata kalonin në jetën tonë duke sjellë me vete brengën e një populli të tërë, po në zemrat tona prej fëmije, fatkeqësia e tyre mbetej diçka e huaj, e pakapshme dhe ne i shikonim pa vëmendje, ashtu siç shikon njeriu muret e rrugës së vet. Mjerimi i fëmijëve ndryshon nga ai i të rriturve. Ne këtë e kuptuam atë pasdite, kur një grek i vogël qëndroi nën arrat e larta të mullirit të Konines, pranë vijës së ujit. Ai dukej, sikur mbi supet e tij të imta, kishte sjellë ngarkuar mjerimin e të gjithë fëmijëve grekë.

S'kishim parë kurrë fëmijë aqë të dobët; këmbët e duart i kishte të holla si kleçka, sytë të mëdhenj pa shkëlqim dhe buzët të zbeta. Lëkura e tij qe e thatë, e për çudi në ngjyrë të hirit. Koka mezi i qëndronte mbi qafën e hollë e dukej si diçka e huaj në atë trup të vogël. Këpucë s'kishte. Trupin e kishte mbuluar me një këmishë liri të hapur përpara dhe me një palë pantallona të grisura te gjunjët. Gjunjët i kishte çuditërisht të mëdhenj.

I huaji nuk trokiti në ndonjë portë sepse, du-

ket, e pandehte veten, akoma në fshatrat greke dhe i pëlqente më tepër të jetonte si të mundej, se sa të dëgjonte fjalë të vrazhda. Mulliri në atë kohë nuk punonte, dhe djalit kjo nuk i bëri asnjë përshtypje, sepse kohëve të fundit ai kishte parë vetëm mullinj të heshtur. Por ai e pëlqeu këtë vend. Sipër arrave dhe nëpër pemët aty afër, zogjtë cicërinin duke e përzjerë këngën e tyre me atë të jazit të mullirit. Nga koha në kohë, disa laraska fluturonin nga çatitë e shtëpive nëpër pemë duke krakaritur me shëmti. Nga malet e Gramozit vinte shushërima e ujrave të përrenjve, që rridhnin tatëpjetë, duke e mbushur ajrin me një uturimë të përhershme e të pambaruar.

Lufta për ekzistencë e kishte mësuar djalin si të vepronte. Ai mblodhi disa shkarpa e karthije, i vuri njerën mbi tjetrën si të donte të bënte zjarr, pastaj ngriti kokën lart nga pemët, ku zogjtë këndonin të shkujdesur dhe filloi të shikonte me vëmendje. Nxori nga gjiri një llastik e, duke qëlluar disa herë, në pak kohë vrau dy laraska e një rabeckë. Deri në atë kohë praninë e tij gati s'e kishte vënë re askush. Vetëm kur zuri t'i shpuploste laraskat, disa fëmijë të vegjël iu afruan dhe po e vërenin me çudi. Edhe ne e lamë lojën përgjysmë dhe iu afruam pranë. Ai vazhonte punën e tij i qetë dhe, kur iu duk se i kishte rjepur mjaft, i shkoi në një hell të vogël. Çdo gjë e bënte ngadalë, i matur dhe ne as që na vinte re.

Në rrinim të heshtur pranë tij dhe ndiqnim me kujdes çdo lëvizje, si të kishim para një prestigjator. Vallë, ç'kishte ndër mend të bënte ai? Mos donte t'i

piqte e pastaj t'i hante? Kjo ishte e pabesueshme. Laraska dhe rabecka të pjekura ne s'kishim ngrënë kurrrë dhe as që kishim dëgjuar se ato mund të hareshin... Kureshtja na shtynte t'i qëndronim pranë e të prisnim se çdo të bënte me to moshatari ynë i heshtur, me lëkurë ngjyrë hiri.

Vumë re se pa u pjekur mirë, ai u ul në bisht, afroi te goja hellin dhe zuri ta brente me uri mishin e laraskave. Dhe hante duke na shikuar me frikë, si një këlysh që trembet se mos ja rrëmbejnë koskën që lëpin. Gjergji, që ishte pranë meje, luajti nga vendi, dhe greku i vogël e fshehu menjëherë pas kurrrizit laraskën e përcëlluar.

— U tremb, e shikon?

— Ka frikë se mos ja rrëmbesh.

Gjergji bëri dy hapa prapa dhe ai filloi të hante sërish, duke hedhur vështrime të frikshme rreth e qark. Duart e vogla e të thata ngjisnin çuditërisht me këmbët e zogut, mishin e paktë të të cilit po e shqyente me uri.

Kureshtja pak nga pak, ja lëshoi vendin dhembjes. Ai dukej sikur solli atë çast mjerimin e të gjithë fëmijëve të uritur grekë, dhe trishtimi u nder në fytyrat tona.

Deshëm t'i thonim dika, po s'dinim nga t'ja fillonim e për çfarë të flisnim.

— Kushedi qëkur s'ka ngrënë bukë! — tha Gjergji.

E mposhtëm ndrojtjen e filluam ta pyesnim, po ai s'dinte asnjë fjalë shqipe dhe gjithë pyetjeve tona u përgjigjej duke ngritur supet e tij të dobëta.

— «Psomi, psomi. Thelis psomi?»¹⁾ e pyeti Gjergji.

Greku u mundua të buzëqeshte dhe një sërë rru-dhash iu formuan në të dy çipat e gojës. Vallë, a mund ta besonte një lumturi të tillë? Ne u shpërndamë nëpër shtëpitë tona duke vrapuar. Donim kush e kush t'ja sillte bukën më parë.

Unë, ngaqë e kisha shtëpinë më afër, u ktheva i pari. I zgjata bukën. Ai më shikoi në sy, si të donte të provonte sinqeritetin tim e pastaj shikoi copën e bukës. U ndrojt. Mbase nuk i besohej një gjë e tillë. Ja lashë bukën mbi kthis dhe u largova. Ai e rrëmbeu menjëherë; e zuri copën e bukës me të dy duart, si të kishte frikë mos ja merrnin sërish dhe, duke futur kokën midis supeve të tij të ngushta nisi të hante me uri.

Në çast erdhën edhe fëmijët e tjerë. Ata ja zgjatnin copat e bukës dhe ai, ndërsa me një dorë hante, me dorën tjetër mblidhte coprat me shpejtësi e i fuste nën këmbë duke na shikuar të gjithë me radhë, ndërsa sytë i shndrisnin, nga kënaqësia.

Mësuam se e quanin Dhemosten.

Ne ndjeheshim të lumtur. Asnjëherë s'kishim provuar ndonjë gëzim të tillë. Po këtë gëzim na e prishi xhaxha Koci. Ai i shpejtë si era me shi, erdhi u fut në mes të grumbullit tonë dhe i hoqi bukën nga dora grekut të vogël. Djali u mblodh si iriq. Mëria jonë arriti kulmin, kur pamë se ja mori edhe të gjitha copat e tjera të bukës, të cilat shoku ynë i largët i

1. Bukë, bukë. A do bukë?

kishte fshehur nën këmishë. Në sa s'po qanim nga inati.

— Hë mo, ç'ke? Pse ja merr bukën? — i tha Gjergji.

— Si s'të vjen pak keq.

— Pse, buka jote është? — i tha Petrua, që ishte në krahun tim.

Xhaxhi Koci filloi të nxehej dhe na bërtiti:

— Ikni, shporruni! Shejtanër! Zhdukuni, të mos jua shikoj sytë!

Ne s'dëgjonim të iknim. Vinim rrotull atje pranë mullirit dhe e shikonim me mëri Kocin, që i rrëmbeu bukën Dhëmostenit të uritur. Edhe shoku ynë i largët ishte topitur nga ajo e papritur, ai po e shikonte me frikë dhe me urrejtje njeriun që i rrëmbeu bukën nga duart.

Për çudi, Koci i zgjati dorën dhe i tha të shkonte me të. Shoku ynë në fillim hezitoi, po pastaj i dha dorën e tij të hollë. Ne e shikonim me habi. Vallë, ç'kuptim kishte kjo? Ata shkonin rrugëve të katundit, dhe ne i ndiqnim pas me kureshtje. Ku do ta çonte Dhëmostenin Koci dhe pse e mori përdore, kur pak më parë i rrëmbeu bukën? Apo mos vallë u pendua dhe do t'i jepte tjetër? Koci diç mundohet t'i thoshtë grekut të vogël, ndërsa ai s'arrinte ta kuptonte. Greku kthente kokën nga ne, sikur t'i vinte keq që e kishin ndarë nga grigja jonë. Ai me ata sytë e tij të zbetë dukej sikur na lutej për diçka e kërkonte ndihmë.

Koci e çoi në shtëpi të vet. Ne e përcollëm gjer te porta dhe pastaj qëndruam atje duke bërë zhur-

më. Nuk donim të iknim. As të sharat e të mallëkuarat e nënës së Kocit nuk na përzunë dot. Qëndronim atje duke pritur se ç'do të bëhej me mikun tonë të largët. Pas pak, xhaxhi Kocit duket i ra inati dhe doli te porta së bashku me Dhemostenin. Tani atij i kishte dalë frika. Qe tulatur pas dorës së madhe të Kocit, si pas një gjëje të butë e të ngrohtë dhe e përkëdhelte pas faqes. Në majën e mjekrës i kishte mbetur pak qumësht.

— Budallenj! — na tha xhaxha Koci. — Për pak e morët më qafë. Po ta hante ai gjithë atë bukë që i dhatë ju, me siguri do të vdiste. Të uriturve në fillim u jepet pak ushqim. Tani ky piu pak qumësht e pas pak do t'i jap edhe ca tjetër.

Dhemosteni e kaloi atë dimër në fshatin tonë. Ai u bë shok me ne, shok me lodrat tona.

TREGIMI I GJYSHES

Vjeshta po vjen me hapa të shpejta e të mëdha. Ajo ndihet tani kudo: bari është tharë, pemët po zhvishen dhe ajri është i freskët. Erërat e lindjes sjellin më vetë frymën e ftohtë të akujve dhe të dimrit dhe shtyjnë nëpër qiell copa të murme resh. Po tek-tuk qielli ruan pellgje të kaltra si kujtime të çmuara nga koha e verës.

Një degë e thatë kumbulle fërkohet papushim pas xhamit të dritares duke lëshuar një gërvimë të hollë e të përvajshme; Gërvima ngjet çuditërisht me cicërimat e një zogu të vogël që ankohet për diçka. Që nga dritarja duken pemët e oborrit që përkulen nga era, çatitë e shtëpive dhe plevicave të fqinjëve mbuluar me pllaka guri, qielli me re të grisura dhe më tej akoma malet e larta.

Fryn erë, vërshëllima e saj herë bëhet e fortë, herë platitet. Njerëzit e shtëpisë janë mbledhur në sobën e dimrit, ku nëna ka ndezur zjarrin dhe secili merret me diçka. Soba është e ngrohtë, e pastër, e qetë dhe s'të vjen të besosh se përjashta bën me të vërtetë ftohtë.

Babai rri në minder, me kurrizin mbështetur pas

murit dhe shfleton ngadalë faqet e një libri të trashë, gjyshja është ulur mbi krevat, kanistrën me pala e ka afër vetes dhe po tjerr lesh, kurse mëma ka afruar karrigen në dritare dhe po qëron oriz. Unë sodis këtë pamje dhe më duket sikur shikoj një tablo pikturë me dimensione të mëdha, ku është shkrirë harmonia, jeta dhe poezia.

Është një nga ato pasdreket e qeta familjare, ku çdo gjë duket sikur ka ngrirë dhe ka mbetur pezull, rrethuar nga harmonia dhe dashuria. Njerëzit bien në njëfarë plogështie, sekush kridhet në punën e tij, ose në botën e kaluar të kujtimeve, dhe fjalët duken të tepërta e të zbeta. Ndërkohë, në dhomën e ngrohtë, ndihet kërcitja e zjarrit, kërnjallja e kënaqur e maces që fle e mbështjellë kutullaç, fërkimi që bën boshti duke u dredhur në pëllëmbët e gjyshes dhe kënga e kapakut të tenxheres që ngrihet e ulet prej avullit. Në ato çaste të duket se ngrohësia e vatrës shtrihet tejmbanë dhe sikur mbi gjithë botën ka rënë një qetësi e lumturi e pakufishme.

Çdo njeri në familjen e tij e ka shijuar qetësinë dhe ëmbëlsinë e këtyre çasteve.

Në një hop gjyshja, duke tjerrë mekanikisht, hedh vështrimin përjashta, shikon pemët e oborrit që tunden nga era dhe më tej malet e larta të Gramozit.

Era vinte që nga shpatet e malit dhe sulej poshtë luginës së Kolonjës drejt detit, ndërsa pemët dukej sikur i përkuleshin me nderim asaj mysafireje të ardhur nga vende të largëta e të ftohta.

Gjyshja mbeti një copë herë me vështrimin të

ngulur te pemët që lëkundeshin, e pastaj psherëtiti duke tundur kokën. Fytyra iu bë e menduar, dhe rrudhat sikur iu thelluan.

Unë e pyeta:

— Pse psherëtite, moj gjyshe?

— Kot, o bir, kot.

Pastaj sërish tundi kokën e sytë iu mbushën me lot. Nisi përsëri të tjerrë po këtë herë duart nuk i bënë për punë, e boshti vërtitej me ngathësi. Ajo lëshoi duart mbi prehër e tha:

— M'u kujtua ai, i ziu. Ja si në këtë kohë ka ikur...

Gjyshja nxori një shami nga brezi dhe fshiu lotët.

— Ja, kështu qe koha dhe atë ditë. Ishte vjeshtë dhe frynte erë. I ati s'deshi ta linte gjëkund, po ai iku fshehurazi. Ne atëhere s'kishim mbushur as katër muaj që ishim martuar. Si ishin dhe ato kohë! Sa mbaronim punët e beharit, futnim dhe misrat brenda dhe pastaj meshkujt nisëshin për në kurbet. Burrat e fshatit tonë shkonin në Mal të Shenjtë, atje ndërtonin manastire dhe kisha, ose mbartnin qereste. Ne, nusezat, mbeteshim në shtëpi, duke pritur me ankth sa të na ktheheshin burrat. Vjeshtës shkonin dhe Shën-gjergjit ktheheshin. Pa se mos ktheheshin gjithnjë? Kështu edhe asaj vjeshte, i erdhi koha për të shkuar dhe atij timit, iu ngrit mendja. Pa edhe shokët që u nisën e më s'i rrihej në shtëpi.

Një natë, tek hanim bukë, — ishte e shtunë mbrëma më duket, se kishim ndezur dhe kandilin e mirë — ai i tha të jatit.

— Unë javës tjetër them të iki, o baba.

Të jatit s'i erdhi mirë. E la lugën në sofër dhe e pyeti gjoja se nuk e kuptonte për ku e kishte fjalën.

— Ku?

— Në Agjion Oros, se e kemi lënë punën përgjysmë.

Kjo mbase ishte e vërtetë, se ai atë pranverë ishte kthyer nga Mali i Shenjtë, po plaku e kundërshtoi.

— Ti më the se e kishe qeruar llogarinë.

— Unë kur ika e qërova llogarinë, — ja ktheu ai, — po epistrati i Ruskos m'u lut që në vjeshtë të kthehesha sërish.

— Jo, — i tha plaku, — lëre mënjanë epistratin. Ti sivjet sapo u martove, ç'domethënë kjo të ngrihesh e të shkosh?

— Po ja, edhe Gaqi sivjet u martua...

— Ti nuk do të shkosh këtë dimër. Gaqi s'ka ç'të hajë, kurse ne, shyqyr zotit, s'jemi në atë gjendje. Bukën e vitit e kemi bërë dhe ca bulmet e kemi vënë mënjanë.

— Më vjen rëndë t'i dal nga fjala...

— S'ka pse të të vijë rëndë. Dëgjove? Dëgjova, thuaj, dhe këtë muhabet të mos e bëjmë më.

Ai s'ja ktheu as mirë, as liksht.

Kur pas ça ditësh, e shikoj unë, vajti në sënduk e po nxirrte rrobat një nga një. Unë s'guxova t'i thosha gjë atij, po vajta me link te Babo Plaku — se kështu e thërrisnin vjehrrin.

— Ai po niset... — i thashë me nxitim, pa ja zënë ngoje emrin, se më vinte turp.

— Si po niset? — pyeti Babo Plaku duke ngrysur vetullat. — Është në vete ky djalë?

U ngrit, vajti në odën e mirë, ja mori rrobat nga duart dhe i kyçi në sënduk të vet.

Pas ndonjë jave, Babo Plaku vuri qetë përpara dhe shkoi në Blanjë për të bërë ugar. Kishte marrë me vete edhe të mjerën Magdhi — çupën e tij. Nga nxitimi edhe sëndukun e kishte harruar hapur. Im shoq e vuri re. Sa iku Plaku, ky erdhi së jashtmi, i nxori rrobat, i futi në hejbe e më tha:

— Moj, (se dhe atij i vinte turp të më thërriste me emër) — unë do të iki sot.

Mua sikur më ra pika, nuse e re, sa isha martuar, mirëpo më vinte turp t'i lutesha të rrinte; pastaj edhe s'i dilja dot përpara, se ai ishte burrë e ai urdhëronte. Megjithatë me sy ulur i thashë:

— Qysh do ikësh kështu, papritur. Me tët atë nuk do të takohesh?

— Jo, — tha, — se ai s'më lë.

— Po si, pa marrë uratën e tij do nisesht ti?

— S'kam ç'të bëj. Unë duhet të iki. . .

— Si t'i dal unë përpara tim vjehri, kur të kthehet në darkë? Ç't'i them?

— Ç'do t'i thuash! Hiç, asgjë mos i thuaj. Iku, i thuaj, s'më pyeti mua.

S'dija nga të vija. Kisha mbështjellë ca kos. E zbulova dhe i thashë:

— Merr, ha ca bukë.

Mori vetëm një majë luge, sa lagu buzët, pastaj tha:

— I ëmbël qënka, po mua s'më hahet.

Pastaj u ngrit e vajti nga xhaxhai, nga Mitraqi.

— Unë them të iki, o xhaxha. Ti si thua?

— Ikë, — e këshilloi xhaxhai. — Ç'do të bësh në dimër këtu? Sa të vërtitesh kot nëpër këmbët e grave. Shko, nxirr ndonjë para andej, ke mundësi t'i dërgosh dhe shtëpisë gjë a gjë.

Mori uratën nga xhaxhai. Erdhi në shtëpi. nxori mushkën nga patozi dhe nisi ta ngarkonte. Unë me të mjerën time më, e përcollëm gjer në Ramje. Ja, frynte erë kështu si sot. Kjo më kujtohet gjithnjë, se kur u ndamë dhe kur po ktheheshim për në shtëpi, unë ecja pas Nukos dhe qaja. Ajo kthehej herë pas here e më thoshte:

— Ç'ke që qan, moj budallaçkë, ja, erdhi qershori dhe ai sikur është kthyer...

— Nuk po qaj, i thoja unë, po më lotojnë sytë nga era...

U ktheva në shtëpi e s'dija ku të vija. Shtëpia më dukej e errët dhe e zbrazur. Me duart në gji u stumosa pranë vatrës dhe atje qava e qava sa u lodha. E keqja më e madhe ishte në darkë, kur të kthehej Babo Plaku nga ara.

Po kur na kishin parë ata! Ne shkonim rrëzës së malit, Magdhia na kishte parë që nga Blanja.

— O baba, — i kishte thënë ajo, — dy gra po përcjellin një burrë në Ramje. Kam frikë mos është Limoni.

— Jo, — ja ktheu ai, — s'e bën im bir atë punë.

— Unë e njoh nga të ecurit, Limoni është.

— Si do të shkojë im bir pa marrë uratë nga unë, je në vete ti? — i thia plaku dhe s'e preu të lëruarit.

Po gjene e hante merak, se ja dinte kokën të birit dhe, kur u kthye në mbremje në shtëpi, më pyeti që nga porta, pa shkarkuar orenditë:

— Nuse!

— Orse, baba! — i thashë unë.

— Ku është Limoni? — më pyeti.

— S'është! — ja ktheva unë dhe ula kokën.

— Iku? — më pyeti me inat e padurim.

— Iku... — i thashë.

E përplasi hostenin në oborr, e la kalin pa shkarkuar dhe sikur t'i kishte thënë njeri si kishte ngjarë puna, i vajti të vëllait drejt e në shtëpi.

— Të kesh turp, — i tha, — për atë që më bëre...

— Çfarë të kam bërë, o im vëlla? — e pyeti Mitraqi.

— Pse i dhe lejë tim biri të shkonte? Pse e le të ikte? Nuk e dije ti që ai është i sëmurë?

— Ai vetë deshi...

— Dhe ti e le... gjoja i bëre mirë. E more më qafë, ta dish, më more më qafë edhe mua, se sa e doja unë që e kisha djalë, nuk e doje ti që e kishe nip.

Mitraqi deshi ta përmbante dhe i tha se në Mal të Shenjtë klima është e butë dhe do t'i bënte mirë shëndetit të Limonit, po këtë plaku s'deshi ta pranonte. Dhe iu zemërua. Ca javë s'i foli fare e s'i ktheu kokë, ai, që s'i rrinte ditë pa i vajtur nga shtëpia.

Në darkë Babo Plaku u ul në divan, i lodhur, i vrrarë, i rënduar dhe qau në heshtje. Lotët i shkisin mbi mjekrën e bardhë, se i ndillte zemra zi.

Ne me Magdhinë rrinim të heshtura. Shtëpisë sikur i kishte rënë zia dhe asnjëri s'fliste.

Shtrouam darkë, po siç e shtrouam ashtu e ngri-tëm. Asnjëri s'vuri gjë në gojë. Kujt i shkonte tatëpjetë?

Morëm vesh pastaj se nga Korça e tutje, për në Selenik, Limoni kishte ikur me një muhamedan që ishte i ligu i dynjasë. Ai, një anë të mustaqeve e kishte, një anë s'e kishte. Thonin bota: «Qysh kutu-risi e iku me të, se ai të vret në udhë.» Mirëpo me atë ky yni njihej dhe e kishte shok. Thonin se së bashku kishin bërë ca trimërira andej nga rrethet e Athosit. Ai kishte qenë kaçak maleve e rrugës i pas-kësh thënë edhe këtij tonit:

— A vjen me mua, o Limon?

— Ç'të bëj me ty?

— Rrojmë firarë. Do fitosh dhjetë herë më shu-më se me atë çekanin e thyer që ke në torbë.

— Tani s'jam për ato punë, — i tha ky yni.
— Zemrën e kam të fortë, po gjoksin, jo. Shiko këtu!
— u kollit pak dhe nxori gjak.

— Atëhere s'paske bërë mirë që ike nga shtë-pia. Siç më duket mua, rehatin e shtëpisë nuk do ta gjesh atje në mes të murgjëve.

— Kisha gruan të rëndë, — ja ktheu ky, s'mund të rrija në shtëpi!

— Hajde, or Limon, hajde, ç'zemër që më pas-ke! — i paskësh thënë ai dhe e çoi gjer në Selanik.

Yt gjysh pështynte gjak. Thonin që e kishte ma-rrë atë sëmundje nga e ëma. Ai vetë s'fliste kurrë

për sëmundje. S'u shtrua një herë në rroba e s'u ankua një herë. Ama digjej, digjej gjithnjë zjarr.

Më thoshte kohë pas kohe, e mjera Nuko;

— Moj bijë, kam merak për ty, e dheu s'do më tretë. Ta dhamë burrën të sëmurë.

— Po ju s'e dinit? — e pyesja unë.

— Nga ta dinim ne? Ai ishte në Mal të Shenjtë. Njerëzit e shtëpisë së tij të kërkuan, dhe ne të dhamë atje se janë soj i mirë.

Ai kollitej atë behar që u martua dhe vinte pak si i verdhë. Unë ndonjëherë i thoja:

— Hë, mor dhe ti, ç'e ke gjithnjë këtë gjak që pështyn.

I vinte dhe rëndë, po i vinte dhe keq të gjorit.

— Më vete nga dhëmbët... — më thoshte.

S'donte të më trëmbte, nga ana tjetër ishte shumë kryelartë. Qëkur mori vesh pastaj se isha me barrë, iu ngrit mendja dhe s'donte të rrinte më në shtëpi.

Në mars, kur bëmë djalin, i dërguam lajm.

— Nga ka ngjarë djali? — pyeti.

— Nga e ëma, — i thanë.

— Më mirë që paska ngjarë andej, — tha.

Plaku, atë dimër, gjithandej e kishte mëndjen, se i kishin thënë kurbetllinjte që s'para e kishte mirë djalin me shëndet. Që atëhere edhe të nipin e vogël s'e pekulepste më, po e linte mbi dyshek se i dukej sikur ai ja largoi të birin. Edhe e merrte ndonjëherë në dorë, po pa qejf, kurse më përpara s'e lëshonte nga duart.

Ai atje — sëmurë keq. Dy javë para se të vdiste, i dërgoi të jatit sahatin e xhepit dhe dy lira flori.

Plaku e mori sahatin, e përkëdheli me duar, e puthi dhe pastaj e vuri mbi buar të oxhakut.

Në tetor iku, në maj vdiq. Vdiq atëhere kur nga të gjitha anët hapin lulet. Karta e zezë kishte ardhur, po neve s'na kishin treguar, se unë isha lehonë.

Kur mbushi djali dyzet ditë, erdhën e na treguan. Unë atë ditë që vajta në kishë për të marrë uratat — isha nisur e stolisur e mënt fluturoja nga gazi. Çupë e re, tetëmbëdhjetë vjeçe, kisha bërë djalë, për një muaj do të më kthehej burri, me ëndrra si çdo e re, kisha hak që fluturoja nga gazi. Ku ta dija unë se atë ditë do të merrja mandatën më të dhembur në jetën time.

Me të mbaruar mesha, erdhën burrat e vëllezërisë një nga një në shtëpinë tonë e, të heshtur e të menduar, u ulën në odën e mirë.

Unë u preva sikur më ra pika. Thashë mos kishin ardhur të uronin djalin, po ato fytyra tregonin tjetër gjë.

U ngrit njëri dhe zuri plakun nga dora.

— Bëj zemër, o vëllai ynë, se djali të la. Na iku Limoni, na iku vëllai ynë.

Plakut i shkuan lotët kërr tatëpjetë. Bëri kryq e, duke ngritur duart nga qielli, tha:

— O perëndi, ti ma dhe, ti ma more, bëmë derman dhe mua plakut tani!

Ne ja dhamë kujes. Sa e hidhur qenka vdekja e largme. Pelin! Pelin!

— Nuse, shtro shtëpinë, — më tha vjehri e s'më vështronte dot në sy.

Erdhën pastaj për kryeshëndoshë njerëzit me

radhë. Kështu mbeta unë nuse e re, me fëmijë të njomë në gji e me një plak në vatrë.

Ata pesë muaj shkova unë me burrë. Më thanë të kthehesha në derën e babait se ku dihej, rronte a s'ronte djali dyzetditësh, po unë i vura gur zemrës dhe thashë: «sa të kem djalin gjallë, s'ndahem nga kjo shtëpi.» U dhëshë pas punës e punova tërë jetën si kopile, rrita djalin e e bëra burrë, e martova dhe, ja, shyqyr, nuk e mbylla derën, m'u gëzua shtëpia me nipër e mbesa plot.

Ajo e mbaroi tregimin e heshtur. Pas pak shtoi:

— Më përpara s'para e kujtoja tim shoq, po tani, sa herë vjen vjeshta e nis të fryjë erë, më kujtohet ai i nxiri kur u nis për në kurbet dhe më vjen të qaj.

Gjyshja heshti dhe afroi kanistrën me pala.

Përjashta era s'kishte reshtur dhe dega e kumbullës, si një gisht i thatë, vazhdonte të fërkohej me ankim pas xhamit. Që nga perëndimi një rreze e bardhë dielli çau retë, shndriti midis gjetheve e hyri në dhomë duke e pruar murin me vizatime fantastike, ngaqë gjethet përkundeshin papushim prej erës.

Në por zjarri kërciste, e prej kapakut të tenxheres dilnin shkulme avulli të bardhë.

NJOHJA

Plakut të mirë myzeqar
Pet Rrëza

Ai doli nga shtëpia duke mbajtur në sup një shkop, ku kishte varur një bohçe me disa ndërresa. Hapat e para i bëri të shpejta e të nxituara, si të donte të largohej sa më parë nga shtëpia. Po, pa bërë as pesëdhjetë metra, këmbët s'i bënë të shkonte më tej dhe qëndroi në mes të rrugës i pavendosur. Nga-dalë u kthye me fytyrë drejt shtëpisë, duke u përpjekur ta shkoqiste atë nyje që e kishte munduar gjithë ato ditë: si ishte më mirë, të vazhdonte rrugën apo të kthehej e të qëndronte së bashku me fëmijët?

Pranë moçalit të gjelbër, nga myshqet që ndodheshin pranë shtëpisë së tij, pa djalin e vogël që po vazhdonte akoma të ndiqte rosakun e fqinjit. Kur po dilte nga shtëpia, ai i tha djalit:

— Eja të të puthë baba, se do të iki.

Djali qe stepur; atij në atë çast i pëlqente më shumë të ndiqte rosakun që hapte sqepin e tij të gjerë dhe rikaste me frikë, se sa t'i afrohej babës për të marrë një të puthur.

I ati e ndjeu këtë gjë dhe i erdhi keq në thellësi të shpirtit, po s'kishte pse të zemërohej dhe të prekej.

«Është i vogël», e fali ai me mend. «Ky s'merr vesh nga hallet e njerëzve, dhe gjithë ditën mendjen e ka te lodrat».

Gruaja, së bashku me vajzën e madhe, kishte dalë në fushë për të mbledhur lakra. Tani kjo punë ishte bërë e zakonshme dhe e rëndësishme. Atë pak miell misri që kishin siguruar me aqë telashe, e shtonin me lakra, duke gatuar një lloj kaçamaku, dhe pastaj e hanin të gjithë së bashku. Thonin se, po t'i gatujë me qumësht, bëheshin të shijshme, po ku ta gjente qumështin Mit Sota? Lopën e kishte mëzore dhe i kishte shteruar me kohë. Kaçamaku merrte një shijë të hidhur, po s'kishin si t'ja bënin ndryshe, e hanin vetëm nga nevojë që të mbanin shpirtin gjallë. E vërteta që se kur kishin bukë, as u binte ndër mend për atë gjellë të njeriut primitiv. Ngushëllimi që se nuk vuanin vetëm ata, në fshatin e tyre dhe në fshatrat rreth e rrotull s'kishte ndonjë çështje tjetër që t'i shqetësonte të gjithë veç bukës. Qënë vite krize dhe shtrenjtësie, kudo ishte vështirë, bukë s'kishte, kurse gazetat shkruanin për ballot luksoze që jepte monarku në pallatin e tij.

Disa burra nga fshati i Mitit, ishin nisur për të kërkuar punë dhe bukë, duke e ditur që më parë se nuk ishte e lehtë të siguronin as njerën, as tjetrën. Kilja e misrit kushtonte shtrenjtë dhe, derisa të piquej buka e re duheshin dhe disa javë të mira.

Si do të bënin ata në shtëpi? Ky merak e mundonte shumë. Gruaja do ta kishte shumë vështirë kur

të shikonte sytë e fëmijëve që luteshin për bukë. Mbrëmavet, kur qëllonte që s'kishin ç'të bënin, ajo niste dhe u tregonte ca përralla të gjata që s'kishin të mbaruar, me të bukura dheu, me diva e me hajdutë, gjersa fëmijët i zinte gjumi. Ndofta, njerëzimi në netët e gjata të urisë ka shpikur përrallat më të bukura.

Buka qe bukë, gjellë dhe perëndi. Ata i faleshin asaj si Diellit, Zjarrit e Krishtit dhe betoheshin për të si për zotët e tjerë: «Më zëntë buka sytë!» ose «Ja, për këtë bukë që ha, në gënjej!» Dhe, në qoftë se gjenin diku një copë bukë të hedhur në rrugë, e merrnin me kujdes si një gjë të shenjtë dhe e vinin mënjanë në një vend ku të mos e shkelnin këmbët e njerëzvet, se buka nuk mund të shkelet me këmbë.

Një mëngjez, para dy javësh, djali i tij kishte kërkuar bukë.

«Nuk kemi, i qe përgjegjur e ëma, — na u mbarua:

— Atëhere nëm ca përslesh.

— Ku ta gjejmë përsleshin?

— Pse, as përslesh nuk ka? — kishte pyetur Periku me habi.

Në shtëpi kishin qeshur me lot, ndërsa Periku, i skuqur dhe i turpëruar, shikonte me radhë njerëzit e shtëpisë duke e ndjerë se kishte thënë diçka që nuk shkonte, po se çfarë ishte ajo s'e gjente dot.

Miti e kujtoi këtë ndodhi atje në mes të rrugës, dhe vuri buzën në gaz për një çast, po buzëqeshja iu shua menjëherë kur solli ndër mend se në shtëpi asaj radhe s'kishte miell as për dy ditë. Ku mund të merrnin, kush mund t'u huante?

Mos ishte më mirë të kthehej në shtëpi dhe le t'i gjente ç'ti gjente të gjithë së bashku? Apo të vinte t'i kërkonte dhjetarit? Si mund t'i kërkonte bukë vetë atij që ja kishte rrëmbyer? Mallëkoi dhe pështyu. Jo, s'kishte si të kthehej prapa. Po qe se edhe ai do të rrinte në shtëpi, mielli do t'u mbarohej më përpara. Më mirë të ikte, kështu fëmijët do të kishin të hanin diçka më tepër, ndofta një ditë më shumë. Ky mendim e qetësoi dhe i fali një kënaqësi të brendshme, kënaqësinë e vjetër të sakrificës së përhershme të prindit.

Fëmijët e kishin lëkurën bojë hiri si të gjelbër. Ashtu e kishin vërtet, ngaqë ushqeheshin me lakra, apo i bënin sytë? Kohët e fundit ai ndjente se vështrimi i qe dobësuar dhe të gjitha gjërat i dukeshin si të mjegulluara e të përhimta.

Qarkullonin fjalë se në katundet rrëzë Gramshit, misri atë mot kish qenë i mbarë dhe tek-tuk mund të gjeje për të blerë. Po të kishte fat, mbase, edhe Mit Sota do të gjente diçka për fëmijët e tij. Është e vërtetë se ai s'kishte në xhep asnjë kokërr leku dhe gjithë shpresat i kishte mbështetur te krahet e tij. Ai dinte të ndërtonte tharqe dhe kasolle prej kallami, dhe shpresonte se asaj ane do të gjente ndonjëfarë pune. Pra le të nisej për rrugë; nga gjithë mendimet e tjera që i vëlonin në kokë, ky iu duk më i arësyeshmi.

Hodhi shkopin me bohçe në sup dhe mori rruqën. Shpirtin ja kishte pushtuar një dëshpërim i thellë, sepse prapa linte fëmijët pa bukë dhe përpara e priste pasiguria. Sa herë kujtonte fëmijët ndjente

një dhembje në zemër, dhe i dukej se ai vetë ishte shkaktar për vuajtjet e tyre.

Vallë, nuk ishte i zoti, apo kishin ardhur kohë të vështira? Donte të dinte në e kishte bërë ndonjëherë këtë pyetje gjatë jetës edhe i ati. Sikur të qe vërtet ashtu, do ta ndjente veten të lehtësuar. Po me siguri do të kishte hequr keq edhe ai. Ndryshimi qe ky: ai qe bujk i Shaban agait, kurse Miti qe i djalit të tij. Brezat ndryshoheshin, iknin e vinin, po shfrytëzimi mbetej njëlloj.

Këmbët e tij ngrinin pluhurin e verdhë të rru-gës, dhe shtresa e imtë e tij ishte pahitur edhe mbi lëkurën e opingave prej bualli. Ai shkonte drejt lindjes, duke i hedhur hapat të gjata dhe pa u nxituar, si një njeri që ka për të bërë rrugë të gjatë.

Më të djathtë kishte kënetën e Tërbufit. Mbi të notonin fije të kalbura kashte dhe ca insekte me këmbë të gjata e me krahë. Zhabat kuaknin me potere, sa ndjenin hapat e tij kërcenin nga ledhet e anës dhe zhyteshin në ujrat e turbullta.

«Ne s'kemi bukë, se kemi shumë moçale; gjynah nga zoti! Ta kishin bujqit këtë tokë, mbase s'do të hiqnin keq për bukë. Po si t'ja bësh gjithë këtij uji, me se ta heqësh?»

Lart në qiell fluturonin tufa harabelash, garguj dhe skilopa me sqep të gjatë. Ata çanin ajrin me shpejtësi, të gëzuar nga ajri i ngrohtë i pranverës. Miti nuk i dëgjonte, për atë nuk kishte ardhur akoma pranverë. Qe akoma larg atyre ditëve të gëzuara, kur do të hynte në arë me drapër në dorë, duke bërë kryq për bukën e re.

I duhej të ecte që, të paktën pasdreke të arrinte në ndonjë fshat te kodrat që dukeshin përtej si të mbështjella me një vello bojë plumbi.

Duke menduar se në katundet e para do të kishin ardhur të tjerë përpara tij, ai u shty më thellë luginës, gjersa arriti në fshat, të cilin e ndante mes për mes një përrua i vogël.

Ai s'dinte ku të drejtohej. Atje s'njihte asnjeri dhe as emrin e fshatit s'e dinte, po do të bënte ashtu siç bënin shqiptarët. Do të pyeste dy-tre vetë, do t'u thoshte nga ishte e përse kishte ardhur dhe me siguri do të dilnin të njohur. Kushedi, mbase ishte pjekur ndonjëherë me ata në pazar të Lushnjes, ose në Kavajë. Në mos me ata, me ndonjë të njohur të tyre.

Dhe ashtu bëri.

Dikush prej tyre i tregoi një shtëpi me dorë dhe i tha:

— E shikon atë shtëpinë e vogël me hajat, atje përtej? Pyet një herë atje për punë, se më ngjan sikur i zoti i saj donte të ndërtonte një kasolle për bagëtinë.

— Si e quajnë? — pyeti Miti.

— Selim, Selim Murrizi.

Miti e falënderoi dhe u nis. Sikur vërtet të gjente punë, ashtu siç kishte ëndërruar. Në fillim duhej të bënte pazar, që të mos kishte grindje dhe pakënaqësi në fund, me të zotin e shtëpisë. Po sikur të mos binin në ujdi? Miti mendoi i shqetësuar se edhe kjo kishte mundësi të ngjiste, po ai s'kishte ç'bënte, do të pra-

nonte çdo pazar që t'i jepte, mjaft që të mos kthehej duarzbrazur në familje.

Ai iu afrua shtëpisë dhe thërriti:

— O Selim! O Selim!

Një zë iu përgjegj nga brenda dhe pas pak doli në hajat një burrë i thyer me një palë mustaqe të bardha e me një qeleshe në kokë. Burrat e kësaj ane mbanin qeleshe të shkurtra, kurse myzeqarët takije.

— Hajde, urdhëro brenda! — e ftoi i zoti i shtëpisë.

Ata i dhanë dorën njëri-tjetrit, ndonëse i zoti i shtëpisë tregohej pak i habitur, po nuk e bënte veten. Mbase do të ishte ndonjë mik që i kishte bujtur në derë; e që ai s'e mbante mend. Kishte faj edhe pleqëria në këtë mes. Selim Murrizi e shikonte mysafirin me bisht të syrit dhe po mendohej të sillte ndër mend ndonjë tipar të njohur. Vallë, ku e kishte takuar dhe pse s'e mbante mend? A ka lezet të mos mbajë mend njeriu miqtë e shtëpisë? Kur u ulën në hajat, Selimi, ndonëse me turp, e pyeti të porsaardhurin.

— Ore byrazer, turp nder, unë do të pyes. Ku më njohke zotrote, se unë s'ta di emrin.

Miti i tha si quhej dhe pastaj i tregoi me pak fjalë se as ai nuk e njihte, po kishte ardhur për të kërkuar punë.

Qëndrimi i Selimit ndryshoi menjëherë, ai u bë më i shkujdesur e më mospërfillës, sado që me gojë s'tha asgjë. Pra s'ishte ndonjë mik shtëpie po një fshatar i panjohur i ardhur nga fshatrat e fushës, që kërkonte punë dhe që pranonte si shpërblim vetëm bereqet. Mit Sota e ndjeu këtë gjë duke vështrë-

ar fytyrën e të zotit të shtëpisë dhe të pjesëtarëve të tjerë. I erdhi shumë rëndë dhe turp nga vetja e vet.

— Ndonjë punë, — tha Miti, — çfarëdo punë që të jetë. Mua më vjen ndoresh edhe për të prashitur.

Duke u ngjitur për në fshat, ai kishte shikuar se misrat e hershme qenë rritur dhe koha ishte e përshtatshme për prashitje.

— Për të prashitur kam djemtë e mi, — tha Selimi. — Atyre s'ua del dot njeri në këtë punë.

Miti e kuptoi se edhe kjo përpjekje i shkoi kot, dhe s'po dinte nga t'ja mbante. Ku mund të vinte tashti? Vështrimi i syve iu turbullua dhe, si të zgjohet nga një gjumë i gjatë, filloi të fërkonte sytë dhe ballin.

Selimi e shikoi të porsaardhurin dhe dëshpërimin e tij të çiltër me dhëmbje. Nevoja e kishte sjellë atë njeri në derën e shtëpisë së tij dhe ai nuk lypte po kërkonte punë. A nuk mund ta ndihmonte sado pak? A nuk mund t'i huante diçka, sado që edhe ai vetë qe i varfër? Vështrimi i tij u zbut dhe me një zë gati miqësor e pyeti:

— Po mur a di të ndërtohet? Kam një mur për të ngritur. Ka nja dy muaj ma rrëzoi sqota ballenë e haurit. Po qe se di, atëhere mund të rregullohem.

— Jo, tha Miti, nuk di.

Ndjehej i dëshpëruar, sado që i erdhi mirë nga kjo kthesë që vuri re në zërin dhe në qëndrimin e të zotit të shtëpisë. Po kur s'donte fati, s'kishte se ç'bente.

Ndërkohë erdhi djali i madh me një pjatë në dorë dhe solli dy kafe. Ndofta ngaqë kafeja kishte

pak sheqer, a ndofta ngaqë gojën e kishte të hidhur, Miti iu duk farmak dhe pa shië. Ndërsa e pinte, shikonte i menduar oborrin e shtëpisë, ku kishin lulëzuar ftonjtë, dhe mendja i vajti menjëherë te shtëpia e tij. Ç'po bënin në atë çast dhe si po e kalonin fëmijët? Do të kishte dashur më shumë t'i jepnin një copë bukë se sa atë kafe prej qiqrash dhe elbi, kafe fukarenjsh, po s'kishte si të kërkonte pa filluar punën. Dita që thyer, dielli po rrëzohej në anën e detit dhe gjelbërimi i arave u bë më i thellë, ndërsa e kaltra e qiellit filloi të zbehej.

Një djalë shkoi në oborr duke mbajtur një kofin në krahë. Në këtë kohë plaku e pyeti:

— Po kosha a di të ndërtosh?

— Di, — tha Miti dhe i shkëlqyen sytë. Ai ishte gati të fillonte që atë çast nga puna, po i zoti i shtëpisë i bëri me dorë të mos nxitohet.

Ai i thërriti një djali.

— O Halit! O Halit! — dhe diç i bëri me shenjë.

Pa shkuar as dy minuta Haliti erdhi e shtroi përpara të porsaardhurit një sofër të vogël, ku kishte fasule, dhallë dhe bukë misri të ngrohtë.

— Të bëjmë punën një herë, pastaj bukën, — tha Miti me ndruajtje.

— Jo, ne këtej e kemi ndryshe, — tha Selim Murrizi. — Ha bukë me këtë që na u ndodh dhe pastaj fjalosemi për punë. Ti me siguri nuk ke ngrënë, se ke qenë në rrugë.

Ai u ngrit nga vendi dhe zbriti shkallët, se nuk ishte gjë e përshtatshme të rrinte në hajat, si duke

numëruar kafshatat e njeriut nga fusha. Le të hante i qetë dhe me nge.

Miti ja nguli sytë bukës me adhurimin e devotshëm të një fetari. Zgjati dorën ngadalë, me frikë se mos ajo i largohej ashtu si në ëndërr dhe i erdhi mirë kur ndjeu ashpërsinë e kores në pëllëmbën e vet. E theu më dysh ngadalë, ndërsa pështymën e kapërcente tatëpjetë, shikonte shkëlqimin e verdhë të cipave të misrit dhe pastaj mori lugën. Kishte kohë që s'kishte ngrënë bukë dhe ja tani fati ja solli përpara. Bëri mirë që doli nga shtëpia. Njëherë e një kohë edhe ai në shtëpi shtronte bukë kështu në sofër, po ajo kohë tani i dukej se kishte mbetur larg.

Futi kafshatën e parë në gojë dhe filloi të përtypej, duke ndjerë kënaqësinë e pabesueshme të njeriut të uritur. Po atë çast mendja i vajti te fëmijët. Oh, sikur t'i kishte aty. Ai po hante, po ata vallë, ç'po bënin?

Iu ligështua fytyra dhe s'po e kapërcente dot tatëpjetë. Nga sytë i dolën lot dhe i shkanë nëpër faqe. Ndjeu një sëmbim të fortë në zemër dhe hodhi vështrimin nga oborri. Gjer atëhere kishte kujtuar se do të hante me kënaqësi të madhe, po kujtimi i fëmijëve e turbulloi, dhe bukën tjetër e hëngri më shumë prej turpiti se prej urisë.

Mbaroi, fshiu buzët me peshqir dhe u ngrit në këmbë. Në atë çast Selimi, i zoti i shtëpisë, ngjiti shkallët.

— Do të më thuash një gjë, — iu lut ai duke e shikuar në sy.

— Urdhëro.

— Pse qave qëparë në bukën time?

Mit Sota uli vështrimin dhe shikoi majat e opin-gave, që ruanin akoma pluhurin e rrugës.

— Jo, nuk qava, — kundërshtoi me një zë të pavendosur.

— Unë të pashë që qave, mos thuaj jo. Po pse të qash në bukë?

Miti nuk i dinte zakonet e atyre anëve, dhe sado që në fillim s'kishte menduar t'i rrëfente për fëmijët e uritur që kishte lënë, kur kujtoi se plaku mund ta kishte për gjynah t'i qaje në bukë, i tha:

— Ashtu e kam hallin, o Selim. Kam lënë kalamanjtë pa bukë në shtëpi, hanë vetëm nga një dorë kaçamak me lakra.

Plaku i vuri dorën në sup.

— More Miti, po këtë të ma kishe thënë në krye fare e jo më flisje për punë. Baba fëmijësh je ti, baba fëmijësh jam edhe unë. . . Fukara ti, fukara unë. . . Të tepërt s'kemi, po nga ajo që kemi do të të japim, të hanë edhe fëmijët e tu dhe të mos kesh fare merak. Sa të kem bukë në shtëpinë time, do të kesh edhe ti. Shyqyr zotit, moti u ngroh dhe buka e re nuk është larg.

Miti Sota ngriti kokën dhe shikoi fytyrën e plakut me mustaqe të bardha. Asnjë plak nuk i ishte dukur më i mirë dhe më i dashur se Selimi, emrin e të cilit e dëgjonte për herë të parë dhe prakun e të cilit po e shkelte për herë të parë.

Plaku u kthye nga oborri dhe thërriti sërish Halitin.

Djali i erdhi pranë dhe po priste urdhërat.

— Dëgjo Halit, — i tha, — do të marrësh katër kaçile misër dhe do t'i shpiësh në shtëpinë e këtij mikut që na erdhi sot këtu, se ka fëmijët pa bukë.

Miti deshi ta falënderonte, deshi t'i thoshte se po e bënin borxhli mbasi nuk kishte filluar akoma nga puna dhe tani sa ishin njohur, po iu bë një komb në grykë, dhe nuk nxori dot asnjë fjalë. Kish-te ardhur argat, e qe bërë mik. Në vend të tij Selimi tha:

— Po të mos jemi ne për njëri-tjetrin, atëhere kush do të jetë për ne?

Pastaj të dy zbritën shkallët dhe vajtën të shikonin punën që duhej bërë. Ndjeheshin të afërt dhe të bashkuar me njëri-tjetrin.

Filladi sillte me vete kundërmimin e barit të fushës dhe lajmëronte se nata kishte për të qenë e butë dhe e ngrohtë.

RRUGËS

Moshatarëve të mi

Shiu na zuri pas tri orësh. Ne e pamë qiellin të mbushur me re, pamë edhe zogjtë që fluturonin ulët të shqetësuar, dhe nxituam të ngarkonim sa më parë kafshët e të niseshim për rrugë. Kishim blerë patate për të plotësuar, në një farë mënyre, mungesën e bukës, Leksi njëqind kile e unë tetëdhjetë. Unë mund të kisha blerë edhe më shumë, po kisha frikë se gomari s'do që i zoti të mbante më tepër mbi kurriz, kurse Leksi kishte kalë.

Gomarin e ngarkuam vetë, ndërsa kalin s'e ngarkonim dot se ishte i lartë. Hanxhiu, kur pa se po orvateshim kot, erdhi e na ndihmoi. I mori thasët e rëndë dhe i ngriti në samar. E pashë se si iu skuqën e iu frynë venat e qafës dhe thashë me vete se një thes të tillë unë s'do të mund ta ngarkoja kurrë.

— Pa shikoje, mos anon? — e pyeti ai Leksin. Leksi e tërhoqi kalin prej kapistre. — Jo, nuk anoka, — tha hanxhiu.

E nxora edhe unë gomarin nga porta e hanit.

— Tani nisuni. Hajt, rrugën e mbarë! — na uroi

hanxhiu e pastaj, sikur të ishte kujtuar për diçka, pyeti: — Ku do shkoni ju?

— Në Kolonjë.

— Vetëm? — tha ai me habi duke rrudhur ballin.

— Vetëm...

— Ju lumtë! Po ju jeni kalamanj... Sa vjeç je ti? — m'u drejtua mua.

— Trembëdhjetë.

— Po ti? — i tha Leksit.

— Katërbëdhjetë.

— Ti dukesh më i madh, — më tha mua.

M'u bë qejfi që dukesh më i madh se Leksi, po megjithatë s'më vinte mirë që ai ta ndjente veten të fyer, prandaj ula kokën dhe herë vështroja gurët e kalldrëmit, herë rrëshqitazi fytyrën e tij.

Hanxhiu pyeti përsëri:

— Domethënë s'paski frikë? — dhe pas pak vazhdoi të shtjellonte mendimin e tij. — Le që kush do t'iu ngasë! Tani lufta mbaroi dhe sikushdo shikon punën e tij. Të huaj s'ka, hajdutë jo. Mund të vejë njeriu ku të dojë.

Pa dalë akoma nga Korça, shkova edhe një herë nëpër mend të gjitha porositë që më kishin dhënë në shtëpi. Shkoja për herë të parë në pazar, dhe kisha qejf të mos lija gjë mangut. U kujtova se rrotkat me penjë, për të cilat më kishte porositur nëna, s'i kisha blerë akoma. Po ne s'kishim dalë nga qyteti dhe rrugës kishte plot dyqane të vegjël. U ktheva në një prej tyre dhe bleva nja katër rrotka penjë.

Gjithë gaz, mendoja çastin kur do të arrija në shtëpi dhe, ashtu siç bënte gjyshja kur kthehej nga:

pazari, do të ulesha përpara torbës dhe do të nxirrja një nga një sendet që kisha blerë, ndërsa njerëzit e shtëpisë do më shikonin me adhurim.

Që tani po e merrja me mend atë kënaqësi dhe vetëm zëri i Leksit më largoi nga ato vegime.

Ai, duke vështruar qiellin, tha:

— S'besoj të zërë shi, se retë janë akoma lart. Vërtet retë qenë lart dhe s'dukeshin të rënduara.

— Sikur të mos na zërë, mirë do jetë. Sa ishte ora kur u nisëm?

— Nja tre, a tre pa një çerek.

— Domethënë më njëmbëdhjetë të natës jemi në shtëpi.

— Sikur të ecim shpejt, mund të vemi edhe më herët.

I nxituam kafshët aqë sa mundëm, po ja, shiu na zuri. Një shi i ngadalshëm, i hollë, i qetë.

Në fillim vumë re se shiu na kishte njomur pantallonat. Leksi më tha:

— E di sa mirë hekurosen pantallonat tashti? Tamam për hekur janë bërë.

Ai duhet ta dinte mirë këtë gjë, se ishte futur çirak tek një rrobaqepës. Kishte disa muaj që punonte atje, por unë nuk ja kisha zilinë asaj pune, sepse vazhdoja shkollën, dhe shkolla më pëlqente më shumë se çdo punë tjetër.

— Ke mësuar ti të hekurosësh pantallonat? — e pyeta.

— Kam mësuar, po jo fare, fare.

— Pse e le shkollën? Më mirë ta kishe vazhduar uniken.

— S'deshi babai. Më mirë mëso ndonjë zanat, më tha, se zanati s'të le kurrë pa bukë.

Ne po zbrisnim tatëpjetë një luginë. Monopati shkante anës një përroi. Patkonjtë e kafshëve kërcisnin duke u përpjekur pas gurëve.

— Me kaqë shi, unë s'dua t'ja di, — tha Leksi.

— As unë. Mua ndonjëherë më pëlqen shiu, si domos në verë.

Rrugën kryesore e kishim lënë nja dy kilometra më të maitë dhe gjithmonë zbrisnim tatëpjetë luginës. Po fillonte të ngrysej. Malet përreth nuk dukeshin fare, shiu si një perde e trashë i fshinte të gjitha gjërat. Dëgjonim vetëm shushurimën e një përroi të rrëmbyer. Kjo shushurimë zotëronte mbi gjithë atë luginë dhe na shoqëronte në rrugën tonë. Qielli dukej i zi dhe i heshtur.

Leksi tha:

— Sikur të kisha një «parabel!»

Ne i dinim të gjitha markat e armëve, se atëhere lufta sapo kishte mbaruar. Megjithatë, dëshira që shfaqti Leksi atë çast, m'u duk e habitshme. Pse i qe kujtuar parabeli?

— E ç'e do parabelin? Ai është i rëndë e mezi mbahet.

— Ta kishim, që po të na dilte ndonjë ujë, ta vrisnim.

— Tani s'ka ujë, se akoma s'ka rënë dëborë. Në shkurt duhet të kesh frikë nga ujë, sepse atëhere ata shkojnë lukuni, — e qetësova unë, duke i thënë atë që kisha dëgjuar prej të tjerëve.

— Unë te Ollmi kam frikë, — tha ai.

Kali i Leksit u pengua dhe për pak ra. Pas disa metrash ai u pengua përsëri. Leksi iu afrua dhe vuri re se patkoi i kishte dalë mënjanë nga thundra si strehë kapeleje dhe i mbahej vetëm në një gozhdë. Ai e mbajti kalin duke i thërritur, pastaj i ngriti këmbën dhe ja hoqi fare patkuan.

— Ruaje, i thashë unë, — që t'ja mbathësh përsëri.

— Jo, — tha Leksi — ky është ngrënë shumë e nuk bën. — Ai e flaku në një dushqerë dhe ne vazhduam rrugën.

Gomari im ecte përpara dhe kali e ndiqte pas me besnikëri. Tani thujse ishte errur. Po kalonim Ollmin. Akoma binte shi. Korja e lisave dukej e zymtë. Nga fletët e ndryshkura shkisin pikat e ujit. Fletët na dukeshin të errëta, po ne e dinim se ato ishin ngjyrë kremi, ashtu sikurse i kishim parë një ditë më parë. Te Ollmi edhe unë kisha frikë. Më dukej sikur prapa çdo kaçubeje fshihej një ujk a një diçka tjetër e frikshme. Sidomos kisha frikë nga heshtja. Dëshironja që ta kalonim sa më parë atë vend dhe u fala me mend. Ne nuk flisnim, vetëm përgjonim me sy e me veshë. Pritnim nga çasti në çast të dëgjonim një klithmë të frikshme, në mes të heshtjes e të errësirës, dhe pastaj diçka që do të na hidhej në fytyrë.

Asgjë s'ngjau. E kaluam Ollmin dhe ndjemë sikur u çliruam nga një peshë. Dolëm në xhade e kaluam urën mbi përrua. Poshtë urës, ujrat e rrëmbjera gurgullonin papushim. Ne nuk u afruam fare në parmakët, dhe për t'i dhënë zemër vetes filluam të flisnim me zë të lartë.

Pas nesh u ndien zëra dhe këmbë kafshësh. E

dinim se këta ishin pazarakë, që po ktheheshin në shtëpi ashtu si ne. Ata ishin të gjithë me kuaj e me mushka dhe nga të përpjekurat e patkonjve e kup-tuam që ecnin shumë më shpejt se ne. Dëgjonim edhe bisedën e tyre.

«Ajo barkashurja ishte e mirë. Unë desha ta blija. I thashë edhe atij, gjysmat e parave i kam, gjysmat t'i sjell javës tjetër, do? Ashtu s'kemi gjë, — më tha ai, — se tani gënjejnë njerëzia. Ku të të ndjek unë ty javës tjetër? Na mushkën, nëm paratë, kështu po».

«Se mos do t'ja shpije ti!»

«Kolonjarët s'gënjejnë, — tha ai që kishte folur për mushkën.

«Cilët? Kolonjarët s'gënjejnë?»

«Ato dhëntë e atij devolliut ishin të mira.»

«Të mira, po i mbante shtrenjtë.»

Na arritën, na uruan rrugën e mbarë dhe u zhdukën në errësirë. Ne i mbajtëm kafshët mënjanë që të mos na i merrnin përpara.

— Këta do të jenë nga ndonjë fshat këtu afër, — i thashë Leksit.

— Sikur ta kishim edhe ne fshatin këtu afër!

— A të dhëmbin këmbët ty? Mua më dhëmbin.

— Edhe mua. Po do t'i vë në ujë me kripë. Po t'i vesh në ujë të vakur me kripë, të çlodhen menjëherë.

Unë s'e kisha dëgjuar këtë metodë, dhe u gëzova shumë kur e mësova. Me të vajtur në shtëpi, atë punë do të bëja të parën.

Edhe ca burra të tjerë kaluan afër nesh. Këta ngisnin kuajt me ankth e nuk shkëmbenin asnjë

fjalë me njëri-tjetrin. Në heshtjen e tyre kishte diçka të keqe. Të dukej sikur barrët i kishin vjedhur a rrëmbyer dhe mundoheshin të largoneshin sa më parë. Edhe këta na lanë prapa.

Pastaj një automobil. Pamë dritën e prozhektorëve, e cila në shi dukej e bardhë si qumësht. Në kthesat, drita shkonte në bregoret e lagura, i ndriçonte për një çast e pastaj çdo gjë kridhej në errësirë. Maqina na kaloi pranë me potere dhe ne pamë shiun që binte në fashat e dritës.

Leksi tha:

— Të vinte një maqinë tani e të na merrte...

— Po kafshët kujt t'ja linim?

— T'i merrnim edhe ato në maqinë. Gjermanët i hipnin kuajt në maqinë.

— Edhe italianët! — shtova unë.

Ne po ëndërronim për maqina, sepse ishim lodhur. Kjo dukej sheshit, se më përpara as që na kishte vajtur mendja për maqina. Kishim pesë orë që po ecnim. Rruga shkonte pranë një fshati. Fshati në errësirë nuk dukej fare. Ne ndjemë erën e plehut, dëgjuam të lehura qensh dhe një zile me një tingull të ngjirur. Anës së rrugës dukeshin vetëm gjerdhet me gjemba. Leksi tha:

— Babai im ka një mik këtu. Sikur të dilte ai miku tani e të na thoshte: «ejani nga shtëpia ime sonte, dhe nesër ikni».

Këtë Leksi nuk ma kishte thënë fare, kur shkuam në mes të fshatit. Dukej se tani u kujtua. Apo ëndërronte kot? Atij i vinin vazhdimisht idera në kokë dhe këto idera i shfaqte.

E kaluam fshatin dhe dolëm në një rrugë me baltë. Baltën e ndjenim, se mezi i shqitnim këpucët. Duke shkuar asaj rruge, kali i Leksit rrëshqiti dhe ra. Ne vajtëm menjëherë pranë tij.

— Shkau! — tha Leksi. — O burra, ta ngremë.

U përpoqëm ta ngrinim me të thirrura, pastaj, duke e zënë për bishti e për koke, por të gjitha mundimet na shkuan kot, se kali s'bënte asnjë përpjekje të ngrihej.

— Më mirë ta shkarkojmë. S'ka si të ngrihet me gjithë barrën.

— E kush të na e ngarkojë pastaj? — pyeti Leksi.

— Ne vetë.

— Kam frikë se s'do ta ngarkojmë dot e do të mbetemi këtu.

— S'kemi ç'bëjmë. Ky është lodhur e nuk ka si të ngrihet kështu.

Me mërzë e pa vullnet Leksi zuri tërkuzën e lagur e të forcuar nga shiu dhe filloi ta zgjidhte. Edhe unë në krahun tim atë punë po bëja. Me ta ndjerë veten të çliruar, kali u ngrit në këmbë. Thasët me patate mbetën në baltë.

Një thes e ngarkuam kollaj, sepse e zumë që të dy dhe e ngritëm në samar. Gjithë vështirësia tani ishte te thesi tjetër, sepse njëri duhej të mbante anën dhe tjetrit i mbetej ta ngrinte vetëm.

I pari provoi Leksi. E luajti pak thesin nga vendi, pa qenë i zoti ta ngrinte. Duke mbajtur barrën, unë dëgjoja gulçimet e tij.

— Ta provoj unë, — i thashë.

Ai erdhi mbajti anën, e unë dola në krahun tje-

tër. E zura thesin me një dorë përgryke, e me tjetrën përfundi. Duke u sforcuar e ngrita mbi gjunjë dhe qëndrova i kërrusur. Vallë, a do të isha i zoti ta hidhja mbi kalë? I mblodha fuqitë e mia dhe u mundova të ngrihesha, po thesi që i rëndë, nuk ngrihej. E lëshova përtokë.

— Qenka shumë i rëndë, Leksi. Nuk ngrihet.

— Të thashë unë që do mbetemi këtu. S'po vjen asnjëri që të na ndihmojë.

Rruga ishte fare e qetë. Binte vetëm shi i hollë. Tani as uturima e lumit nuk dëgjohej.

— Vetëm s'ngrihet. Eja ta ngremë të dy.

— Do ta rrëzojë samarin kali, — tha Leksi.

— Mbase e mban.

Leksi e lëshoi barrën dhe erdhi me të shpejtë pranë thesit, por sa u matëm ne ta ngrinim, samari u kthye në anën tjetër.

Nisëm gjene nga e para.

— Po t'ja shtrëngojmë qingjen kalit e po ta hedhim thesin e parë lart, me siguri që do ta mbajë — thashë unë.

E ndjeva se Leksi ishte lodhur duke mbajtur barrën. Këtë e kuptova se thesi herën e dytë, sado që e ngritëm së bashku, u bë më i rëndë.

— Më ngrinë duart! — u ankua Leksi.

E merrja me mend se duart e Leksit ishin skuqur si të lyera me bojë. Atij ashtu i bëheshin duart sa herë që ftohej moti.

Gomarin s'po e shikoja asgjëkundi. Ai duket kishte vazhduar rrugën. U trëmba.

— Bobo Leksi, më iku gomari!

— S'ka gjë se e arrijmë. Ja, sa të ngarkojmë.

Qepallat i ndjeja të rënduara prej shiut, e zemra më rrihte fort. Provuam përsëri, dhe përsëri na shkoi mundimi kot. Tani të dy qemë lodhur, merrnim frymë thellë e me vështirësi. Më pihej ujë. Nxora gjuhën e lëpiva buzët e lagura nga shiu. Doja të më shikonte kush se sa po vuaja, dhe mendja më vajti menjëherë te nëna. Në rrugë s'po dukej asnjëri. Leksi zuri të qante. Unë dëgjoja ngashërimat e tij. Ai përpiquej të qante pa zë, por kjo ishte akoma më e keqe. Ai kishte frikë se do të mbeteshim gjithë natën atje.

— Leksi, të provojmë përsëri. Mbase këtë radhë ja dalim.

— Unë s'e ngre dot thesin. Më kanë ngrirë duart.

— Ti mbaj anën me kurriz.

Thesin e parë e vumë së bashku, po të dytin më duhej ta ngrija vetëm. I përmblodha të gjitha fuqitë, e ngrita thesin mbi gjunjë dhe pastaj, duke e shtrënguar pas gjoksit, i dhashë trupit të ngrihesha në këmbë. Nga tensioni m'u duk sikur do të më pëlçiste koka. Gjunjët më dridheshin. E mbështeta thesin mbas samarit dhe pastaj kapa shkallën. ¹⁾ Mora frymë i lehtësuar. Punën më të vështirë, sado që akoma s'më besohej, e kisha kryer. Tani ne mund ta rregullonim barrën së bashku.

Pas atij sforcimi, ndjeja një këputje të madhe, jo vetëm në duart, po në të gjithë trupin. Rruga e

1) shkallë — kështu quhet laku prej litari që rri poshtë barrës.

gjatë, shiu, pesha që kisha ngritur, i kishin thëthirë forcat e mia. Më vinte rëndë të flisja. Edhe Leksi ishte lodhur e s'fliste. Ne ecnim në rrugën me baltë vetëm me mendimet tona. Sado që s'e thonim, mendonim të njëjtën gjë; kishim frikë se mos kali shkiste e rrëzohej përsëri.

Pas ndonjë gjysmë ore dolëm nga baltovina dhe po ecnim në një rrugë të sheshtë. Një grup pazara-kësh të tjerë na arritën. Edhe këta vraponin si të parët, ose ndofta nuk vraponin po ashtu na dukej neve. Ata kishin ikur mjaft përpara, kur unë u kujtova.

— Këta do ma marrin gomarin përpara me kafshët e tyre. Po sikur të ma vjedhin?

— Ikë përpara, — më tha Leksi — dhe arriji!

Vrapova në errësirë pas atij grupi. Ata ishin larguar mjaft. Unë nuk dëgjoja as këmbët e kuajve. Mendoja me frikë se ata do të ma merrnin gomarin përpara, pa e vënë re, dhe unë, po të mos i arrija s'kisha mundësi t'i gjeja në asnjë mënyrë. As nuk e dija se nga ç'fshat qenë ata. Kjo frikë më shtynte të nxi-toja, dhe ecja duke gulçuar. Shikoja se si vraponte nën këmbët e mia rruga e lagur. Pikat e shiut as që i ndjeja fare.

I arrita thujt aty ku rruga ndahej për në fshatin tim dhe e gjeta gomarin. Isha këputur nga ai vrapim e s'doja gjë tjetër veç të shtrihesha atje në mes të rrugës në shi e të flija. Ecja me sy mbyllur; këmbët nuk i ndjeja fare, veç e kuptoja se ato ecnin vetë. Edhe rruga ishte zgjatur. S'e kisha ditur se, nga fshati deri në xhade, ishte aqë larg dhe habitesha pse herët e tjera më ishte dukur e shkurtër. Vetëm

shtëpia më tërhiqte si diçka e praruar dhe vezullonjëse dhe në mendjen time ajo soba e pastër e ngrohtë, e qetë e gjithë dritë s'më ishte dukur kurrë më e dashur. Mendoja nënën duke më pritur pranë zjarrit e duke thurur çorape, ndërsa te këmbët i fërkohej macja; çajniku valonte pranë prushit. Llambës ja kishin ulur fitilin që të mos digjte shumë vajguri, dhe drita e saj mezi arrinte gjer në këndet e dhomës. Dhoma binte erë ftonj dhe rrëshirë pishe. Unë me këmbët në legen do t'u tregoja se ç'kisha hequr, sa isha munduar kur kisha ngarkuar kalin e Leksit, se si pastaj isha trembur mos më humbiste gomari dhe tregimi im do t'i mallëngjente. Pastaj unë do të flija duke u futur në çarçafët e ngrohtë që binin erë finjë. Ishte diçka midis vegimit e mendimit, po rrugën s'endjeja më.

Arrita në fshat. Ai që i heshtur; strehët e çative pikonin. Hyra në oborrin e shtëpisë sime. Edhe oborri që i ftohtë dhe i errët. Në të katër dhomat e shtëpisë s'kishte asnjë shenjë drite. Ata kishin rënë të flinin pa më pritur. Më erdhi keq për veten time. Trokita në xham e thërrita me forcë: :

— Nënë, hape portën!

U ndez një shkrepse e drita e saj shkëlqeu në xhamet e dritares. Ndjeva hekurin e portës që kërciti, dhe pastaj zërin e nënës;

— Erdhe, të keqen nëna?

— Erdha.

— Kushedi sa je lodhur...

— U lodha.

Zëri i nënës ishte i ngrohtë, i përzemërt e, sado

që unë isha disi i fyer ngaqë s'më kishin pritur, prapë-seprapë më pëlqente ta dëgjoja. E shkarkuam gomarin dhe i futëm thasët brenda. Ndjeva dorën e nënës të më prekte supet.

— Po ti qenke bërë qull! E shkreta unë! Gjithë pasdreken s'pushoi shiu e ne thamë: «si s'po pushon ky i flamosur; kemi dhe djalin përjashta. Shko, ndërrohu shpejt!»

U ngrit edhe gjyshja nga gjumi. Largoi velenxën tej e me një fytyrë të qeshur tha:

— U, djali! Na bëri pazarin e parë!

Dhoma ishte e ngrohtë dhe e qetë. Motra që flinte pranë gjyshes mori frymë thellë në gjumë dhe u këthye në krahun tjetër. Nëna u afrua pranë oxhakut, zbuloi prushin e vuri disa shkarpa të thata. Zjarri u ndez menjëherë. E shikoja dhomën me çudi e, si i ardhur nga një botë tjetër, më dukej se ishte bërë një kohë e gjatë qëkurse isha larguar, e s'më vinte të besoja se vetëm një natë s'kisha fjetur në shtëpi.

Kërkova ujë të vakur me kripë. Ma sollën menjëherë.

— Si e kaluat? — më pyeti nëna.

S'thashë asgjë nga ato që kisha menduar rrugës. Në atë ambient, ato që kisha hequr, më dukeshin të huaja e tepër të largëta, prandaj iu përgjegja shkurt.

— Mirë.

Nëna s'u kënaq me kaqë, donte të dinte diçka më shumë.

— Vetëm ërdhët? S'kishit njeri tjetër rrugës?

— Unë erdha, — i thashë ngadalë. — Leksi mbeti më prapa, se na u rrëzua kali i tij.

— Po ai ç'u bë? — pyeti nëna.

— Ai po vjen prapa. . .

Nëna heshti dhe më shikoi e menduar. Në atë vështrim ndjeva një qortim të hidhur e, ndonëse s'më tha gjë, unë nxitova të shfajësohesha.

— Po çfarë të bëja unë? Ndërsa ne po ngarkonim kalin e Leksit, gomari kishte ikur përpara dhe unë pastaj mezi e arrita.

Buzëqeshja që ndërej mbi fytyrën e nënës, duke e bërë të dukej si diçka praronjëse, u shkri menjëherë pas atyre fjalëve. Tiparet iu bënë serioze, dhe vështrimi i rreptë. Ajo sillej me mua gjithmonë e butë dhe e dashur, e gatshme të më falte çdo gabim, prandaj u ngurrosa kur e pashë të zemëruar, si s'e kisha parë asnjëherë.

— Dhe ti erdhe vetëm? Po si e le shokun në rrugë? Si s'të vjen turp!

Zëri i dridhej. Përveç notave të qortimit, vura re se ishte shumë e mallëngjyer, gati sa t'i shpëtonin lot. Duke kapërdirë pështymën, më tha me ndërprerje.

— S'ke bërë mirë, biri im. Ju u nisët bashkë e duhej të vinit bashkë.

Unë ula sytë. Më e keqja ishte se e ndjeja që ajo kishte të drejtë. Pse s'e prita Leksin atëhere kur arrita gomarin, po vrapova drejt shtëpisë? Çfarë bënte Leksi dhe ku do të ishte? Mos vallë i ishte rrëzuar kali përsëri? Mos kishte mbetur në rrugë?

Këto pyetje as që më kishin shkuar ndër mend

përrjashta. Atëhere isha lodhur, e mendoja vetëm për veten time. Doja të arrija sa më parë në shtëpi, të ngrohesh, të çlodhesh e të flija, sidomos të flija.

Nëna u ngrit nga vendi, bëri një thes si xhokë, e hodhi mbi kokë që të mos lagej nga shiu dhe doli prej derës. Ndjeva hapat e saj në oborr dhe pastaj portën e jashtme që kërciti. Më pushtoi përnjëherësh një hidhërim i madh. Pas asaj rruge të gjatë, pas lodhjes e ngricës, s'ndjeja asnjë prej atyre gëzimeve që kisha menduar se do të shijoja në shtëpi. Doja t'ja mbushja mendjen vetes se s'kisha bërë asnjë gabim dhe se kushdo që të ishte në vendin tim, ashtu do të kishte vepruar: Dhe, duke përsëritur këtë me mend, shkoja nëpër duar thekët e qilimit, po dikush nga brenda më përgjigjej vazhdimisht: «s'bëre mirë, s'bëre mirë, s'bëre mirë!».

Isha shumë i hidhëruar. Atëhere s'e kuptoja përse, po më vonë e kuptova; ishte mësimi i parë që më jepte jeta.

ZEMËRIMI

Fusha e madhe prej qindra hektarësh, ku gruri i pjekur dallgëzohej nga era, dukej si një det ngjyrë floriri. Vetëm autokombajna dilte sipër këtij dallgëzimi e ngjante për çudi me një anije që noton, sepse herë përkulej në njerën anë e herë në anën tjetër. Kashta e grurit lëshonte pluhurin që kishte mbledhur gjatë verës dhe kjo re e mërztishme e shoqëronte kombajnën në gjithë rrugën e saj.

Mbi kombajnë Nesti dhe ndihmësi i tij, Mitri, punonin pa shkëmbyer asnjë fjalë. Ata ishin krenar në mendimet e tyre dhe kishin rënë në atë gjëndje që bien dy njerëz, të cilët, mbasi ja kanë thënë të gjitha njëri-tjetrit s'kanë se ç'të thonë më. Fusha digjej nga vapa. Fshatrat ishin tej. Ato mezi dukeshin të fshehura në mes të blerimit të pemëve të larta, dhe në mes të ditës të jepnin përshtypjen se ishin tulatur në hije për t'u shpëtuar rrezeve përvëltonjëse të diellit. Në disa parcela, pranë fshatit Selishtaj, kooperativistët korrnin me drepinj; trikot dhe fustanet e vajzave e thyenin ngjyrën monokrome të fushës e dukeshin si flamuj ngjyra-ngjyra. Puna e tyre në krahasim me kombajnën nuk binte fare në sy.

Kombajna hante me një etje të pashuar grurin e rritur dhe aty për aty ja ndryshonte pamjen fu-shës; pas saj s'kishte më det ngjyrë ari e dallgëzime. Krëhëri vërtitej vazhdimisht duke i goditur kallinjtë e grurit si me kamzhik, e poshtë dhëmbët e mprehtë, si të një maqine qethëse vigane, e grinin kashtën me lehtësi të çuditshme. Kombajna uturinte Rulet vërti-teshin duke lëshuar një kërkëllimë shurdhonyjëse. Rrezet e diellit të korrikut, të nxehta e të pamëshir-shme e shtonin edhe më shumë nxehtësinë që krijonin vetë motorat e fuqishëm të kombajnës.

Diellit s'kishte si t'i shpëtoje dhe gjithë maqina lëshonte një afsh të nxehtë që të digjte sytë e të merrte frymën.

Ishte një punë e rëndë. Megjithatë Nestit nuk i bënte përshtypje se ishte mësuar. Atij i fluturonte zemra nga gazi, kur sillte ndër mend se, me të perënduar dielli, do të vinte ajo vajza e bukur për të ushqyer pulat e fermës. Me trikon e kuqe, me fustanin bojë qielli e me atë shaminë e bardhë lidhur në kokë, Eli ngjante me një flutur pranvere që shket sipër kallinjve të grurit.

Duke e dalluar që larg, Nesti i shkelte gazin au-tokombajnës dhe i hipte një dëshirë e papërmbajtur që në ato çaste të bënte një diçka të mrekullishme, të bukur. Ajo e shikonte dhe buzëqeshte, kjo buzë-qeshje ishte shpërblimi më me vlerë që merrte ai gjatë ditës; Pastaj i dilte përpara, ja merrte torbën me gëzhuta, të cilën ajo e mbante në dorë, dhe të dy së bashku shkonin gjer në fermën e pulave.

Ndihmësi nuk luante nga kombajna. Ai bënte

sikur rregullonte diçka dhe, që nën strehën e gjerë të kapellës i shoqëronte me vështrim, derisa ata humbnin prapa pemëve të një kishe të rrëzuar. Pastaj ndihmësi shtrihej më kurriz në fushë duke shikuar qiellin e lartë. Aty më tutje, mbi një kamineto, valonte gjella e darkës.

Për shkak të asaj dashurie e të atyre çasteve të mbrëmjes, Nesti nuk e vinte re se si kalonte dita.

Kurse këtë herë dita s'kishte të mbaruar. Nesti kthente kokën vazhdimisht e shikonte në drejtim të shtëpive të fshatit. Në fytyrën e tij të nxirë nga dielli e djersa dukej një shqetësim i thellë. Dhe në buzë i kishte ngrirë një pyetje: «Vallë, a do të vinte ajo?»

Ai s'dinte të mbante gjë të fshehtë, dhe që në mëngjez i kishte thënë Mitrit se Eli qe zemëruar me të.

— Pse? — e pyeti Mitri.

— Kot fare! — tha Nesti duke kthyer vështrimin në anën tjetër. Në Selishtaj do të shpalleshin brigadat e punës socialiste dhe me atë rast rinia kishte organizuar një mbrëmje dëfrimi. Kishin ftuar edhe miq.

Nesti dhe Eli ishin ulur në një stol afër skenës. Se si ra fjala për dashurinë dhe Nesti, duke ndërhyrë në bisedë, tha:

— Çdo dashuri nuk mund të përfundojë me martesë.

Eli ndjeu se diçka e zhuriti në kraharor. Pse e tha ai atë fjalë? I hodhi Nestit një vështrim, sikur të kishte zbuluar te miku i saj një njeri tjetër. Nesti e ndjeu këtë vështrim dhe uli sytë.

- Pse, për t'u tallur thua ti? – pyeti Eli.
- Unë s'them për vete, moj Eli, – u mundua të arësyetonte Nesti. – Unë them se martesë dhe dashuria janë dy gjëra të ndryshme.
- Ashtu vërtet, njeriu dashuron që të ketë mundësi të zgjedhë shokun a shoqen e jetës, – ndërhyri shoku i tij.
- Që të zgjedhë? – pyeti Eli thujse me inat.
- Po, natyrisht.
- A, domethënë të provojë një tri a katër dhe pastaj të marrë kë t'i mbushet mëndja. Jo, more, kush të ka mësuar kështu ty?
- Unë s'them për vete, moj Eli.
- Po për kë thua?
- Thashë ashtu kot... – u mundua të shfaqësohej Nesti.
- Pse s'the një gjë tjetër, po the këtë?
- Nesti ngriti supet.
- Sepse këtë kishe menduar.
- Shiko, mos e merr kështu! – iu lut Nesti.
- S'ka nevojë të zgjatesh më tej. E kuptova fare mirë.
- Ajo u ngrit me vrull nga vendi. Nesti e zuri nga dora.
- Eli!
- Lëshomë!
- Ajo e shkëputi dorën dhe, duke u rënë flokëve mënjanë me mospërfillje, iku pa u thënë as natën e mirë.
- Ç'na bëre! – i tha Nesti shokut që kishte në krah.

— Unë? — u habit ai. — Ç'të bëra unë?

— Budallallëk! — tha Nesti. — Po edhe mua ç'mu desh? Sikur s'kisha ç'të thoja tjetër. . .

Ai e dinte se Eli ishte krenare, veç kurrë s'e kishte parë të fyer e të zemëruar. Vallë, sa do të zgjaste zemërimi i saj? Mos midis tyre ishte prishur lidhja njëherë e përgjithmonë? Ai ishte në merak, dhe orë e çast thonte me vete: «do të vijë vallë?».

Autokombajna korrtë duke u lëkundur sipas vrageve të tokës. Hekurat e saj të shumë të kërcisnin me një zhurmë monotone e të thatë. Afshi i nxehtë, që lëshonte motori dhe pluhuri i fushës të merrte frymën. Nesti e ngadalësoi shpejtësinë, sepse afroi te një brazdë kullimi.

I tha ndihmësit:

— Ama ç'na gënjeu kryetari! I kemi sheshuar brazdat, tha, mos kini merak, kurse shiko si i ka lënë. Po të mos e kesh mendjen, e prish kombajnën kur të duash. Këto na pengojnë shumë, sepse s'korrim dot me shpejtësi.

Mitri s'dinte si t'i përgjigjej, se edhe për këtë gjë kishin biseduar disa herë. Ai heshti.

Pas pak Nesti e pyeti:

— Mitri, si thua ti, do të vijë ajo?

— Mundet.

— Kurse unë s'kam shpresa fare.

— S'dihet. . .

Filluan sërish nga puna. Autokombajna vinte e vinte duke i ngrënë sllogjet e grurit me radhë. Ca nga ca dielli po perëndonte dhe po afronte çasti kur

Eli duhej të vinte. Po ajo sigurisht s'kishte për të ardhur. Nesti kthente kokën e shikonte i përqëndruar rrugicëzën e ngushtë që dilte nga fshati.

Papritur ai dalloj tej një vajzë me triko të kuqe, që po vinte në drejtim të tyre. Nesti e frenoi menjëherë autokombajnën e, duke u ngritur në këmbë, klithi nga gëzimi:

— Mitri, po vjen, po vjen, shiko atje!

Mitri vuri dorën si strehë mbi ballë dhe shikoi me kujdes atje përfund fushës, ku, midis ngjyrës së verdhë, dukej një pikë e kuqe që lëvizte. Ndjeu sikur u çlirua nga një ankth që e kishte munduar gjithë ditën. Duke buzëqeshur ktheu vështrimin nga Nesti. Atij i shkëlqenin sytë, dhe nën këmishën e lerosur dhe të nxirë nga pluhuri gjoksi i ulej dhe i ngrihej vazhdimisht.

Mitri kërcë: në vendin e tij dhe shtrëngoi me duar timonin. Autokombajna uturoi. Maqina e rëndë, duke u lëkundur, u nis në fillim ngadalë e pastaj gjithmonë e më shpejt. Më kot thërriste ndihmësi:

— Nesti, mos e nxito kaqë shumë!

Çdo gjë përreth u bë më e bukur dhe përnjëherësh mori jetë. Ku ishte gjithë ajo dritë, ku ishte ajo bukuri e madhe që ai s'e kishte vënë re gjithë ditën? Fusha që si një qilim madhështor me push, kallinj të e grurit ngjanin me ca zogj që ishin gati për të flutuar në ato malet përtej ngjyrë vjollce, sipër të cilave një napë blu, një diçka e prekshme, e butë dhe përkëdhelëse dukej sikur i kishte veshur të gjitha gjërat. Autokombajna ishte si një aeroplan, mbi të cilin Nesti fluturonte midis asaj kaltërsie të muzgut.

Edhe në shpirt diçka iu çlirua dhe iu bë më e lehtë, sikur të kishte dalë nga kufitë e tokës dhe ta kishte humbur krejt peshën, të endej i lirë në hapësirë ashtu si të donte. Dhe punën e bënte instinktivisht. Puna ishte kënaqësi, nevojë, gëzim, një fushë ku derdhte ato energji të mëdha që dashuria i kishte ngjallur në shpirt.

Eli sigurisht do të ishte afruar mjaft. Ai e kishte ndjekur me sy shtegun nëpër të cilin po vinte ajo dhe, padashur kishte thënë me vete: «po shaminë e bardhë pse s'e paska vënë sot?».

E ndali autokombajnën dhe, si për t'u gjendur në punë, shkoi dorën në faqe. Gishtrinjtë i prekën qimet e ashpra dhe të parruara që prej dy ditësh. «Qenkam i parruar», mendoi me dëshpërim. Shikoi këmishën e nxirë nga djersa dhe pluhuri dhe shtrembëroi buzët. «Edhe këmisha qenka bërë pis. Më duhet një xhaketë tjetër.»

— Mitro, më jep pak xhaketën tënde.

Mitri ja hodhi nga sipër pa i thënë asnjë fjalë. Nesti e veshi me kujdes, u rrotullua në vend dhe u nis t'i dilteELIT përpara. «Sa mirë që erdhi», thoshte me vete.

— Nesti, më mirë mos shko, — e këshilloi Mitri — rri këtu!

Ç'kuptim kishte kjo? Ai vërtet ishte pak i shqetësuar se si do të shkonte takimi i parë pas zemërimit, po përderisa ajo kishte ardhur, dukej se çdo gjë do të përfundonte më së miri. A nuk ishte ky një fakt që tregonte se ajo nuk i qe zemëruar? Apo mos vallë vinte sa për t'u dhënë pulave ushqim dhe Nestit

nuk do t'i kthente kokë? Megjithëse e mundonin këto pyetje, ai më shumë vraponte se sa ecte. Një herë i shkoi mendja të fshihej në hendekun prapa urës së vogël e me të ardhur Eli të ngrihej përnjëherësh e ta trembte. Ajo do të vinte dorën në gjoks e, kur ta njihte se kush e kishte trembur, do t'i thoshte duke iu ankuar e duke iu përkëdhelur: «Oh, sa më trembe, më ngrive gjakun!»

Kështu ja kishte punuar nja dy herë dhe pas kësaj shakaje ata duheshin më shumë. Kurse këtë radhë ai e ndjente se kjo shaka nuk shkonte fare. «Më mirë t'i them hapur: Eli, më fal, po unë s'po flisja për vete! Dhe ajo do të më kuptojë. Sigurisht do të më kuptojë, në qoftë se edhe ajo më do».

U takuan papritur ballë për ballë.

Nesti e shikoi një herë me habi, e pastaj me dhembje. Ajo nuk ishte Eli. Një tjetër vajzë kishte triko të kuqe dhe mbante në dorë një torbë me gëzhuta. Pra Eli s'kishte ardhur.

Ndjeu se, me humbjen e saj, diçka e ndritshme, si një sferë e vogël, i kishte dalë nga gjoksi dhe po fluturonte tej në qiellin e pamasë, duke u tretur gjithnjë më shumë. Hidhërimi i humbjes e kishte mpirë.

Çdo gjë përreth u errësua. Shkëlqimi i fushës u venit menjëherë. Fusha e lodhur nga vapa dukej sikur kotej përgjumësh. Ca stërqoka fluturonin me përtim në qiellin blu. Autokombajna, e anuar pakëz me njërin krah, i ngjante si një grumbull hekurash të harruara e pakuptim.

— S'ishte ajo... — i tha ndihmësit me një zë të kapitur.

— Unë e njoha, prandaj të thashë mos shko.

Nesti u shtri përmbys mbi togun e grurit. Mbështeti kokën mbi llërë dhe mbylli sytë.

Mitri, i pazoti ta ngushëllonte, e shikonte me dhembje. Ai donte t'i afrohej, të zgjaste dorën e, duke i lëmuar supin, t'i thoshte disa fjalë të mira, ngushëllonjëse, po këto fjalë s'i gjente dot. Megjithatë deshi ta thyente heshtjen që rëndonte dhe, si të kishte frikë se mos e zgjonte nga gjumi, tha ngadalë.

— Nesti!

Kombajneri hapi sytë. Ata ishin të lagur.

— Si do të bëjmë, Nesti, a do të korrim më?

— Nesër... Tani s'më punohet...

Mitri trazonte grurin me këmbë. Ato shpatullat e rrëzuara i kishin dalë akoma më shumë. I vinte inat me veten e tij, se të tjera gjëra donte të thoshte e të tjera gjëra i dilnin nga goja thuajse kot.

Për një çast iu duk se e gjeti rrugëdaljen, sepse me gëzim i propozoi:

— Nesti, pse bëhesh budalla? Eja të vemi në klub, kam unë lekë...

— S'më pihet! — ja ktheu Nesti, pastaj me një zë tjetër shtoi: — Mitri, unë do të iki nga kjo kooperative. Do t'i them brigadierit të më shpjerë në anën tjetër të lumit. Nuk qëndroj dot më këtu... s'më rrihet.

— Sa budalla që bëhesh! Kushedi si i ka rënë puna. Ti s'e pyete atë vajzën?

— Jo.

— Ta kishe nvetur. — do kishte bërë mirë. Mbase Eli është sëmurë...

Nesti u ngrit në këmbë.

— Më erdh' rëndë ta pyesja. Po pse, s'e kuptoi ajo, thua ti?

— Të vete të pyes unë në fshat?

— Jo, jo, rri këtu, s'ke kë pyet, — tha Nesti i vendosur. Unë do ta pres edhe nesër. Po nuk erdhi edhe nesër, atëhere të dielën do të vete ta takoj në fshat. Unë nuk i ndahem asaj.

Kur u shtruan të hanin darkë, Nesti i tha ndihmësit si t'i besonte një të fshehtë të zemrës:

— E di që, Mitri? Unë s'e dija që e doja kaqë shumë!

GËRSHETAT

Ndihmës mjekëve —
kudo që janë

Vali rrinte me fshesë në dorë në ballkonin e shtëpisë dhe, si e harruar, vërente harabelat që fluturonin. «Ja tani edhe pakë, sa të perëndojë dielli i korrikut, dhe harabelat do të mblidhen të gjithë në ata dy plepat e lartë pranë mullirit, — mendonte. Atje do të fillojnë një koncert të çmendur prej cicërimesh dhe ky koncert do të zgjatë deri sa të bjerë nata e qetë dhe e vakët».

Vali thoshte me vete ndofta për të njëqindtën herë:

«Pse bëjnë kështu para se të bien në gjumë? Zihen për vendet, si nxënësit e klasës së parë, apo gëzohen që mblidhen së bashku?».

S'e gjente dot këtë të fshehtë, dhe ëndërronte të kishte krahë për një çast e të vinte t'i shikonte me sytë e saj. Dhe shpesh kishte përshtypjen sikur bëhej zog e fluturonte së bashku me harabelat në plepat e lartë.

Pastaj Vali shikoi qiellin. Retë ishin shtrirë në

vijë të drejtë, sa në qiellin e pamasë dukej sikur ishin ndërtuar rrugë të reja, të drejta e të pafundme. Vallë, ku të çonin ato rrugë?

Nga ëndërrimet e zgjoi zëri i fortë i babait.

— Vali, shko na mbush ca ujë të ftohtë, se na u tha gryka.

Vali zbriti shkallët dhe hyri në kuzhinë. Pranë zjarrit qe ulur e ëma, Vita, si e thërrisnin ata në shtëpi. Ajo ruante qumështin të mos i derdhej dhe njëkohësisht përgatiste sallatën për darkë.

Vali mori gjymet dhe u nis për në krua. Në murin pranë kroit, si çdo mbrëmje, rrinin një tufë djemsh. Ata, duke biseduar e duke bërë shaka me njëri-tjetrin, hidhnin vështrime të shpejta në rrugë, aty ku kalonin vajzat me gjyme në krahë.

Sa u afrua Vali, njëri prej tyre, si nën buzë, ja mori një kënge me zë të ulët. Por nga kjo këngë, ai këndonte gjithmonë dy vargjet e para, të cilat flisnin për një palë gërsheta të bukura. Një dorë e panjohur i kishte shkrojtur dy vargjet e kësaj kënge edhe në kanatin e portës së Valit.

**«Gërsheta si ato të tuat
Nuk gjenden në botë. . .»**

Kur i vuri re për herë të parë, Vali u drodh nga inati dhe deshi t'i fshinte menjëherë, po pas pak zemra e saj u zbut nga ai lloj komplimenti dhe pas disa ditëve, sa herë dilte nga porta, i pëlqente t'u hidhte një vështrim shkarazi e t'i kundronte si një të fshehtë të ëmbël, të cilën e dinte vetëm ajo. Flokët i

kishte shumë të bukur, këtë ja thonin të gjithë. po vallë, cili ishte ai që kishte guxuar t'ja shkruante ato vargje në portë? Paskali, apo ndonjë djalë tjetër?

U kthye nga kroi duke menduar se pas një muaji gjithshka do të ndryshonte. Do ta linte shtëpinë dhe këtë rrugën e kroit plot guralecë dhe do të fillonte një jetë tjetër. Valit i kishte dalë bursa për në shkollën mjekësore në Tiranë dhe s'i pritej sa të nisej. Vallë si ishte Tirana? Kur binte në shtrat, ajo mbyllte sytë dhe mendohej ta parafytyronte. Si nëpër mjegull i dilte një qytet i madh, me rrugë të gjera, me ndërtesa të shumta, me njerëz të veshur bukur, ku çdo gjë ishte e pastër dhe shkëlqente. Në imagjinatën e saj ngjallej një qytet fantastik që vezullonte nga ngjyrrat e dritat. E, pikërisht sepse e mendonte aq të bukur, i dukej se s'do të kishte fatin ta shikonte kurrë. Ishte një lumturi kaq e madhe, sa i dukej e pabesueshme.

Sidomos i therte zemra kur sillte ndër mend se si e kishte pritur i ati lajmin e bursës.

Mamaja që gëzuar, ajo e kishte puthur me dashuri në faqe, ndërsa sytë i qeshnin e i shkëlqenin. Dhe në kulm të atij gëzimi i kishte thënë Valit:

— Tani shko i thuaj edhe babait.

Vali e kërkoi, duke thërritur nëpër shtëpi «baba», «baba», e duke hyrë me vrull nga një dhomë te tjetra. Ai nuk qe. Ajo e kërkoi në oborr e pastaj në kopsht, po as atje s'e gjeti.

— Mos e ke parë babanë? — pyeti vëllanë e vogël, që po luante në oborr me këlyshin.

— Në haur është, më duket.

Vali rendi në haur. Babanë e gjeti me sqepar në dorë duke rregulluar grazhdet. Ai po mbërthente një gozhdë e nga trari i vjetër, i shkruar si me hieroglifë nga krimbat që s'kishin lënë vend pa e ngrënë, sa herë që godiste sqepari, ngrihej një re pluhuri.

— Baba! — i tha Vali me gëzim — më ka dalë bursa për në Tiranë.

Ai as e ngriti kokën ta shikonte, por vazhdoi të mbërthente dhogën me vëmendje e kujdes. Bëri sikur s'dëgjoi, por në të vërtetë kishte dëgjuar fare mirë. Duke vazhduar punën, ai mendonte si, t'i përgjigjej, t'ja prishte që atë çast, apo ta linte për më vonë? Megjithatë, edhe kur e mbaroi punën, ishte akoma në mëdyshje:

— Si the? — e pyeti serioz.

— Më ka dalë bursa për në shkollë. Sapo më lajmëruan... Unë u gëzova shumë, ja thashë edhe mamasë...

— Ja, hallin e bursës tënde kemi ne tashti...

Valit i ngriu gazi në buzë. Gjithë lumturinë që i vlonte në shpirt, i ati ja theu me atë frazë të vrazhdë. Fytyra që i shkëlqente, iu zbeh dhe sytë i uli përtokë. Donte të ikte, të ikte sa më parë nga ai vend.

I ati, Xhezmiu, e vuri re hidhërimin e saj dhe i foli:

— E pse ngrive kështu? Kemi kohë për atë punë, tani shko më sill ca perona se m'u mbaruan. Në sëndukun prapa derës së qilarit janë.

Vali iku. Letrën që mbante në dorë e kishte zhumbrosur dhe akoma po e shtrëngonte pa e pasur mendjen. «Pse më priti ashtu babai? Mos vallë nuk i pël-

qen që të vete në shkollë?» Ky dyshim që i lindi në ato çaste, iu duk pa vend, sepse babai, po të mos donte ta linte, pse e kishte lejuar të bënte lutjen?

Ajo ishte e re, dhe akoma s'ishte në gjendje të analizonte psikologjinë e të jatit. Xhezmiu s'i kishte kundërshtuar kur bëri lutjen, sepse shpresonte që së bijës nuk do t'i dilte bursa, dhe atëhere ai sa për sy e faqe do të shfaqte pikëllimin e tij duke e ngushëlluar Valin:

— Mos u mërzit, çupa e babait. Edhe unë kisha qejf të të dërgoja në shkollë, po, siç e shikon, s'qe fat, sepse s'të doli bursa. Kështu e kanë këto punë, do të kesh ndonjë mik. Ne mik s'kemi...

Mirëpo, ja, Valit i kishin dhënë bursë pa thënë as gjysmë fjale e pa trokitur asgjëkundi. «Si është e mundur kjo gjë? — mendonte — vallë nga notat e mira? Ku ta dish, po besoj kjo do të jetë... E kanë parë dëftesën e saj me nota të mira dhe kanë thënë: «dale ta shpiem në shkollë.» Do të më hapë punë kjo çupë...»

Vali solli gozhdët, ja la atje pranë pa i thënë asnjë fjalë dhe iku. Hidhërimi i saj qe i çiltër, ashtu si i gjithë të rinjve, dhe i lexohej në fytyrë. Xhezmiu e shikoi tek po largohej dhe tundi kokën.

— Si qelqe e kanë zemrën gratë... Po u the një fjalë që s'u pëlqen, ndryshohen menjëherë. Ja dhe kjo, megjithëse është e vogël, s'i ka lënë gjë mangut së ëmës. Shih si i vari turinjtë...

Vali mendohej ta përlligjte qëndrimin e të jatit dhe, ditët e para, mendonte se babai ndofta atë ditë kishte qenë i lodhur dhe, prandaj s'kishte shfaqur as-

një shenjë gëzimi. Megjithëse kur kujtonte zërin e tij dhe shprehjen e fytyrës, nuk i vinte të besonte se shkaku kryesor ishte lodhja. Ai as më vonë s'e kishte zënë ngoje çeshtjen e bursës, dhe kjo nuk ishte shenjë e mirë. Vali dyshonte se babai s'do ta lejonte të shkonte në shkollë, dhe priste me ankth ditën kur në shtëpinë e tyre do të hapej ajo bisedë.

* * *

Xhezmi Dervishi ishte më shumë kurnac se fanatik. Ai mendonte se po të vinte Vali në Tiranë, sado që me bursën e shtetit, do t'i duhej edhe atij të harxhonte për nja katër vjet. Do t'i duhej të blinte fustane të mira, këpucë e sandale dhe herë pas here duhej t'i dërgonte edhe lekë. Atje në fshat ajo mund ta kalonte dimrin me një fustan dosido e me një triko të grisur të bërrylet, kurse Tirana kërkonte gjëra të mira e të kushtueshme. Ai mendonte se Vali e kishte mjaft shkollën shtatëvjeçare, më shumë s'kishte ç'i duhej. Ndjehej i kënaqur kur parafytyronte se tani e tutje ajo do të rrinte në shtëpi të gatuar, ndërsa ai me të shqen do të punonin në kooperativë. Meqë ishin dy krahë pune, do të kishin të ardhura të mira. Edhe për Valin kështu s'do të ishte keq; ajo do të mësohej me punët e shtëpisë e do të bëhej një amvisë e mirë.

Erdhën ditët e fundit të gushtit dhe shoqet e Valit, atyre që u ishte dhënë bursa tashmë ishin pregatitur për t'u nisur.

Ditët e fundit Vali rrinte gjithmonë me një shoqe, të cilën s'e kishte çmuar aq shumë. Më shumë se dashuria ato i bashkonte i njëjti hall, i njëjti hidhërim. Edhe Netën, — se kështu e quanin shoqen e saj — prindërit s'dëshironin ta linin në Tiranë. Ata hiqeshin fanatikë pa qenë të tillë, dhe kishin ca mendime të çuditshme në kokë. Vajzën e tyre e mbanin për shumë të bukur, dhe i gënjente mendja se Tirana do të humbte mendjen pas saj. Ata me fantazinë e tyre thurnin e stërthurnin ngjarjet që do të zhvilloheshin, ku ndërthureshin disa drama e disa tragjedi.

Po më së fundi, ashtu siç pritej, kur vunë re se prindërit e tjerë, i nisën vajzat e tyre, u bindën dhe thanë ato fraza të zakonshme e banale që thuhën në këto raste: «Atje ku venë të tjerat, le të vejë dhe vajza jonë.»

Një mbrëmje, Vali kishte larë kokën e po terte flokët pranë zjarrit. Flokët e saj kishin një shkëlqim të artë saqë Neta s'e mbajti dot veten e, duke zgjatur dorën, i përkëdheli duke ja lëmuar:

— Sa flokë të bukur që ke ti, Vali!

— Ç'pyet! — i tha Vali, pa u dhënë rëndësi fjallëve të saj. Ajo gati sa nuk qante prej hidhërimit. E ndjente se i ati po ja mbyllte përgjithmonë dyert e shkollës. Neta të nesërmen do të shkonte. Sa mirë sikur ta lejonin edhe Valin! E ëma i kishte premtuar

se do të përpiquej, por në rast se babai do të ngulmonte, ajo s'kishte ç'të bënte. Edhe fustanet që kishte qepur me këtë rast, gjysmëfshehura nga babai, do të mbeteshin si një dëshmi e hidhur, si një kujtim nga ato ditë plot ëndrra e shpresa.

— Ju do të mbaroni shkollën e mesme, kurse unë... — tha Vali dhe s'mundi ta mbaronte frazën.

Neta iku. Vali mbeti përpara pasqyrës së vogël, duke shikuar atje një fytyrë të njohur, dy sy të mbushur me lot dhe një ballë të rrudhur.

Në mbrëmje, kur u ulën të hanin bukë, Vali ndejti mënjanë.

— Pse nuk ha bukë ti, Vali? — e pyeti babai.

— Nuk më hahet...

— Hëëë... — foli Xhezmiu nëpër dhëmbë, pa dashur ta shprehte mendimin gjer në fund.

— Asaj nuk i hahet nga hidhërimi, — tha Vita.
— Ja, edhe Netën, që s'e linin prindërit, tani e lejuan dhe ajo nesër do të shkojë.

— Ha bukë ti, ha, se mos mbytesh — i tha Xhezmiu me inat, duke mos dashur në asnjë mënyrë ta hapte atë kuvend. Nga toni i rëndë e fyes që përdori, ai desh i t'i jepte të kuptonte së shoqes se kjo s'ishte punë për të dhe do të bënte mirë të mbyllte gojën e të mos përzihej fare. Po e shoqja nuk u trondit dhe, si të mos e kishte dëgjuar qortimin e rëndë të Xhezmiut, vazhdoi:

— Mirë them, të gjitha shkuan, vetëm vajza jonë mbeti... Ne pse të mos e dërgojmë në shkollë? Ç'kuptim ka kjo? Atëhere kot që doli e para në shkollë...

— Kot! — tha Xhezmiu, duke dashur ta mbyllte sa më parë atë bisedë.

— Venë ca të humbura në shkollë, dhe vajza jonë të rrijë... S'e ke mirë, ti të luteshe vetë...

Tani Xhezmiu s'kishte si t'i bënte ballë me hesh-tje ose duke pohuar fjalët e saj. Ndeshja ishte e pash-mangshme. Vita vazhdoi:

— Të mos i kishin dërguar dhe bota, mund të thojë: «e po gjersa s'i dërguan të tjerët, as ne s'po e dërgojmë...»

Ai nuk i duronte dot gjykime të tilla, dhe ja preu me zemërim:

— Nuk dua të shikoj botën, unë bëj ashtu si më bëhet mirë mua dhe shtëpisë sime. Ja, u mbytën në lumë shoqet e saja, do vejë dhe kjo të mbytet?

— S'është fjalë ajo që thua ti. Po të ishte për t'u mbytur, nuk i dërgonin ata.

Ndiheshin vetëm lugët që trokisnin në sahan. Pas pak Vita tha:

— Ti, në je fanatik...

Asgjë s'do ta kishte nevrikosur më tepër Xhez-miun se kjo fjalë e lëshuar gati-gati kot. E shoqja me mospërfilljen më të madhe e kishte quajtur fana-tik... Xhezmiu u nxeh dhe filloi të bërtiste:

— Ti s'di të gjykosh, moj t'u mbylltë dera! Ti s'ke mend as... — mundohej të giente në inat e sipër një krahasim poshtërues dhe iu duk se e gjeti — as sa një pulë! — tha më së fundi. — Unë shikoj të mirën e shtëpisë dhe të çupës sonë. E kam lënë zhveshur a, e kam lënë zbathur a, e kam lënë pa ngrënë, pa më thuar? Nuk isha unë ai që e dërgova në shkollë,

nuk isha unë që e lashë në festival? Dhe qënkam fanatik, ë? Nga më nxjerr mua fanatik, moj të hëngërt mortja.

Vita vazhdoi të hante ngadalë, duke pritur me njëfarë qetësie të shtirur sa të mbaronte kjo furtunë.

— Edhe për burrin, — vazhdoi Xhezmiu — kur t'i vijë sëra asaj pune, le të marrë kë të dojë, unë nuk i ndërhyj. Pa më thuaj tani, kështu janë fanatikët?

Në shenjë përbuzje i ktheu kurrizin së shoqes dhe, duke mos iu drejtuar askujt, tha:

— Fjalosu me njerëz të tillë, pastaj!

Në dhomë pllakosi një heshtje e shkurtër. Pastaj Xhezmiu u kthye nga e bija. Asaj i foli me një ton të butë, në të cilin s'ndihej asnjë fije zemërimi:

— Ti je e zgjuar vetë, moj çupë, dhe mos dëgjo tët ëmë, se kjo s'ka mend për vete. Ç'është kjo shkollë tani larg shtëpisë? Mbarove shtatëvjeçaren mirë e bukur, ç'të duhet më shumë? Rri pranë familjes rehat; pse të kesh kokëçarje të tjera? Puno sa të kesh qejf e kur të të punohet, të mësosh nga rregulli i shtëpisë, se pas dy-tre vjetve do të martohesh; të bësh ndonjë gjë për pajë. Të gjitha këto, për veten tënde, unë s'të kërkoj asgjë. Po u mërzite në shtëpi, të gjej-më dhe ndonjë punë këtu afër, ja, futu rrobaqepëse.

Vali s'fliste. Nga fytyra e saj e mërzitur dhe e ngurosur Xhezmiu e kuptonte se s'po i pëlqenin këshillat që i jepte. Atëhere ja ktheu ndryshe:

— Ja, s'do të kishte dalë bursa... atëhere ç'do të kishe bërë? Këtë të mendosh.

— Atëhere do që ndryshe, nuk do të më vinte maraz, po tani pse të humbas bursën?

Xhezmiu filloi të lutej e të kërkonte mëshirë. Ai e dinte se kjo është mënyra më e sigurtë, për të zbutur zemrën e ndjeshme të të rinjve.

— Shiko, moj Vali, të të vijë keq edhe për ne. Po ike ti, një herë ujë të ftohtë s'ka kush të na mbushë. Ne duam të të kemi pranë, të na gëzohet syri kur të të shikojmë. Edhe jot ëmë u plak, s'i bën dot të gjitha punët...

Valit i erdhi keq dhe uli kokën. Xhezmiu u qetësua, se puna po mbyllej në anën e tij. Në këtë çast kritik, Vita tha me një zë të qetë.

— Punët? I bëj, i bëj dhe vetë.

Xhezmiu u kthye menjëherë në drejtim të saj e filloi ta përqeshte duke ngërdheshur fytyrën:

— I bëj, i bëj... Të kam parë si i bën.

— Pse, ore, vetë i kam bërë, mos kam thërritur botën?

— I ke bërë se ke pasur çupën këtu. Po tashti që ajo do iki, si do t'i bësh?

— Ca nga ca... Punët s'mbarohen kurrë. Po pse, kur të martojmë çupën, kush do të t'i bëjë punët ty? Ja, unë do t'i bëj gjene.

Xhezmiu e ndjeu se arësytimi i saj qe shumë i fortë dhe i drejtë. Këtij arësytimi të shkëlqyer të nxjerrë nga jeta, s'kishte si t'i kundërshtonte veç me ndonjë frazë bajate dhe arrogante.

— Mbylle gojën! Mjaft na çave veshët?

— Edhe im vëlla ashtu tha, — ndërhyri Vita, — le të vejë Vali në shkollë.

— Edhe ai se mos ka mend më shumë nga ti...

— Të vejë, — tha Vita e vendosur — të hapë sytë për veten e saj.

Vita dëshironte që e bija të mos mbetej prapa shoqeve, dhe me çdo kusht të shkonte në shkollë. Ajo tani për tani shtyhej vetëm nga sedra, meqenëse të tjerët i kishin dërguar fëmijët në shkollë, duhej që edhe këta ta dërgonin Valin. Po prapa kësaj sedre kishte diçka tjetër më të madhe, që ajo e ndjente po nuk arrinte ta shfaqte e ta kuptonte: qenë dëshirat e gjithë brezit të saj të rritur në terr e në padije, që e shtynin të tregohej aq e fortë dhe këmbëngulëse për çeshtjen e së bijës. Ajo i kundërshtoi të shoqit me një vëndosmëri të jashtëzakonshme dhe arriti derisa e ngushëlloi Valin me këto fjalë:

— Mos qaj, se të nis mamaja nesër ty! Le të thotë ky...

Kjo përgjegje e zemëroi Xhezmiun dhe, duke shkumëzuar nga inati, u grrit në këmbë.

— Unë nga inati yt s'kam për ta lënë! Ja, tani po thosha me mend se do ta lejoja, kurse tani s'kam për ta lënë, sikur edhe im atë të ngjallet nga varri. Dhe ta dish, për inatin tënd. — Këto fjalë i thoshte kot, sepse asnjëherë s'kishte menduar se do ta lejonte, po i theksonte enkas që të thyente këmbënguljen e së shoqes e që Vitos t'i dukej se me kokëfortësinë që kishte treguar, s'kishte bërë gjë tjetër veçse i kishte prishur punë së bijës.

Vita nuk u besoi fjalëve të Xhezmiut, dhe e kuptoi pse i thoshte.

— Posi, do ta lejoje... Llafe! Ti me kaq të thëna e s'u binde. Të njoh unë tashti, të njoh.

Xhezmiu dhe Vita ndryshonin nga shumë anë të karakterit, po nga kokëfortësia i kishin ngjarë një-ri-tjetrit.

— Dhe ti! — iu kthye Xhezmiu Valit, duke e kërcënuar me gisht — të mos e shkosh as nëpër mend që të nisesh pa lejën time. Se po ike, më nuk e shikon këtë prak!

Vali mbuloi fytyrën me duar e filloi të qante në heshtje. Njeri nga gërshetat i shkau në qafën e bardhë.

Megjithëse Xhezmiu shkumëzonte nga inati, dhe kurrë s'ishte treguar aq i egër, përsëri ja kishte frikën vendosmërisë dhe qetësisë që po tregonte e shoqja. Kjo e trembte më shumë se çdo gjë tjetër, dhe kësaj nuk dinte si t'i kundërshtonte. S'mbahej mend të kishte ndodhur grindje më e madhe në familjen e tyre dhe ndryshe nga herët e tjera të dy palët, pas fjalëve të ashpra, fyerjeve e kërcënimeve, nuk kishin dhënë shenja lodhjeje e dorëzimi. Të dy palët kishin mbetur në pozitat e tyre. Më në fund zëri i fortë i Xhezmiut gjëmoi:

— Ikni flini! Mjaft më mërzitët!

Vëllai i vogël i Valit u ngrit serioz e doli nga dhoma pa thënë natën e mirë. Pas tij doli edhe Vali, e cila flinte në një dhomë me të.

— Ikë dhe ti! — i bërtiti së shpejt Xhezmiu, — se s'të shikoj dot. Tërë jetën s'më ke mërzitur sa sonte. Dhe të mos të kisha nënën e dy fëmijëve, për këtë zjarr, që do të ndahesha me ty që tani. . .

— U, po ti. . . — ja ktheu Vita dhe doli nga dhoma duke murmuritur nëpër dhëmbë.

Xhezmiu mbeti vetëm. Mendonte me njëfarë ankthi se sikur të nesërmen ajo ta përcillte ashtu siç kishte vendosur, ky do të ishte një turp shumë i madh. Atij s'i mbetej gjë tjetër, veçse ta ndiqte të bijën në Tiranë, ta merrte nga shkolla e ta sillte me forcë në shtëpi. Mirëpo kjo gjë sigurisht do të merrej vesh, dhe ecë e të dëgjoje fjalët e botës, pastaj! Duhej zgjidhur kjo punë dhe duhej gjetur një mënyrë e përshtatshme që Vali të mos kishte si të ikte në shkollë edhe kur ai të mos ndodhej në shtëpi, sepse s'mund të mbyllej brenda e të ruante çupën.

«Nga gratë ka ndezur belanë edhe djalli,» mendonte me ligësi, dhe në shpirtin e tij në ato çaste ishte shuar çdo ndjenjë mëshire dhe dashurie. Filloi të shkonte ndër mend shumë mënyra, po asnjë s'i dukej e përshtatshme. «Ç'e kishin mirë qëmoti! Thoshte babai jo, dhe jo, kishte marrë fund ajo punë. Mirëpo edhe qëmoti kishte vajza që s'dëgjonin? Ç'u bënin atyre?»

Më në fund i ra ndër mend një gjë që e bëri të gëzohej, dhe sytë i shndritën nga kënaqësia.

«Shko tashti në shkollë, po deshe, tha me vete. Kur të ta qeth unë kokën, s'ke se si të dalësh përjashta.»

Të vjetrit kështu i ndëshkonin vajzat e përdala. Që një shenjë pöshtërimi dhe fyerje, një njollë që mbetej gjithë jetën, po Xhezmiu në inat e sipër as që i mendonte këto gjëra. Ai priti sa i zuri gjumi të gjithë njerëzit e shtëpisë, pastaj u ngrit, mori një palë gërshërë dhe iu afrua shtratit të së bijës në majë të gishtrinjve. Valin e kishte zënë gjumi përmbys, si

duket, kishte qarë akoma në shtrat. Xhezmiu përgjoi një hop, sepse ajo luajti në gjumë, dhe priti derisa dëgjoi frymëmarrjen e saj të rregullt. Atëhere u ul në gjunjë. Gërshërët hynë në punë dhe filluan të rrezonin në faqen e bardhë të jastëkut tufa flokësh të ndritshëm e të butë si mëndafsh.

Vali ndjeu nëpër gjumë se një gjë e ftohtë po i kalonte në kokë dhe instinktivisht ngriti dorën, po atëhere qe tepër vonë. Xhezmiu thujse i kishte qethur gjysmën e kokës. Ajo hapi sytë përgjumësh e në fillim s'kuptoi gjë, vetëm kur pa në dorën e të jatit gërshërët, u tremb dhe vuri dorën në kokë që të mbronte flokët. Dora i ra në vendin e qethur, ajo bërtiti me frikë. Akoma nuk i besohej çfarë i kishte ndodhur e, duke u ngritur me vrull, vajti te pasqyra.

Nuk e pa dot më shumë se dy sekonda atë vajzë me kokë gjysmë të qethur, që dukej se ngjiste me të. Mbylli sytë me duar, pastaj u shemb përdhe duke bërtitur me sa fuqi që kishte:

— Mama! Moj Mama!

E ëma u ngrit menjëherë nga gjumi dhe shkoi në dhomën ku flinin fëmijët. Ngjante me diçka të tmerrshme kjo nënë që donte të mbronte fëmijët.

— Ç'i bëre çupës, mor egërsirë?

Xhezmiu tundte akoma gërshërët ndër duar.

— Hë dosë, dosë! Shko tashti në shkollë, po deshe... Tani nga mua e ke lejën me pash.

Vita hodhi një vështrim të shpejtë në dhomë, pa flokët e së bijës mbi krevat e në dysheme dhe e kuptoi ç'kishte ngjarë.

— Hy, të preftë perëndia ditët! Hy, të hëngërt një kolerë! Po baba je ti, mor ditëzi?

Xhezmiu hodhi gërshërët në dysHEME e doli nga dhoma.

Vita iu afrua së bijës dhe e zuri nga supet. Edhe ngushëllimet e saja në ato çaste qenë të rrepta:

— Hajde, ngrehu, se s'të gjeti gjë. Flokë janë, përsëri do të rriten, mos qaj si budallaqe!

Vali shikonte në dysHEME gërshetin e saj të pruar dhe i vinte të qante me kuje. Ai akoma shkëlqente nga të larët. E mori tufën e flokëve dhe e shtrëngoi në gjoks me një ndjenjë dhëmbjeje të turbullt. Në mes të ngashërimeve ajo tha:

— S'më vjen keq për flokët, më vjen keq që s'do të vete më në shkollë.

Vali futi kokën në prehrin e së ëmës, si atëhere kur ishte e vogël, dhe tek ndjente dorën e nënës që i lëmonte flokët i dukej se provonte sërish atë gëzimin e largët të fëmijnisë, kur të përkëdhelurit e nënës, pasi që vrarë ose rrëzuar, ishte ngushëllimi më i mirë në botë.

Edhe këtë radhë po i fliste nëna, zëri i saj s'kishte ndryshuar, ai ruante po atë timbër, të cilin e kishte dëgjuar së pari, duke u përkundur në një djep të vogël prej druri; ai zë sillte me vete jehonën e largët të shumë ninananave.

Ata vjete kishin mbetur tej, si një yll në horizont, po nëna ishte përsëri aty, e dashur dhe e mirë si gjithmonë. Dhe nga fjalët e saj, retë e mallëngjimit dhe të hidhërimit që kishin pushtuar Valin, u

larguan ca nga ca. Mbi sytë e vajzës, mbushur me lot, ndriti një copë qiell i kaltër.

E ëma kishte dëgjuar ta ngushëllonte, ashtu siç dinë vetëm nënat, dhe Vali ndjehej krejt e qetë.

Xhezmiu shkoi në punë herët në mëngjes, ashtu si gjithmonë. Vita e përcolli me sy gjer në të kthyerën e rrugës.

Kur ra dielli anembanë, ajo mori Valin përdore dhe të dyja së bashku shkuan te berberi i fshatit. Ky, duke tundur gërshtë, tha me dëshpërim:

— Nuk rregullohen, s'kam si t'ja bëj. Po të më dëgjoni mua, më mirë le ta qethë kokën fare. Për tre-katër muaj do t'i rriten përsëri.

* * *

Kështu erdhi ajo në shkollën tonë. Ndryshe nga gjithë vajzat e tjera që rrinin kryejashtë, Vali e mbante kokën vazhdimisht të mbështjellë me një shami mëndafshi, cepat e së cilës i lidhte nën gushë. Ne në fillim e pandehëm se ishte qeroze, e shikonim me njëfarë përcmimi, bile disa që nuk shquheshin për mirësjellje edhe pëshpërisnin, kur ajo kalonte pranë nesh. Vetëm pas disa javësh, kur morëm vesh si kishte ndodhur puna, qëndrimi ynë ndryshoi shumë. Tani më shumë se shaminë e saj të mëndafshhtë me të cilën mbështillte kokën, ne shikonim shpirtin e saj të paepur dhe dëshirën e zjarrtë për shkollë.

MOTRA

Ajo s'do të kishte ardhur në spital po të mos më kishte ndodhur aksidenti. Siç ndenjëm dymbëdhjetë vjet pa folur, ndofta mund të rrinim edhe dymbëdhjetë të tjerë dhe mëria jonë s'do të merrte fund kurrë. Gati-gati ne ishim bërë si të huaj me njëri-tjetrin, qëkurse ajo nuk iu bind familjes, nuk iu bind këshillave të babait dhe iku me atë...

As në çastin kur më ndodhi aksidenti, e as ato ditë që ndenja në shtëpi, s'e kisha kujtuar motrën, s'më kishte rënë ndër mend për të. Edhe në spital, kur më shkonte mendja se mund të vdisja, më vinte keq për fëmijët e për nënën, kurse motrën, për çudi, as që e kujtoja. Dhimbjen e saj s'e merrja me mend, bile e kisha vështirë ta parafytyroja, dhe tiparet e saj nuk i bashkoja dot në një të tërë, ato më kujtoheshin vetëm të shpëputura.

Vjete armiqësore ishin futur midis nesh dhe koha, kur ajo më përkeqësoi e me shtrengonte kokën në gjoks, kishte humbur në një mjegullirë të padepërtueshme, ishte larguar tej e ishte zvogëluar si një objekt që fluturon në ajër me shpejtësi.

Ditët e spitalit, të gjata si ditë korriku, mezi

ngryseshin. Meqë nuk lexoja dot, se rreshtat më vallëzonin përpara syve, rrija shtrirë në krevat dhe përpigësja të kujtoja ndonjë ngjarje të bukur me të gjitha hollësitë. Po hollësitë gjithnjë më shpëtonin. Më vështirë e kisha kur mbyllja sytë. Sapo qepallat puqeshin me njera-tjetrën, kisha ndjenjën e mërzitshme sikur vazhdoja të ecja me maqinë dhe, doja s'doja, kujtoja aksidentin.

Si të gjitha aksidentet, edhe yni, kishte ngjarë fare kot. Ne po shkonim me «gazin» e komitetit të partisë nga qyteti në minierë. Do të bënim një vizitë të shkurtër dhe do të ktheheshim sërish. Unë isha ulur përpara, përkrah shoferit. Ishte një mëngjez i bukur dhe dielli ndriçonte fort. Rrezet e tij na binin përballë, dhe, për të zbutur fuqinë e tyre, ula xhamin mbrojtës të diellit; kështu gjithë natyra dukej ndryshe, me nuanca bojë kafeje e kredhur në një banjë të ngrohtë drite. Do të kisha bërë mirë të mos e kisha ulur fare xhamin e diellit, sepse për pak lashë kokën. Menjëherë, pas një kthesë jo shumë të fortë, ne u përplasëm me një gaz që po vinte në drejtim të kundërt. Shoferi ynë e pa dhe u mundua ta mbante maqinën mënjanë, gati sa nuk e hodhi në rrëpirë, kurse shoferi që po vinte me shpejtësi përballë nesh, nuk bëri as përpjekjen më të vogël që të mbante krahun e vet; kështu ngjau përplasje. Punë sekondash. Maqina u godit në krahun e majtë, dhe pas përplases së fuqishme ngeli në vend. Nga udhëtarët goditjen më të madhe e pata unë që ndodhesha në krahun e djathtë. Balli im u përpoq te bullona sipër xhamit të diellit dhe

bullona më hapi një vrimë përmbi vetull. Ndjeva gjakun të më shkiste nëpër fytyrë, dhe pastaj pashë pikat që po më binin mbi xhakatë e mbi pantallona.

Filloi pastaj një rrugë mundimesh e torturash. Më çuan në spital. Gjysmën e kokës nuk e ndjeja, më dukej sikur ma kishin zëvendësuar me një copë dhogë, sendet më vinin rrotull dhe lëviznin papushim. Shikoja murin, që më largohej, pastaj dallgëzohej si të ishte një send i ujshëm. Që të binde-sha se s'luante, më duhej t'i mbërtheja sytë në një pikë e ta detyroja logjikën të më përsëriste të vërtetën e njohur se muri s'luan e nuk dallgëzohet. Kisha dhe shqetësime të tjera. Kohë pas kohe e ndjeja veten si një tel violine të tendosur në maksimum. e atëhere nuk i luaja dot gjymtyrët, më dukej sikur në lëvizjen më të vogël diçka do të më këputej e unë do të përmbysesha në tokë. Herë të tjera më dukej sikur dikush më shtrëngonte në grykë e s'merrja dot frymë.

I shtrirë në krevat, me faqen të mbështetur në jastëk, shikoja komodinën, kurrizin e shokut, dy-mbëdhjetë pllaka të çimentos në ngjyrë të bizeles, tri këmbë krevati dhe një palë heqka. E tëra kjo ngjiste me një tablo pakuptim, si ato të piktorëve abstraksionistë. Kështu, pra, me një kënd shikimi të tillë, sendet reale humbnin kuptimin e tyre, nga-çë s'kishte as perspektivë, as horizont, dhe të gjitha dukeshin kaotike. Kurse po të ngriheshe nde-njur mbi krevat, ç'do gjë dukej e qartë, e pastër, e rregullt. Krevatët e vendosur në dy rreshta si-metrikë, tryeza me lule dimri në mes, dritaret e

larta prej nga hynte shumë dritë, pllakat e çimentos që shkëlqenin, pemët e larta matanë dritareve dhe qielli i kaltër të futnin në botën e bukur e të mirë.

Kjo më shtyri të mendoja shpesh, ato ditë, se sa ka të bëjë horizonti i të shikuarit të gjërave. Nga njëfarë niveli disa gjëra duken jo ashtu si janë. Më kujtohej edhe një skicë nga libri i gjeografisë. Atje tregohej qartë se si zgjeronej horizonti i shikimit në përpjestim me lartësinë. Atë skicë, të cilën gjithmonë e kisha kundruar pa ndonjë vëmendje e kujdes, atje në spital e çmova si asnjëherë tjetër. Duke u ngritur në njëfarë niveli, syri pushton gjithmonë hapësira më të mëdhaja.

Në spital vinin më vizitonin, gati përditë, nëna, gruaja dhe fëmijët. Edhe disa shokë. Vizita të tjera unë s'prisja. Motra s'kishte si të vinte. Ne ishim zemëruar me të qysh në vitin 1946, atëhere kur ajo filloi të dashuronte një oficer të ri që banoonte kundrejt shtëpisë sonë. Vendi sa që çliruar nga pushtimi i huaj. Tirana që mbushur me partizanë, të shumtët e të cilëve për ne qenë të panjohur. Ai oficeri që rrinte përballë shtëpisë sonë, që një djalë i ri dhe i shëndetshëm. Trupin e kishte të hollë e të drejtë; bustinën e vinte pak mënjanë, e linte t'i dukeshin flokët e dredhur. Kishte një ecje të lehtë e fodulle. Rrypin dhe revolverin e mbante gjithmonë mbi xhakaventon ushtarake.

Nuk e di nga i buronte gjithë ajo krenari në lëvizje, në të folur e në ecje, po edhe pa shkak s'ishte. Ai kishte dalë malit partizan e kishte luf-

tuar, shtojtu këtyre dhe fitoren dhe entuziazmin e rinisë dhe atëhere kuptohej pse ja mori mendjen Meremes. Në fillim ne dëgjua thashetheme nëpër mëhallë, pastaj e pamë edhe me sytë tanë se Meremja po i shpeshonte vizitat në shtëpinë e komshiut me shkak e pa shkak. Nuk shkoi shumë kohë e ajo tha se dëshironte të martohej me një oficer.

Babai, natyrisht s'kishte si ta lejonte.

Një mbrëmje, sapo u kthye nga dyqani, ai zbathi këpucët dhe, duke kryqëzuar duart mbi bark, iu drejtua Meremes:

— Ç'është ai oficer që kërkon të na sjellësh në shtëpi ti? — Në tonin e zërit të tij ndihej dëshpërimi dhe inati.

Motra rrinte mbi minder duke shikuar e menduar palat e fustanit. Një pyetje të tillë, që i binte çeshtjes drejt, ajo s'e kishte pritur, prandaj u hutua, u skuq dhe, pa e kuptuar se ç'po bënte, si ata kalamajtë e vegjël, filloi të kafshonte një gisht.

— Ty të pyes; ç'është ai oficer që kërkon të na sjellësh në shtëpi? — e pyeti sërish babai, duke e mbërthyer me vështrimin e tij të rreptë.

— Ai s'do të vijë këtu... belbëzoi motra — unë s'kërkoj të sjell këtu... Ne do të zemë një dhomë më vete... — mezi mundi t'i nxirrte nga dhëmbët këto fjalë.

— E kuptoj ç'kërkon të thuash... Ti thua se nuk do të vijë ai këtu në shtëpinë tonë, por do të shkosh ti atje... Kështu, apo jo?

Motra pohoi me kokë.

— Je budallaqe! Budallaqe! — i gërthiti babai, — Në qoftë se do ta bëj dhëndërr. a s'do të vijë këtu në shtëpinë time të ulet në një tryezë me mua? A s'do të hyjë e do dalë si njeriu i shtëpisë? Hë, moj, folë!

Motra nuk dinte si të përgjigjej, por nga mënyra se si kish përthyer buzët, dukej se s'kishte ndër mend të hiqte dorë nga vendimi i saj.

Babai, nga ana tjetër, s'kishte pritur një kundërshtim të tillë, dhe dukej shumë i zemëruar. Duke ngritur njerën dorë lart, ai vazhdonte të fliste duke e bombarduar motrën me një breshëri pyetjesh:

— Ç'është ky oficer që na paska zgjedhur kjo koka jote e zgjuar? Nga është, nga ka ardhur, ç'njerëz ka në shtëpi, ku e ka prokopinë, ku e ka shtëpinë? Ti, natyrisht — u mundua babai të buzëqeshte me ironi — as ke pyetur për këto, se t'i kanë marrë mendtë kaçurrelat e tij. Mirëpo tani duhet të mendohesh, se s'je vajzë e vogël. E para e punës, ti s'e ke pyetur nga është? Po sikur të jetë nga ndonjë fshat i Labërisë, ndonjë çoban dhish, do t'i vesh pas ti?

Motra nuk iu përgjegj. Dyshoj se ajo vërtet s'kishte pyetur prej nga ishte oficeri, të cilin donte ta merrte burrë.

— Hë, moj, folë! Do të vesh?

Motra shikoi anash me bisht të syrit, si për të gjetur një rrugëdalje e pastaj u përgjegj me kokë ulur:

— Do t'i vete.

Babai, ashtu siç qe në këmbë, iu afrua, ja kapi kokën me duar që ta shikonte në bebëza dhe, ndërsa sytë i vezullonin, e pyeti:

— Nuk dëgjova mirë. Si the, do t'i vesh pas?

— Po, — tha ajo.

— E të vesh në djall atëhere, ti dhe ai bashkë me ty! — dhe, duke thënë kështu, babai e goditi me shuplakë në faqe.

Akoma më kujtohet sa shumë krisi ajo shuplakë. U duk sikur në shtëpi ishte thyer një vazo e çmuar kristali dhe menjëherë u vendos një qetësi e rëndë. Motrës i qe ndezur faqja flakë dhe nën qerpikët e zez sytë i kishte të njomur, nga dhimbja dhe dëshpërimi. Megjithatë nuk qau.

Shuplaka ishte kulmi i atij hovi zemërimi. Mua më vinte keq për babanë; s'e kisha parë kurrë aq nervoz. Ai zuri të ecte nëpër dhomë duke u përpjekur të ngjallte në shpirtin e motrës ndjenjën e detyrës dhe ndjenat e dhembshurisë kundrejt prindërve, po dukej se çdo gjë ishte e kotë dhe kishte marrë të tatëpjetën.

Motra iku në dhomën tjetër, megjithatë babai s'hoqi dorë nga arësytimet e veta; ai ishte i sigurtë se fjalët e tij dëgjoheshin edhe në dhomën ngjitur, prandaj vazhdonte të fliste:

— Prindi s'ja do kurrë të keqen fëmijës. Ti akoma je re, e papjekur nga jeta dhe nuk di t'i gjykosh punët ashtu si duhet. Po sikur nesër-pasnesër ta transferojnë nga Tirana dhe ai të iki duke të lënë në mes të rrugëve, nga t'ja mbajmë ne pas-taj? Ç'të mirë do të kemi ne, kur vajza jonë të

vuajë? Pse të marrësh për burrë një hushkukur, një njeri që s'e njohim fare, për ç'të keqe ta bësh këtë gjë, çfarë të detyron? Ti e shikon me pallaska kraheve dhe thua si ky s'paska tjetër. Po tani lufta mbaroi, tani duhet zanat, tregëti, kapital. Edhe oficerë do të bëhen ata që kanë shkollë. Ai yti s'besoj se ka shkollë. Ku do ta gjente shkollën në majë të malit, afër mëndsh, kështu që do t'ia heqin pallaskat. Atëherë me se do të merret yt shoq? Ç'është i zoti të bëjë? Do të zërë kërrabën përsëri... E po me çobanin e dhive unë s'shtrohem në një tryezë!

Mbase ai oficeri që rrinte kundrejt shtëpisë sonë s'kishte qenë kurrë çoban, po në sytë e babait të gjithë lebërit ishin çobenj dhe hajdutë. Fakti ishte që ai s'e donte dhëndrrin oficer e aq më tepër nga Labëria. Kjo do ta vinte babanë në një pozitë të vështirë përpara rrethit tonë familjar, që përbëhej nga tregëtarë e zanatçinj të vegjël. Në sytë e tyre vlera e babait, po qe se bëhej ajo krushqi, do të binte shumë; babai do të konsiderohej si një njeri që kishte futur në rrethin tonë një person krejt të huaj, me të cilin nuk mund të bisedoje pa ndruajtje. Dihej gjithashtu se asnjë nga të afërmit tanë nuk do ta pranonte që goca e Rexhës të martohej me një burrë që s'kishte asnjë prokopi, asnjë të ardhur veç rrogës së tij.

Nëna s'dinte si të vepëronte. Sigurisht edhe asaj nuk i pëlqente të na hynte në shtëpi një oficer. Nga të gjitha llojet e uniformave ajo ndruhej e stepej. Ajo dëshironte për dhëndërr jo ndonjë kushedi se

çfarë, po të paktën ndonjë djalë tregëtari nga ata të rangut të babait, ose ndonjë mësues. Dhe natyrisht të ishte tiranas, njeri që të kishte zakonet tona.

Unë vetë i jepja të drejtë babait, dhe arësytimet e tij më dukeshin bindëse. Babai atë javë po sillej me mua si me një burrë të rritur, sido që unë nuk isha më shumë se pesëmbëdhjetë vjeç. Ai shkoi gjer në Shijak për dy ditë dhe nuk e mbylli dyqanin si tjetër herë, por ma besoi mua. Më dha çelësat e më tha se unë isha bërë djalë i pjekur dhe mund ta mbaja dyqanin çelur. Për këtë arësye respekti im për babanë që shtuar, dhe unë s'doja ta shihja të zemëruar. Kokëfortësia dhe këmbëngulja e Mëremes nuk më pëlqente. Dhe nga ana tjetër më dukeshin krejt të kota, se derisa babai nuk donte, kjo do të thoshte se ajo gjë s'duhej të bëhej kurrë. Shkova në dhomën tjetër, atje ku ishte motra dhe i thashë:

— Të isha unë në vendin tënd, s'e merja atë oficerin... E dëgjove se ç'tha babai?

— Ku merr vesh ti se ç'bëhet! Ti je kalama! — Këto m'i tha me mospërfillje, me një ton të vrazhdë. Përgjegjja e saj më zemëroi shumë... Padashur kishte prekur pikën time më delikate: më tha kalama në një kohë kur unë e quaja veten të rritur.

— Sidoqoftë ne s'të japim tek ai...

— Se po të dua unë, s'e marr vetë? — tha ajo duke picërruar sytë. — Kalama!

— E merr, po ne s'ta japim sëndukun e pajësi.

Këtë unë e kisha dëgjuar nga babai, dhe m'u duk se u hakmora mirë, mbasi motra heshti. Ajo

kishte punuar të paktën nja gjashtë vjet për të pregatitur pajën dhe unë gjithmonë, qëkurse isha fare i vogël, sa herë e sillja ndër mend, nuk e përfytyroja dot ndryshe, veçse të ulur te shkallët, duke qëndisur mbi gjergjef lule e zogj.

Paja e motrës ishte objekt zilie për kushërirat tona e për shoqet e saj. Në shtëpinë tonë gati çdo javë s' bëhej gjë tjetër veçse merreshin hua modele qëndisjesh, bliheshin jastëqe të pikturuara dhe qepeshin copa të reja. Krimbi i zilisë më kishte hyrë edhe mua qëkurse i kërkova babait të më blinte një biçikletë. Për pajën e Meremes ai s'i kursente kurrë paratë, kurse mua, sado që i isha lutur disa herë me radhë, s'kishte dashur të më jepte të holla, duke e shtyrë nga muaji në muaj, gjersa një ditë ma tha hapur, ta hiqja mendjen nga biçikleta.

Baulja e pajës së motrës ishte në dhomën ku ne po grindeshim. Motra heshti duke shikuar baulen e pajës me një vështrim të përqëndruar. Atëhere unë dola nga dhoma fitimtar. Ndjeja kënaqësinë e mundjes së kundërshtarit dhe gëzimin e ëmbël të egos.

Me motrën unë s'grindesha kurrë dhe përgjithësisht në familje bënim një jetë shumë të qetë. Babai kishte një dyqan të vogël, ku shiste fruta e zarzavate dhe gjithë ditën e kalonte jashtë shtëpisë. Bile edhe drekën ne ja çonim në dyqan, kurse mbrëmave e prisnim sa të kthehej nga dyqani, sepse atij i pëlqente kjo gjë. Ai duke ngrënë kishte qejf të bisedonte dhe të na tregonte të rejat e ditës.

Edhe atë mbrëmje nëna përgatiti darkën dhe

shtroi tryezën. Motra nuk dëgjoi të vinte. Ne u ulëm në vendet tona. Babai u hodhi një vështrim përçmues pjatave, pastaj i ra lugës me kurrizin e dorës dhe e rrëzoi në tokë. Tingëllima e saj, si ë një zileje të vogël, u dëgjua në gjithë shtëpinë. Babai u ngrit nga tryeza, ndërsa nëna e ndoqi me një vështrim mbushur me merak. Vetëm unë hëngra asaj nate si zakonisht.

Edhe më vonë, gjatë atyre ditëve më dukej e çuditshme dhe s'e kuptoja dot si ishte e mundur që një i huaj, një njeri të cilin ne s'e kishim parë kurrë e me të cilin s'kishim të bënim fare, kishte qënë i zoti të na prishte atë qetësi të ngrohtë familjare që po e shijonim prej vjetësh.

Të nesërmen babai shkoi në punë, si zakonisht dhe kur u kthye në darkë, u përpoq të sillej sikur natën e kaluar s'kishte ndodhur asgjë. Bile, deshi ta bënte motrën të qeshtë duke bërë shaka në kurrizin tim, po kjo dukej si një lojë e kurdisur keq. Midis tyre, që prej asaj shuplake, dukej se ishte thyer diçka e ajo diçka që e pandreqshme.

Një javë më vonë motra u përvodh nga shtëpia. Sënduku i pajës kishte mbetur atje ku ishte, në cep të dhomës, i paprekur, si kujtim i një kohe të largët. Motra s'kishte dashur të merrte kurrgjë.

Babai u bë si i xhindosur, kur mësoi ikjen e saj nga shtëpia pa lejën e askujt. Donte të vinte diku, e s'dinte ku të vinte. Donte të bënte diçka, e s'dinte çfarë të bënte. Më në fund inati i tij gjeti një rrugë e shpërtheu. Ai vajti, hapi baulen e motrës dhe, me furi të papërmbajtur nisi t'i shqyente fustanet dhe copat e ndryshme një nga një duke bërtitur:

— Sa të jem gjallë s'dua t'ja shikoj sytë! S'dua të më shkelë në shtëpinë time! E kam bërë haram. Haram njëmijë herë!

Disa ditë ai nuk doli në dyqan. Shkonte nga xhaxhallarët dhe përpiquej ta mbyste hidhërimin duke pirë. S'kishte ditë që të mos e mallëkonte, s'kishte ditë që të mos thoshte se do t'i vinte më shumë keq për një magjyp që vuante në rrugë, se sa për të bijën. As ne nuk do t'i flisnim këtej e tutje. Ajo s'kishte më familje, as prindër, as vëlla. Bëri si i deshi koka, tani le t'i dilte mbanë vetë asaj pune.

Kështu na ngjau me motrën.

Ne s'folëm shumë kohë; për vite e vite me radhë ajo qe e huaj për ne dhe ne qemë të huaj për të. Babai thoshte shpesh se ai flokëkaçurreli do ta linte, e se e bija do t'i vinte t'i binte ndër këmbë. Ai thoshte se s'do ta pranonte më, edhe sikur ta shikonte duke vdekur.

Shkuan disa vjet. Burri i motrës u transferua në një qytet tjetër, duke u shpërngulur familjarisht. Nga sa merrnim vesh tërthorazi, jetonin mirë. Ai flokëkaçurreli, në kundërshtim me të gjitha parashikimet tona, qe treguar burrë i dashur e baba i kujdesshëm. Por fatkeqësia vjen pikërisht atëhere kur s'e pret, dhe kjo ishte një fatkeqësi krejt e papritur. Burri i motrës u vra në një aksident automobilistik, së bashku me disa të rinj që shkonin vullnetarë në hekurudhë, duke e lënë motrën të ve me dy fëmijë të vegjël. Atëhere ne shpresuam se ajo do të kthehej në shtëpinë atërore dhe do ta luste babanë

që ta ndihmonte, por as kështu nuk ngjau. Ajo që kokëfortë ashtu si babai.

Pas vdekjes së burrit, motra hyri në punë si shitëse në një dyqan shteti dhe, me rrogën që merrte e me pensionin e të shoqit, i bënte ballë jetës. Nëna donte të shikonte nipërit dhe fshehurazi u dërgonte disa dhurata të vogla, po vetë s'kishte guxuar të kërkonte lejë nga babai që t'i shkonte për vizitë.

Gjatë këtyre vjetve unë e kisha parë motrën vetëm dy herë. Ajo s'erdhi as kur u martova unë dhe s'kishte si të vinte, se ne nuk e ftuam. Një ditë, duke shkuar në autobus, ndjeva në rrëzë të veshit një zë të butë, me timbër të njohur.

— Bujar, si është babai?

Ktheva kokën dhe pashë Meremen: «Si duket ajo e kishte marrë vesh që babai ishte sëmurë. Nuk di pse iu përgjegja duke e fshikulluar si me kamzhik:

— Ty s'ka ç'të duhet. Ti s'ke baba!

Ajo më shikoi me përbuzje e keqardhje, si atëhere kur më quajti «kalama». E ndjeva atë vështrim dhe ula sytë.

— Si s'të vjen turp, më tha. — Je dhe arësimitar. Pika kulturës sate.

* * *

Tani unë jam përpara saj dhe më vjen turp ta shikoj në sy. Ajo hyri në pavion shumë e shqetësuar dhe si në ethe mendohej të më dallonte midis të sëmurëve. E vura re sa e tronditur që ishte. Me

siguri fjala «aksident automobilistik» ishte për të më e tmerrshme dhe me tragjike se çdo fjalë tjetër. Aq më tepër se kushedi në ç'gjendje priste të më shikonte. S'pyeti si do ta prisja. M'u hodh në qafë e, duke më shtrënguar kokën në kraharor, më puthte ku mundte, ndërsa nga sytë i shkisnin lot. Dëgjoj një zë të njohur në mes të ngashërimeve:

— Bujar, — më thotë — vëllai i motrës!

Nuk është vetëm gëzimi që më shikon të gjallë pas aksidentit e që e bën të dridhet si një gjethe plepi. Janë një sërë vjetësh malli të ndrydhur në fund të zemrës së saj.

Asaj i shkasin lot nga sytë dhe ma rrëmben përsëri kokën në duar, ndërsa unë e marr me mend si na shikojnë të sëmurët e tjerë. Ata e pandehin këtë një dashuri të thjeshtë e të zjarrtë prej motre, se nuk i dinë vjetët armiqtësore që janë futur midis nesh.

Më vjen turp ta shikoj motrën në sy. Në këta vjet unë, sidomos unë, jam sjellë si idiot. Cili ishte faji i saj? Vetëm se mori atë që deshi.

Pyesja veten: pse u deshën kaq shumë vjet për të kuptuar këtë gjë të thjeshtë? A s'mund të kisha gjykuar kështu para se të më ndodhte aksidenti? Unë kisha gjykuar duke shikuar një horizont shumë të ngushtë, nga një lartësi tepër e vogël — dhe pushë përsëri komodinën, tri këmbët e krevatit dhe pllakat ngjyrë bizele të dyshemesë.

Motra s'do të flasë për vjetët që kanë shkuar. Ndofta kujtimi i tyre e lëndon. Mezi u nda prej meje; lotët i shkisnin faqeve dhe nuk ishte vështirë të

vije re se ajo ishte e tronditur, e lumtur dhe e mallëngjyer.

Mbi komodinë më kishte lënë një paketë cigare dhe disa çokollata. I shikova me vëmendje. Unë kisha cigare në xhepin e pizhamasë, po më pëlqeu të merrja cigaret e motrës. Mora paketën në dorë dhe u ngrita; nuk më rrihej në pavion. Shpirtin e ndjeja të lehtë dhe ajo atmosferë krejt e zakonshme nuk i përshtatej gjëndjes sime. Kisha nevojë për ajër dhe për një hapësirë më të madhe.

Dola në kopsht dhe mora frymë thellë. Vinte erë ngrohtësirë dhe lule. Hodha sytë nga horizonti; kodrat afër dukeshin kafe, kurse malet më tej kishin ngjyrë jargavani. Sipër tyre qielli ishte i pastër, i ndritshëm dhe vetëm nga lindja endeshin ca re të bardha, si fëmijë shkolle të vonuar.

Ndeza një cigare nga të motrës dhe u ula në një fron, duke shikuar lulet, pemët e kopshtit, malet dhe qiellin e lartë; doja të mendoja diçka të mirë, diçka të bukur, por isha i dehur nga lumturia dhe s'mendoja dot asgjë, vetëm më pëlqente të sodisja kopshtin, muzgun dhe malet ngjyrë jargavani.

46 197

IBRAME
BIBLIOTEKA E SHIETIT
GJIRONASTET

PASQYRA E LËNDES

Faqe

E pabesueshmja	3
Një pushkë më shumë	22
Tre vetë kapërcejnë malin	33
Atë dimër	60
Tregimi i gjyshes	68
Njohja	79
Rrugës	91
Zemërmiri	106
Gërshetat	116
Motra	133